14 How Does Salesforce Use Artificial Intelligence To Transform Businesses?. [Accessed 2 May 2024]. Available From: <https://thedatascientist.com/how-does-salesforce-use-artificial-intelligence-to-transform-businesses/>

15 Patil P. 27 September 2023. Artificial Intelligence in Cloud Computing. [Accessed 5 May 2024]. Available From: <https://www.linkedin.com/pulse/artificial-intelligence-cloud-computing-paresh-patil/>

17 Salesforce Sales Cloud. [Accessed 3 May 2024]. Available from: <https://in-cloud.ca/service/sales-cloud/>

18 Moroz. V. February 2022. SALESFORCE FOR MARKETING CAMPAIGNS: WHAT IS MARKETING CLOUD, ITS MAIN FEATURES AND BENEFITS. [Accessed 2 May 2024]. Available From: <https://twistellar.com/blog/salesforce-marketing-cloud-overview>

Muzika në Shoqëri- Vështrim i përgjithshëm mbi përdorimin e muzikës si Terapi në moshën e tretë

Dr. Eliona LICI

Lektor

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Eliona.lici@univlora.edu.al

MA. Andi BAKIAJ

Drejtor

Shkolla e Mesme e Orientuar Artistike "Jakov Xoxa"

Msc. Dorina GJIKOKA

Drejtor

Shkolla 9-vjeçare "Musa Çakërr"

Abstrakt

Ky punim synon të paraqesë një panoramë të përgjithshme të përvojës së Muzikoterapisë si një aplikim i qëllimtë i muzikës në kontekstin e një terapie, për të rikuperuar dhe për të mirëmbajtur shëndetin mendor dhe shpirtëror. Muzikoterapia është praktikisht e orientuar si një degë shkencore, e cila lidhet ngushtësisht me degë të ndryshme të shkencës, të psikologjisë, të mjeksisë, të muzikologjisë dhe të pedagogjisë muzikore. Një rëndësi parësore në këtë punim merr trajtimi në mënyrë përgjithësuese i hulumtimeve të studiuesëve që kanë përfshirë në kërkimet e tyre muzikën në komunitet, veçanërisht për efektin pozitiv që ka aplikimi i saj në moshën e tretë, për mirëqenien emocionale, mirëqenien intelektuale, mirëqenien fizike (Muzika dhe lëvizja), por edhe në probleme të shëndetit si *Demencia, Parkinson, Alzheimer*.

Në punim do të rravijëzohen mënyrat me të cilat mund të arrihet rritja e cilësisë së jetës së individëve të moshës së tretë përmes muzikës, si dhe produktiviteti ndaj veprimtarive të përditshme jetësore me anën e teknikave të përshtatshme muzikore për të moshuarit.

Teknika e Rimotivimit, përshtatja me realitetin (për rastet e çorientimit ose hutimit, përmes kujtimeve Reminiscencës, trajnim ndijor. Duke përdorur një sërë mjedesh të ndryshme muzikore (Lëvizje, zërin, instrumente, dëgjim muzikor) mund të kuptohet aftësia e të moshuarve në komunikim, vëmendje, sjellje duke zhvilluar njëkohshëm edhe disa aftësi muzikore.

Duke u bazuar në gjetjet e studiuesve, besohet se në jetën e të moshuarve që vuajnë nga sëmundje të ndryshme muzika dhe terapia muzikore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin shëndetit dhe për rrjedhojë të rritet edhe cilësia e jetës së tyre, për këtë sugjerohet që kjo praktikë të përhapet edhe në vendin tonë për të moshuarit në qendrat tona të përkujdesit social, për të përmirësuar dhe lehtësuar përjetimet, problemet që lidhen me aspektin personal emocional, social dhe komunitar

Fjalë Kyçe: *Muzikoterapia, Shendet mendor, Muzika në Shoqëri, Demenca*

Abstract

The purpose of this paper is to provide a broad outline of the Music Therapy experience as an explicit use of music in a therapeutic context to support both rehabilitation from, and use as a prophylactic against ill-health of mind and soul. Music Therapy: An empirical science practiced the practical course, has interdisciplinary-activity roots comprising several direct and blunt relations with various fields of science such as psychology, medicine, musicology, and music pedagogy. This paper is focusing on research done by researchers who has incorporated the music in community which were done by researchers not only positive impact with a holistic view of music applications towards the elderly which includes emotional well-being, intellectual well-being, physical well-being (Music and movement) but also to health promoting for health issues such as Dementia, Parkinson's, and Alzheimer's.

This paper looks at the possibilities for supporting of the quality of life of the elderly using musical therapy, and for optimizing older people's daily life functions using the appropriate techniques of making music for the elderly. We will explore methods including remotivation, reality orientation (support with disorientation or confusion through memories and reminiscence) and sensory training. Through a wide range of musical means (movement, voice, instruments, musical listening), their communicative and attentive, and certain behavioral capacities, are given a musical measure, and consecutively allow to work on these skills.

Music and music therapy are thus considered to be a particularly effective means of preserving the health and quality of life of elderly people with various diseases according to the results of a large number of studies. Therefore, it is recommended that in our country this practice be promoted for the elderly of social care centers as a way to improve and alleviate the personal, emotional, social and community experience harmful to the same.

Key words: *Music Therapy, Mental Health Music in Society, Dementia*

Hyrje

1. Muzika në shoqëri

Muzika në shoqëri është një aktivitet, që përfshin muzikantët e komunitetit, që punojnë me një grupim të caktuar individësh duke synuar angazhimin e tyre në krijimin e muzikës frymëzuar nga interesat dhe idetë e tyre. Disa prej veprimtarive muzikore në shoqëri kanë si qëllim kryesor adresimin e problemeve dhe vështirësive sociale, që përjetojnë komunitetet pjesëmarrëse, ndërsa aktivitete të tjera brenda kësaj veprimtarie synojnë të krijojnë muzikë për qëllime të caktuara (Atkinson 2001). Në një prej analizave të studiuesit Atkinson-it për punën aktuale mbi muzikën në komunitet evidentohen katër karakteristika kryesore përcaktuese:

1) Muzika në shoqëri është një veprimtari ndërvepruese.

2) Muzika në Shoqëri është një aktivitet që fokusohet në grupe, ku ekziston ndjesia e përkatësisë për pjesëmarrësit të cilët i përkasin prej fillimit komunitetit dhe aktivitete muzikore i drejtohen të gjithë grupit.

3) Muzika në komunitet synon të forcojë procesin e muzikëbërjes duke marrë frymëzimin e saj nga vet 'komuniteti' dhe duke iu drejtuar përsëri atij.

4) Muzika në komunitet ka nën-seksione në fushat e krijimtarisë, motivimit dhe aksesit për të aktivizuar mundësitë e secilit në komunitet. Çështjet që muzika prek dhe trajton më shpesh në komunitet janë të lidhura me përjashtimin social dhe diferencat në sektorë dhe grupe të veçanta njerëzish). Praktikisht, janë tre karakteristika kryesore të punës muzikore në komunitet. Zakonisht është "punë në një projekt" dhe jo një proces i vazhdueshëm ku shpesh përfshihen edhe aspekte të performances. Procesi mund të drejtohet nga muzikantë ekspert dhe punonjës të trajnuar.

Përdorimi i artit muzikor dhe veçanërisht procesi i muzikëbërjes mund të shihet si një aktivitet me rëndësi për shëndetin, për stabilizimin e gjendjeve emocionale, marrëdhënieve sociale edhe promovimin e mirëqenies. Bonde (2011)

Vitet e fundit, bazuar në rezultatet e studimeve të shumta, janë ofruar të dhëna që

dokumentojnë disa nga mënyrat, që muzika përdoret për përfitimet ndaj shëndetit, për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e tij në jetën e përditshme (DeNora 2000, 2007).

Duke qenë se sfera e muzikës gjen hapësirë kudo për përdorim në jetën e përditshme për të prodhuar shëndet të mire ajo ngjason si mjekësi e thjeshtë terapeutike dhe një ndër grupimet ku muzika zë vend është dhe mosha e tretë. Pjesëmarrja e të moshuarve në programe artistiko-kulturore-muzikore përbën një aspekt ndihmues në shtëpitë e të moshuarve dhe në komunitet për t'u përshtatur me jetesën e përditshme në këto institucione por dhe jashtë tyre duke i ndihmuar për përfshirjen në aktivitete artistiko-muzikore, pasi përmes tyre marrin një sërë përfitimesh, reduktikimin e ankthit, reduktimi i presionit të gjakut dhe marrjes së medikamenteve) rritje të mundësive për t'u socializuar.

Në praktikën ndërkombëtare është diçka mëse e zakonshme, që institucionet e përkujdesit të organizojnë aktivitete rekreative në bashkëpunim me institucione të tjera të edukimit. Studentët vijnë dhe bëjnë aktivitete rekreative për të kënaqur "gjyshërit" e tyre (Vanitha, 2014).

Modeli i studiuesit Bonde (2011) përshkruan mënyrën në të cilën shëndeti përmirësohet përmes muzikës duke e ndërlidhur me katër synime të rëndësishme: 1) Zhvillimin e komuniteteve dhe vlerave përmes krijimit të muzikës. 2) Formimin dhe shkëmbimin e mjedisit muzikor.

3) Përdorimi profesional i muzikës - krijimi i muzikës dhe i tingujve për të ndihmuar individët.

4) Formimin dhe zhvillimin e identitetit përmes krijimit të muzikës ku në bazë të kësaj ai propozon një model në katër drejtime", por ne kemi evidentuar dy prej tyre për të shpjeguar se si janë vendosur praktikatat profesionale në hapësirë dhe kjo është paraqitur më poshtë.

Modeli i studiuesit Bonde (2011) për përmirësimin e shëndetit

Mendje $\implies$ Kuptimi muzikor krijohet në një hapësirë shoqërore. Kjo mund të jetë një familje, një institucion ose një komunitet lokal.

Kuptimi muzikor zhvillohet dhe administrohet nga persona që muzikojnë, zakonisht në grup. Aktivitetet mund të lehtësohen nga profesionistë muzikantë të komunitetit ose terapistët e muzikës. Muzikëbërësit ofrojnë mundësi për personat që mund t'i përvetësojnë përvojat muzikore ato në disa mënyra, të cilat mund të jenë emocionale ose ndërpersonale, afirmative ose korrigjuese - kjo varet nga nevojat e personit dhe kontekstit Shoqëri

Trupi $\implies$ Muzika ofron mundësi për personat që mund t'i përvetësojnë ato në disa mënyra. Përvojat muzikore të vendosura në hapësirën tingullore janë të formuara posaçërisht për promovimin e shëndetit. Qëllimi i peizazheve ose mjediseve tingullore të sistemuara me kujdes përmes pajisjeve speciale synojnë shpeshherë të kufizojnë efektet e mundshme dëmtuese të zhurmës.

Qëllimi mund të jetë gjithashtu ofrimi i mjediseve të rehatshme dhe estetikisht të bukura për komunitetin $\implies$ sociale

Sipas Bonde (2011) zhvillimi i komuniteteve përmes muzikës dhe këndimit sjell përvojën e një tradite solide dhe jetëgjatë për shtresëzimin e muzikës në shoqëri. Repertori i përdorur përmban larmi zhanresh, që varion nga këngët popullore, himnet, këngët laike për komunitetin e deri te muzika bashkëkohore popullore. Ky repertor ushqehet në sistemin shkollor dhe përdoret në hapësirat private dhe publike gjatë gjithë jetës së shumicës së njerëzve. Në shtete të zhvilluara si Danimarka përmend Bonde (2011) ekziston një lëvizje korale e fuqishme, që nis me të kënduarën në komunitet prej institucioneve publike-private e deri te ansamblet elitare vokale. Një traditë specifike daneze është shkrimi i këngëve për raste të veçanta (parodi): këngët e njohura me melodi popullore që përdoren si bazë e teksteve të reja në kontekste shoqërore si dasma, ditëlindje, përvjetorë, takime etj. Të gjitha këto tradita kanë qenë të bazuara në pjesëmarrjen e komuniteteve në këndim, veçanërisht në shkolla dhe kisha. Një vëmendje të posaçme vitet e fundit ka marrë edhe studimi i muzikës në shëndetësi. Në fushën e mjekësisë janë krijuar shoqëri, rrjete dhe qendra të reja dhe për këtë një shembull është

Shoqata Ndërkombëtare për Muzikë dhe Mjekësi (2009) (IAMM) që mbështet revistën e re ndërkombëtare dhe ndërdisiplinore *Music & Medicine*. Për këto organizata një fushë e rëndësishme është krijimi i mjediseve të shëndosha akustike tingullore kryesisht në spitale, për këtë janë bërë disa studime dhe shumë prezantime në konferenca dhe të gjitha ato mbështesin *MusiCure*¹, që shërben si një ndërhyrje muzikore e përshtatshme dhe efektive për spitalet (Thorgaard et al. 2005)

Përsa i përket efektit të muzikës në komunikimin verbal të pacientëve, hulumtimi i Clément (2012) tregoi se rrjedhshmëria e të folurit të pacientëve që morën pjesë në grupin muzikor, u përmirësua ndjeshëm dhe se ky efekt zgjati edhe për një periudhë të shkurtër të kohës dhe pas seancave. Lidhur me shpërthimet emocionale/sjellëse të pacientëve, hulumtimet tregojnë se muzika ka një efekt pozitiv mbi ta. Ndërhyrjet muzikore nxisin ndërveprimin social dhe këtë e fakton dhe hulumtimi nga Irish dhe kolegët (2006) ku paraqitet se muzika stimulonte pacientët me demencë dhe se ky "zgjim" përjetohej gjatë gjithë ndërhyrjes. (Zin et al. 2007).

Disa nga kërkimet e mësipërme pretendojnë se efektet pozitive të dëgjimit të muzikës zgjasin deri në dy javë pas përfundimit të ndërhyrjes dhe se sa më gjatë të jetë ndërhyrja, aq më të dukshme janë efektet pozitive (Clément et al., 2012- Guétin al. 2009- Sakamoto et al. 2013 Ueda et al. Duke qenë se të gjitha studimet e mësipërme përdorin muzikën si mjet për ndërhyrje pasi e quajnë "miqësore" për pacientët pasi eliminon medikamentet (që do të thotë se nuk ka efekte anësore) dhe me kosto të ulët, por edhe mund ofrohet për pacientët nga vetë kujdestarët, pa qenë e nevojshme prania e një terapisti, (instruktorit) të specializuar të muzikës (Sung & Chang, 2005 Sung et al. 2010)

¹ Ëhtë një koncept dhe produkt muzikor krijuar nga kompozitori danez Niels Eje, në këto krijime përfshihen një seri albumesh muzikore të krijuara posaçërisht për t'u përdorur në kontekste mjekësore dhe terapeutike. Qëllimi i Musicure është të përmirësojë mirëqenien emocionale dhe fizike të pacientëve përmes muzikës, duke ofruar një mjedis të qetë dhe relaksues.

2. Efekti i muzikës për të moshuarit me Demencë

Muzika luan një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve me demencë, thjesht edhe kur dëgjojnë një lloj muzikor të regjistruar. Mund të supozohet se pjesëmarrja e vetë pacientit në krijimin e muzikës do të kishte rezultate të dukshme brenda një konteksti terapeutik. Dassa dhe Amir (2014), argumentojnë se pacientët me paaftësi mendore, pavarësisht nga të gjitha vonesat e tyre mendore dhe mungesës të të folurit, janë të aftë të këndojnë këngë të vjetra të njohura. Në hulumtimin e studiuesëve u tregua se përdorimi i këngëve të njohura të një periudhe të kaluar të pacientëve gjatë seancave të terapisë muzikore rezultoi ndihmues për të rikthyer kujtime të detajuara. Për më tepër, brenda seancave, pacientët fituan dhe aftësinë për të formuar saktë fjali të shkurtra e të thjeshta për të shprehur ndjenjat e tyre, në lidhje me muzikën që dëgjojnë/këndojnë njëkohësisht, gjë që përmirësoi ndjeshëm gjendjen shpirtërore dhe ndjenjën e 'përkatësisë'. Sipas studiuesve (Dasa & Amir, 2014) në këtë projekt specifik klinik, në protokoll u propozua përdorimi i këngëve për trajtimin e avancuar të Demencës, këngët, që të moshuarit kishin dëgjuar në moshë të re. (Dassa & Amir, 2014).

Pjesëmarrja në grupet e këndimit, për pacientin me demencë si dhe njeriut që kujdeset për të është një mënyrë që nxjerr në pah rëndësinë e pjesëmarrjes së këtyre pacientëve në aktivitete normale ditore. (Camic et al., 2011 Cambell et., al 2017)

Në shumicën e hulumtimeve, të kënduarit është mjeti kryesor i komunikimit për pacientët me demencë, pavarësisht nga niveli i agresivitetit të gjendjes së tyre. Pothuajse të gjithë studimet Chatterton et al (2010), sugjerojnë aktivitetin e të kënduarit si një "mjet" për këdo që punon me pacientët me demencë për ta bërë më të lehtë rutinën e kujdesit ndaj pacientit dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

Kështu, krijimi i grupeve të këndimit i ofruar posaçërisht për pacientët me demencë dhe kujdestarët e tyre, nën drejtimin e një


muzikanti profesionist ose një terapisti të specializuar të muzikës, vlerësohet tepër i dobijshëm dhe sugjerohet si veprimtari në aktivitetet aktive. (Campbell et al., 2017-Osman et al., 2014). Një program i tillë është "*Singing for the Brain*", i cili përmbledh një grup këngësh për individët me demencë. Programi specifik fokusohet edhe tek kujdestarët e tyre, pasi ata investojnë kohë dhe izolohehen nga aktivitete të jetës sociale të përditshmërisë, (Osman et al., 2014)

Në studimin e Clair dhe Berstein (1990), pacientët me demencë, pavarësisht se ishin në një fazë të avancuar të sëmundjes dhe kishin dëmtime të rënda konjitive dhe motorike, u përfshinë gjatë gjithë seancës me muzikë dhe ndërvepruan me pjesëmarrësit e tjerë (stafi infermior, muzikoterapistët). (Clair & Berstein, 1990). Kështu, mund të argumentohet se një program i strukturuar i terapisë muzikore gjysmë ore jep mundësinë që këta pacientë të ndërveprojnë, dhe të komunikojnë nëpërmjet tyre.

A shërbejnë materialet e njohura muzikore (këngët) e rinisë si një nga metodat më efektive për të rriturit e moshuar për të kujtuar fjalët? Gjithashtu kësaj grup-moshe mund t'u mësohen materiale të reja melodike dhe ritmike. Në studimin e kryer në një prej hulumtimeve të (Moore 1991) paraqiten rezultatet për këto pyetje.

Për rastin u përzgjedhën dhjetë pacientë (gjashtë gra dhe katër burra) me demencë të diagnostikuar të moshës 69 deri në 87. Në studim trajnuesi (terapisti) ishte i ulur në piano dhe pacienti rreth një metër larg tij, gjatë procesit u realizuan videot, vendosja mikrofoni, u fotografua fytyra e pacientit, por edhe këmbët, ose ndonjëherë edhe duart, gjatë procedurës. Detyra për pacientin ishte që sapo ti kujtohej kënga e luftuar nga trajnuesi ai të niste të këndonte. Në çastin kur trajnuesi vërente se pacientit i vinte kujtesa muzikore ai bëhej pjesë duke e shoqëruar pacientin në këndimin e një fraze muzikore. Disa pacientë që nuk mund t'i mbanin mend fjalët mërmëritën ose prisnin të shihnin se kur terapisti do të thoshte një fjalë të njohur që do t'i bënte të kujtonin se çfarë ndodhi më pas.

Fig. 1 Konceptualizimi i aktiviteteve muzikore të lidhura me muzikën dhe shëndetin sipas Bonde (2017)



2.1 Modeli i Përdorimit të Muzikës për të Moshuarit;

Përdorimi i muzikës si një mjet terapeutik për të përmirësuar shëndetin mendor dhe emocional të të moshuarve mund të strukturohet në aktivitete Muzikore në Grup - Organizimi i aktiviteteve muzikore në grup, si këndimi kolektiv, për të rritur ndjenjën e përfshirjes sociale dhe për të promovuar lidhjet e reja sociale, përdorimi i muzikës qetësuese për të ndihmuar në uljen e ankthit dhe tensioneve të ndryshme të emocioneve.

Muzika si urë lidhëse me kujtimet. - Përdorimi i muzikës për të lidhur moshatarët me kujtimet e tyre të kaluara dhe për të nxitur emocione pozitive. Muzika si mjet për të mbajtur mend dhe për të memorizuar - Përdorimi i muzikës për të ndihmuar në ruajtjen dhe përmirësimin e aftësive kognitive. (Bonde, 2011)

Në literaturën e hulumtuar një ndër rastet e studimit të realizuara nga (Aldrige, 2005) i referohet aktivitetit muzikor të këndimit si një nga format terapeutike për pacientin me Demencë.

Rasti studimor i z. B ("Rasti studimor i z. B") i cili vuante nga demenca

Z. B, 70 vjeç me katër fëmijë dhe ishte i martuar prej 50 vitesh. Ai ishte një shofer kamioni dhe simptomat e tij të para të demencës filluan në të 60-at e tij. Disa vjet pasi u shfaqën këto simptoma, ai u transferua në një shtëpi të moshuarish për tre vjet. Infermieret e kishin të vështirë pasi sa herë që përpiqeshin ta ndihmonin, B i shtynte apo edhe i gjuante. Më pas ai u transferua në një qendër speciale për 1 vit e 5 muaj ku filloi terapia muzikore. Gjithashtu, z. B luante fizarmonikë para fillimit të simptomave të demencës. I pëlqenin baladat suedeze, këngët e vjetra të kohës së tij dhe muzika tradicionale. Ai e ndërpreu plotësisht këngën kur u transferua në shtëpinë e parë të të moshuarve dhe filloi të fishkëllej, por kur u transferua sërish në qendrën speciale ai pushoi së fishkëllyeri. Z. B vuante nga demenca e rëndë me sëmundjen e Alzheimerit. Përveç agresivitetit ndaj të tjerëve (shtytje, goditje etj.), ai kishte edhe një sjellje të çuditshme, lëvizte mobiljet dhe ecte lart e poshtë rreth 6 herë në ditë. Kur filloi terapinë muzikore ai mori pjesë në 20 seanca muzikoterapie për 4 javë. Çdo takim muzikor bazohej në këngë të gjata të njohura që Z. B i dëgjoi. Terapia muzikore përfshinte:

1. Këngë përshëndetje
2. Përkatesisht 2 apo 3 këngë në pjesën e pare dhe 3-4 në pjesën e dyte
3. Këngë për përfundimin e seancës

Në seancat e terapisë muzikore u vu re se rrahjet e zemrës së pacientit luahetishin, por nuk kishin rritje duke treguar se pacienti po relaksohej gjatë seancave muzikore dhe rrahjet e zemrës ranë nga 83.6 në 74.6. Gjatë vëzhgimeve nga videokasetat Z. B me Demencë nuk këndonte, por shpesh merrte frymë thellë me një shprehje trishtimi, rrahjet e ulta tregonin reagimin nostalgjik ndaj muzikës që dëgjonte. Ajo që u vu re ishte se ndërsa rrahjet ishin të shpeshta nuk kishte asnjë frymëmarrje të thellë,

frymëmarrja e thellë ishte reagim nda muzikës dhe ndjesia që përjetonte në procesin e dëgjimit.

3. Diskutim

Një prej ndërhyrjeve që është përdorur për të moshuarit me demencë, dëmtime neurologjike ose individëve që kërkojnë zhvillim të aftësive kognitive është kënga, që stimulon funksionet e trurit dhe për të përmirësuar mirëqenien mendore dhe fizike është *Singing Brain*². Gjatë procesit të punës për të aplikuar *Singing Brain* niset me vlerësimin fillestar ku përcaktohen nevojat dhe aftësitë individuale të pjesëmarrësve.

Studimet e bëra në këtë fushë treguan se tek pacientët me *Demencë, Alzheimer, Demencë* të avancuar, e të moderuar, duke përdorur muzikën për 1.5 orë në javë, apo 2 herë ga 30 min në një hark kohor 6 muaj apo 20 seanca të shtrira në 5 muaj me ndërhyrjen aktive muzikore, dëgjimore, në grup apo të individualizuar u vu re përmirësimi i aftësive kognitive, reduktimi i depresionit, përmirësimin e aftësive komunikative dhe shprehjen emocionale pozitive. (Schall, Haberstroh, & Pantel, 2015)

Ndër aktivitetet që mund të realizohen gjatë seancave janë intervista me pjesëmarrësit dhe kujdestarët për të mbledhur informacione mbi historinë shëndetësore dhe muzikore. Teste kognitive dhe emocionale për të vlerësuar nivelet e funksionimit të trurit. Vëzhgimi i reagimeve fillestare ndaj muzikës, planifikimi i sesioneve për zhvillimin e planeve të personalizuara të ndërhyrjes muzikore, përcaktimi i qëllimeve specifike për çdo pjesëmarrës (p.sh, përmirësimi i kujtesës, reduktimi i ankthit, përmirësimi i komunikimit). Me rëndësi është procesi i përzgjedhjes së këngëve dhe aktiviteteve muzikore që janë të njohura dhe të përshtatshme për pjesëmarrësit. Përcaktimi i frekuencës dhe kohëzgjatjes së sesioneve që nisin me përshëndetjen ngrohje vokale, ushtrime të thjeshta të koordinuara me frymëmarrjen me diafragmë, këndimin e një kënge të njohur për të aktivizuar trurin dhe për

² Singing Brain" është një term që përdoret për të përshkruar një ndërhyrje muzikore e cila përfshin aktivitete të këndimit të organizuara për individë, veçanërisht për ata me demencë.

të krijuar një mjedis komod. Instruktori (specialist) motivon pjesëmarrësit të jenë aktiv dhe vijon seancën me ushtrime ritmike për të stimuluar koordinimin motorik dhe kognitiv. Më pas pjesëmarrësit mund të krijojnë melodi të reja ose të luajnë me instrumente të thjeshta. Në përfundim të veprimtarisë diskutohet mbi përjetimin e ndjesive gjatë këndimit, pjesëmarrësit inkurajohen të ndajnë kujtime dhe emocione të lidhura me këngët. Dhe në përfundim si në formë të çlirimit për të mbyllur sesionin këndohet një këngë e qetë për të përfutur relaksimi dhe reflektimi mbi përvojën e sesionit.

Pjesë Muzikore të Sugjeruara për *Singing Brain*

1. Këngë shqiptare të muzikës së lehtë dhe popullore
 - "Valse i Lumturisë"
 - "Serenata Korçare"
 - "Kur më del në derë"
2. Instrumente të Thjeshta Muzikore:
 - Tamburina
 - Daulle
 - Ksilofonë

Pavarësisht faktit se ende nuk kemi një studim të mirëfilltë shkencor mund të themi se procesi i seancave muzikore me veprimtari aktive, këndim në kor, vallëzim dhe këndim, ka nisur pranë një Qendre Ditore për të moshuarit në kryeqytet. Studentët e programit të Pedagogjisë Muzikore Fakulteti i Muzikës (Universiteti i Arteve) (ish instrumentist dhe këngëtar, nën mbikëqyrjen e Dr. Eliona Lici, po ofrojnë kontributin e tyre për këtë grupmoshë.

Ende jemi në procesin e mbledhjes së të dhënave, por nga reagimet e të moshuarve vërehet se ata kanë përfutur kënaqësi, relaks, rikthimin e kujtimeve dhe se janë ndihmuar për qendrueshmërinë e zërit dhe nxitjen e lëvizshmërisë përmes së cilës përmirësohet dhe cilësia e jetës. Trajnimi muzikor me repertor të larmishëm, argëtues rezultoi, që rrit lumturinë e moshës së tretë pasi, përjetojnë emocione pozitive, ruajnë kompetencat ekzistuese muzikore dhe ndërkohë zhvillojnë kompetenca muzikore të nivelit më të lartë për performancat muzikore.

Referenca

1. Atkinson W. *The context and genesis of musical tastes: Omnivorousness debunked, Bourdieu buttressed. Poetics.* 2011 Jun 1;39(3):169-86.
2. Baird A, Samson S. *Music and dementia. Progress in brain research.* 2015 Jan 1;217:207-35.
3. Blackett PS, Payne HL. *Health rhythms: A preliminary inquiry into group-drumming as experienced by participants on a structured day services programme for substance-misusers. Drugs: education, prevention and policy.* 2005 Jan 1;12(6):477-91.
4. Bonde LO. *Health Musicing-Music Therapy or Music and Health? A model, empirical examples and personal reflections. Music and arts in action.* 2011 Apr 14;3(2):120-40.
5. Campbell PS. *Music, education, and diversity: Bridging cultures and communities. Teachers College Press;* 2017.
6. Clair AA, Bernstein B. *A preliminary study of music therapy programming for severely regressed persons with Alzheimer's-type dementia. Journal of Applied Gerontology.* 1990 Sep;9(3):299-311.
7. Dassa A, Harel D. *People with dementia as 'spect-actors' in a musical theatre group with performing arts students from the community. The Arts in Psychotherapy.* 2019 Sep 1;65:101592.
8. DeNora T. *Health and music in everyday life—a theory of practice. Psyke & Logos.* 2007 Jun 1;28(1):17.
9. Vanitha D. *Institutional care of the elderly: a study of old-age homes in Hassan City, Karnataka, India. Int J Interdisciplinary Multidisciplinary Studies (IJIMS).* 2014;1:100-7.
10. Osman SE, Tischler V, Schneider J. *'Singing for the Brain': a qualitative study exploring the health and well-being benefits of singing for people with dementia and their carers. Dementia.* 2016 Nov;15(6):1326-39.

11. Sung HC, Chang AM, Lee WL. *A preferred music listening intervention to reduce anxiety in older adults with dementia in nursing homes. Journal of clinical nursing.* 2010 Apr;19(7-8):1056-64.
12. Schall A, Haberstroh J, Pantel J. *Time series analysis of individual music therapy in dementia. GeroPsych.* 2014 Mar 21.
13. Thorgaard P, Ertmann E, Hansen V, Noerregaard A, Spanggaard L. *Designed sound and music environment in postanesthesia care units—a multicentre study of patients and staff. Intensive and Critical Care Nursing.* 2005 Aug 1;21(4):220-5.
14. Wigram T, Elefant C, Aldridge G, Grocke D, Ochsner HM. *Case study designs in music therapy. Jessica Kingsley Publishers;* 2004 Sep 29.
15. Wang, D. W., Peng, Z. J., Ren, G. F., & Wang, G. X. (2015). *The different roles of selective autophagic protein degradation in mammalian cells. Oncotarget*, 6(35), 37098.

Aspektet pozitive dhe negative të shoqërisë së informacionit dhe komunikimit

Dr. Loreta Tozaj

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
loreta.alushi@yahoo.it

Abstrakt

Evolucioni i shpejtë i teknologjisë në vitet e fundit ka ndikuar në jetën e njerëzve, si konsumatorë, si qytetarë, nëpunës, student, mësues dhe sipërmarrës, në një shkallë që është e pashembullt në historinë e dekadave të fundit. Teknologjitë janë bërë më të thjeshta, të besueshme dhe të përhapura, me ndikim të thellë mbi vetë zhvillimin ekonomik dhe social. Kompjuterat personal, telefonat celularë dhe interneti, kanë kapërcyer kufijtë e kërkimit shkencor, duke sjellë ndryshime shoqërore, kulturore, ekonomike dhe produktive, duke krijuar forma të reja të komunikimit dhe ndërveprimit.

Fjalët kyç: *Shoqëria e informacionit dhe komunikimit, teknologjia e informacionit, interneti, etj*

Abstract

The rapid evolution of technology in recent years has affected the lives of people, as consumers, as citizens, employees, students, teachers and entrepreneurs, to a degree that is unparalleled in the history of recent decades. Technologies have become simpler, more reliable and widespread, with a profound impact on economic and social development itself. Personal computers, mobile phones and the Internet have crossed the boundaries of scientific research, bringing social, cultural, economic and productive changes, creating new forms of communication and interaction.

Key words: *Information and communication society, information technology, Internet, etc*

Hyrje

Kuptimi i përcaktimit të shoqërisë së informacionit, e cila nënkupton kontekstin e ri,

si një univers në të cilin teknologjia dhe marrëdhëniet shoqërore janë të ndërvarura, do të analizohet nëpërmjet këtij artikulli për të njohur rregullimet juridike të këtij fenomeni, jo vetëm për sa i përket ndërhyrjeve teknologjike,

por edhe ndryshimeve shoqërore fushës së të drejtave ekzistuese dhe të reja që janë të lidhura me këtë fenomen, si dhe me shërbimet publike në formën elektronike. Shoqëria e informacionit është konteksti në të cilën teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit luajnë një rol themelor në zhvillimin e aktiviteteve të njeriut. Këto teknologji janë përdorur për të prodhuar dhe për të komunikuar, në formë digjitale, mesazhe, imazhe, tekste, muzikë, filma, dhe kështu me radhë. Zhvillimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit po ndryshon mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë mallra dhe shërbime, si formohen gjeneratat e reja, si studiohet, etj. Transformimi i kuadrit industrial të botës së zhvilluar është shoqëruar në vitet e fundit, nga liberalizimi i telekomunikacionit dhe përhapjes masive të internetit. Tipari që ka marrë aktualisht ekonomia dhe shoqëria kanë çuar në shfaqjen e të ashtuquajturës *shoqëri të informacionit*. Kjo shprehje, e cila e ka origjinën në "shoqërinë post-industriale" është përdorur për herë të parë në vitin 1973 nga Daniel Bell, profesor i sociologjisë në Harvard dhe është tregues i një shoqërie moderne, që në kulmin e procesit të industrializimit, duhet që për të vazhduar të rritet të përqëndrojë përpjekjet e saj jo më në prodhimin e më shumë të mirave materiale, por të shërbimeve të paprekshme¹. Për këtë autor shoqëria post-industriale, është

¹ Në dispozicion në
www.senato.it/ocumenti/repository/relazioni/libreria/quadern_o_43_governance.pdf.

rezultat i kompjuterizimit dhe përhapjes së njohurive, që do të lejojë transformimin e shoqërisë së re.

Disa karakteristika të saj janë: roli qëndror i njohurive teorike, roli parësor i shkencës dhe teknologjive të reja. *Pra shoqëria e informacionit, karakterizon atë lloj shoqërie, boshti organizativ kryesor i së cilës është njohja teorike.* Shërbimet e bazuara në dije janë duke u shndërruar kështu në struktura qëndrore të reja të organizmit ekonomik dhe të një shoqërie të udhëhequr nga dija.

Shoqëria e informacionit, përkufizimi dhe aspektet e saj

Në shoqërinë e informacionit prodhimi material është zëvendësuar pothuajse nga prodhimi intelektual, dhe njohuritë, nëpërmjet informacionit, duke u bërë elementi që e karakterizon. Krahasuar me shoqërinë industriale, shoqëria e informacionit ndjek drejtime të tjera: marrëdhënie të reja të përditshme, forma të reja të ndërveprimit shoqëror, lloje të reja të komunikimit në të cilën një rol kyç mbulohet nga mediat. Vlera materiale bëhet gjithnjë e më shumë jomateriale. Që prej Luftës së Dytë Botërore, brenda pak vitesh, shoqëria industriale, e përqëndruar në prodhimin në masë të mirave materiale, i ka hapur rrugë shoqërisë post-industriale, e përqëndruar në prodhimin në masë të mirave jomateriale dhe informacionit. Për këtë arsye shprehja *shoqëri e informacionit i referohet një vizioni social, që zëvendëson shoqërinë industriale, duke vendosur në qendër të saj "burimin strategjik" informacionin dhe njohuritë, në vend të energjisë dhe teknologjisë mekanike të prodhimit*². Brenda këtij përkufizimi mund të futet edhe dimensionin e përdorimit të mjeteve të reja të komunikimit si interneti. Por ky është vetëm një ndër shumë faktorë të tjerë teknologjik. Një aspekt shumë i rëndësishëm është ai i ofrimit të shërbimeve në këtë sektor, thurja e programeve kompjuterike, ndihma teknike në digjitalizimin e arkivave apo dokumenteve etj. Të tëra këto shërbime përbëjnë një produkt të suksesshëm pa sjellë kurrfarë zhvendosje të ndjeshme të krahut të punës vendas në vende të tjera. Termi shoqëri e informacionit është ndeshur edhe në dokumentin e Martin Bangemann, Komisionerit Evropian³ (i ashtuquajturit Bangemann Report) me titull "Evropa dhe shoqëria e informacionit

global", hartuar në vitin 1994, në bashkëpunim me njëzet grupe të mëdha industriale, i cili shpreh konceptin e komunikimit si "e mirë", në dritën e ndërthurjes gjithnjë e më intensive të informacionit, telekomunikacionit dhe informatikës.

Në kohët e sotme, me termin shoqëri e informacionit në kuadrin e Bashkimit Evropian, kërkohet të ndiqen disa objektiva jo vetëm teknologjik, por edhe politik dhe kulturor. Shoqëria e informacionit përshkruan një shoqëri në të cilën, një shkallë e konsiderueshme e aktivitetit fokusohet në krijimin, shpërndarjen, përdorimin dhe ripërdorimin e informacionit. Ky aktivitet kryhet nëpërmjet të ashtuquajturës teknologji e informacionit dhe komunikimit(TIK)⁴.

Ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan është shprehur se *"me shoqëri të informacionit do të kuptojmë një shoqëri në të cilën i gjithë potenciali njerëzor promovohet përmes aksesit në teknologji dhe edukimin që i lejon të mësojnë se si ti përdorin ato në mënyrë efektive"*. Prandaj, shoqëria e informacionit kërkon zhvillimin e njohurive në rritje dhe zgjerimin e edukimit të vazhdueshëm. Pa këtë dhe pa universalitetin e shërbimeve të komunikimit, teknologjitë e reja ka të ngjarë që të gjenerojnë fragmentarizimin(copëzimin) në vend të integritetit.

Kritikët e shoqërisë së informacionit

Përveç përkrahësve të konceptit të shoqërisë së informacionit, ka studiues të cilët kanë rezervat e tyre. Kritika kryesore e koncepteve të tilla si shoqëria e informacionit, shoqëria e dijes, shoqëria e internetit, shoqëria postmoderne, shoqëria postindustriale, etj që është shprehur

⁴ Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), është tërësia e metodave dhe teknologjive që realizojnë transmetimin, marrjen dhe përpunimin e informacionit (duke përfshirë edhe teknologjitë dixhitale). TIK është një term ombrellë që përfshin çdo pajisje të komunikimit ose aplikimit, në të cilin bëjnë pjesë: radio, televizion, telefona celulare, kompjuter dhe rrjetet hardëare dhe softëare, sistemet satelitore dhe kështu me radhë, si dhe shërbime të ndryshme dhe aplikimet e lidhura me to, si videokonferencat dhe të mësuarit në distancë. Sipas Komisionit Evropian, rëndësia e TIK-ut qëndron më pak në vetë teknologjinë sesa në aftësinë e saj për të krijuar akses më të madh të informacionit dhe komunikimit. Shumë vende të botës kanë krijuar organizata për promovimin e TIK-ut, pasi ekziston frika se nëse zonat më pak të avancuara teknologjiksht nuk do të kenë mundësi për të kapur rritjen dhe përparimet teknologjike të vendeve të zhvilluara, kjo do të shërbejë vetëm për të përkeqësuar hendekun ekonomik ekzistues midis vendeve. Ndërkombëtarisht, Kombet e Bashkuara në mënyrë aktive promovojnë Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit për Zhvillim (ICT4D) si një mjet për tejkalimin e hendekut dixhital. Në dispozicion në <http://searchcio.techtarget.com/definition/ICT4D> informacion-and-communications-technology-or-technologies.

² Shih La società dell'informazione, në dispozicion në <http://www.tecnoteca.it/tesi/democrazia/divide/04>.

³ Në dispozicion në <http://www.cyberrights.org/documents/bangemann.htm>.

kryesisht nga studiues kritikë është se ato krijojnë përshtypjen se kemi hyrë në një lloj krejtësisht të ri të shoqërisë. *"Nëse ka vetëm më shumë informacion, atëherë është e vështirë për të kuptuar, pse dikush duhet të tregojë se kemi para nesh diçka radikalisht të re"*⁵. Kritikët si Frank Ëebster argumentojnë se këto qasje theksojnë mungesën e lidhjes logjike, sikur shoqëria bashkëkohore nuk ka pasur asgjë të përbashkët me shoqërinë siç ishte 100 apo 150 vjet më parë.

Kritikët si Ëebster, argumentojnë se shoqëria bashkëkohore para së gjithash është ende një shoqëri kapitaliste e orientuar drejt akumulimit të kapitalit ekonomik, politik, dhe kulturor. Ata pranojnë se teoritë e shoqërisë së informacionit theksojnë disa cilësi të reja të rëndësishme të shoqërisë (sidomos globalizimin dhe informatizimin), por akuzojnë se ato dështojnë të tregojnë se këto janëtribute të strukturave të përgjithshme kapitaliste. Si përfundim mund të themi se shoqëria e informacionit është konteksti në të cilën teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit luajnë një rol themelor në zhvillimin e aktiviteteve të njeriut. Këto teknologji shërbejnë për të prodhuar dhe për të komunikuar, në formë digjitale, mesazhe, imazhe, tekste, muzikë, filmime, dhe kështu me radhë. Në terma më të përgjithshëm, pjesa më e madhe e informacionit dhe njohurive mund të riprodhohet apo të gjenerohet, në mënyrë digjitale dhe me kosto më të ulët. Pra shoqëria e informacionit është një shprehje, e bërë tashmë shumë popullore, që përdoret për përcaktimin e një nga karakteristikave më të rëndësishme të shoqërisë, përkatësisht qendërsisë së fituar nga informacioni dhe teknologjitë e reja të komunikimit. Karakteristikë e saj është aftësia për të sjellë së bashku një numër të pakufizuar të përdoruesve, përtej kufijve hapësinorë-kohorë, dhe vendosja në dispozicion e një sasive të jashtëzakonshme të informacionit⁶. Koncepte të tilla si shoqëria e dijes, shoqëria e informacionit, shoqëria e internetit, shoqëria postindustriale, shoqëria postmoderne, etj tregojnë se ekziston një diskutim i gjallë në doktrinën mbi karakterin e shoqërisë bashkëkohore dhe rolin që teknologjitë e informacionit dhe komunikimit luajnë në të.

⁵ Webster, F, Theories of the Information Society. Cambridge: Routledge, p 259, 2002.

⁶ Verso Una Società Europe Dell'informazione. La Politica e Le Iniziative Europee nel Settore Delle Tecnologie Dell'informazione E Della Comunicazione, Notiziario dall'Europa, Numero speciale/2, Comune di Forlì, Progetti Europei e Relazioni Internazionali, në dispozicion në <http://www.puntoeuropa.eu/Newsletter/2009/tematico2informazione.pdf>.

Karakteristikat e shoqërisë së informacionit

Sipas Nick Moore, shoqëria e informacionit ka tre karakteristika kryesore. *Së pari*, informacioni është përdorur si një burim ekonomik. Organizatat e kanë përdorur rrjedhën më të madhe të informacionit për të rritur efikasitetin e tyre, për të stimuluar risi dhe për të rritur efektivitetin dhe pozitën e tyre konkurruese, shpesh përmes përmirësimeve në cilësinë e mallrave dhe shërbimeve që ata prodhojnë.

Së dyti, është e mundur të identifikohet përdorimi më i madh i informacionit nga publiku i gjerë. Njerëzit përdorin informacionin më intensivisht në aktivitetet e tyre si konsumatorë: për të informuar zgjedhjet e tyre midis produkteve të ndryshme, për të shqyrtuar të drejtat e tyre në shërbimet publike, dhe për të marrë më shumë kontroll mbi jetën e tyre. Ata gjithashtu e përdorin informacionin për të ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre civile.

Karakteristika e tretë e shoqërisë së informacionit është zhvillimi i një sektori të informacionit në kuadër të ekonomisë. Funksioni i sektorit të informacionit është që të plotësojë kërkesën e përgjithshme për lehtësi dhe shërbime të informacionit. Një pjesë e rëndësishme e sektorit ka të bëjë me infrastrukturën teknologjike: rrjetet e telekomunikacionit dhe kompjuterat⁷.

Aspektet positive dhe negative të shoqërisë së informacionit dhe komunikimit

Progresi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit po ndryshon mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë mallra dhe shërbime, si formohen gjeneratat e reja, si studiohet, dhe si bëhet kërkimi shkencor. Shoqëria e informacionit⁸ nuk është duke ndikuar vetëm në mënyrën e bashkëveprimit midis njerëzve, por është duke detyruar strukturat tradicionale organizative për t'u bërë më pjesëmarrëse dhe më të decentralizuara.

Disponueshmëria e informacionit të besueshëm dhe në kohë ka çuar në rishikimin dhe thjeshtimin e shumë proceseve brenda organizatave dhe ndërmjet organizatave, me rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit të përgjithshëm të sistemeve.

Interneti ka ndryshuar rrënjësisht pamjen sociale, kulturore, ekonomike, duke siguruar

⁷ Moore N, The information Society, Policy Studies Institute, United Kingdom, Chapter 20, faqe 271. Në dispozicion në www.unesco.org/webworld/wirerpt/wirenglish/chap20.pdf.

⁸ Në dispozicion në <http://www.treccani.it/enciclopedia/societa-dell-informazione>.

mundësi të jashtëzakonshme për më shumë se një miliard njerëz që e përdorin atë. Trajtimi i informacionit dhe përpunimi i njohurive janë bërë burimi kryesor i punësimit, pra informacioni dhe njohuritë për këtë arsye janë lëndët dhe produktet kryesore të shoqërisë sonë. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), rritja e përdorimit të internetit dhe hapja e tregjeve të telekomunikacionit kanë revolucionarizuar jetën e përditshme të qytetarëve në mbarë botën gjatë 30 viteve të fundit duke sjellë avantazhe dhe përfitime.

Bota është gjithnjë e më shumë një qendër e madhe, ku komunikimet me brez të gjerë dhe teknologjia janë çelësi i suksesit të tregtisë, të rritjes ekonomike dhe zhvillimit. Lehtësimi në rritje i shkëmbimit të informacionit, redukton kohën dhe koston e aksesit, përveç kësaj, duke siguruar përfitime të mëdha në mjedis nga reduktim radikal i konsumit të letrës. Shoqëria e informacionit dhe përfshirja në të është kërkesë masive, pasi njerëzit janë duke përjetuar të mirat e saj sot nëpërmjet një sërë zbatimesh të saj. Përdorimi i email-it ishte vetëm fillimi. Të lundrosh në internet na con një hap më pranë. Nëse, nga ana tjetër, ne punojmë, edukohemi dhe komunikojmë përmes rrjeteve, atëherë ne jemi bërë tashmë anëtare të shoqërisë së informacionit⁹.

Ekzistenca e shoqërisë së informacionit, ka përfshirë një prezantim të aplikimeve të reja të cilat kanë sjellë avantazhe të padiskutueshme të tilla si rritja e prodhimit, ulja e koston së mallrave të prodhimit, si dhe produkte dhe shërbime të reja konkurruese. Aspekti më i rëndësishëm i shoqërisë së informacionit është lehtësia që ajo ka krijuar në komunikim, e cila në thelb çon në një reduktim të hendekut kulturor. Njerëz nga kultura të ndryshme, janë në gjendje të punojnë me njëri tjetrin dhe të ndajnë ide pavarësisht nga prejardhje e tyre kulturore. Gjithashtu zhvillime pozitive ka dhe në fusha të tjera të tilla si edukimi, puna, ambjenti, kultura etj. Por shoqëria e informacionit ka sjellë dhe apekte negative. Si fillim ne duhet të përballemi me format e reja të krimit, të tilla si krimi kibernetik apo shkeljet e të dhënave personale dhe pronës intelektuale. Mbrojtja e privatësisë tonë është një çështje tjetër shumë e rëndësishme që duhet të merret parasysh. Nëpërmjet shoqërisë së informacionit, një mbingarkesë e të dhënave negative, mund të

kthehet në një faktor destruktiv social, në qoftë se ajo përdoret në mënyrë të pakontrolluar. Shpërndarja e përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme në rrjete të ndryshme, si prostitucioni i fëmijëve, mashtrimi elektronik si dhe aktivitete të tjera të ngjashme, janë transferuar nga rrugët në ekranet tona të kompjuterit¹⁰. Gjithashtu duhet të trajtohet hendeku digjital midis atyre që janë në gjendje të marrin pjesë në shoqërinë e informacionit dhe atyre që nuk janë në gjendje të bëhen pjesë saj. Në fakt, shoqëria e informacionit, me universalitetin dhe ndërveprimin e infrastrukturës dhe shërbimeve, sjell me vete një mori të tërë problemesh që duhet domosdoshmërisht të monitorohen dhe, kur është e mundur, të zgjidhen, me qëllim që të vlerësojmë avantazhet e panumërta dhe përfitimet që teknologjitë e reja mund të sjellin në jetën e qytetarëve, pa pasur nevojë të mbahet barra e rreziqeve të shumta që paraqet informatizimi. Sot po përballemi me ndryshime të rëndësishme të projektuara për të transformuar rrënjësisht kulturën dhe traditat e gjithë komunitetit dhe të cilat kërkojnë domosdoshmërisht një rishqyrtim të rregullave, zakoneve dhe të vetë traditave. Bizneset, administrata, profesionistët, por në përgjithësi të gjithë qytetarët janë në rrjet, ata ndajnë anët pozitive dhe negative dhe duhet t'u përshtaten ndryshimeve teknologjike për të shmangur izolimin e plotë. Tashmë komunikohet me e-mail, nënshkruhen kontrata on-line, arkivohen të dhëna, shkëmbehen të dhëna, dërgohen dhe të merren dokumente elektronike, kontrata, deklarata, përtej çdo pengese fizike. Përballë këtyre ndryshimeve, ligjvënësit, qeveritë e vendeve dhe juristët kanë detyrën e vështirë për tu ofruar dhe garantuar qytetarëve siguri ligjore, për tu mundësuar atyre që të përdorin teknologjitë e reja për të arritur pjesëmarrje më të madhe në jetën demokratike (nivele më të mirë të shërbimeve të ofruara nga administrata publike, shfaqje të vullnetit politik dhe elektoral për të lehtësuar zgjedhjet, për shembull, me votim elektronik) dhe për të shmangur, siç po ndodh kohët e fundit, efektin e kundërt (për shembull hendekun digjital).

Shoqëria e informacionit, dimensionin ligjor dhe institucional në Shqipëri

Shoqëria e informacionit është formë e re e të jetuarit edhe në shoqërinë shqiptare, ku shërbimet universale dhe barazia në aksesin e informacionit së bashku me sistemet dhe

⁹ Polyviou Z, The Information Society: advantages and disadvantages Essay, Aberystwyth University of Wales, Nicosia, Cyprus 2007, në dispozicion në http://eprints.rclis.org/10078/1/Information_Society._Aberystwyth.pdf.

¹⁰ Po aty, faqe 6.

infrastrukturën e zhvilluar të komunikimeve elektronike kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik, zbutjen e varfërisë dhe standarte më të mira të jetës. Praktikant ndërkombëtare tregojnë ndikim pozitiv të TIK-ut në zhvillimin e shoqërisë moderne, që manifestohet në morinë e mënyrave për akses në informacion si dhe burimeve informative publike në të gjitha aktivitetet shoqërore si: e-demokraci, e-qeverisje, e-shërbime, e-biznes, e-ekonomi, e-kulturë, e-shëndetësi, e-edukim etj. Ndërtimi i kësaj shoqërie të re informacioni ka si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor duke u mbështetur në drejtësi sociale, barazi të mundësive, liri, respektimin e dallimeve kulturore, pjesëmarrje civile dhe përparim shkencor duke shfrytëzuar teknologjinë informative dhe komunikuese në të gjitha sferat e jetës sociale. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) përbën një faktor kyç për formimin, ndërtimin dhe zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Politikant në fushën e infrastrukturës synojnë nxitjen e zhvillimit të infrastrukturës së TIK në mënyrë që ajo të jetë e disponueshme në kushte të barabarta, jo diskriminuese dhe me çmime të përballueshme, në mënyrë që të gjithë qytetarët të përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike. Shqipëria në rrugën e saj të nisur drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, ka ndërmarrë një sërë reformash të nevojshme për t'u afruar sa më shumë me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Modeli evropian i zhvillimit është modeli i një ekonomie të bazuar në njohuritë dhe në shoqërinë e informacionit. Nën këtë shembull dhe atë të Strategjisë së Lisbonës për një Evropë elektronike, vendet e Evropës Juglindore nënshkruan në Tetor të vitit 2002 një axhendë të përbashkët *eSEE¹¹ (electronic South Eastern Europe)* duke e parë modernizimin dhe përdorimin e teknologjive të reja, si dhe mundësitë për zhvillim që ato ofrojnë si një rrugë të shpejtë zhvillimi. Shqipëria ka rikonfirmuar angazhimin e saj për të ecur drejt rrugës së funksionimit të një ekonomie të bazuar në njohuritë dhe krijimin e një shoqërie të informacionit, përmes nënshkrimit në tetor të vitit 2007 të *eSEE Agenda+*¹² së bashku me

vendet e tjera të Evropës Juglindore. Kjo axhendë e përbashkët rajonale u nënshkrua nën frymën e planit të veprimtari të Bashkimit Evropian *i2010 për shoqërinë e informacionit*. Angazhimet e marra në këto dy dokumenta përbëjnë një sfidë të madhe për Shqipërinë, nëse marrim parasysh gjendjen aktuale të zhvillimit të sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në Shqipëri. Në analogji me politikant dhe prioritetet e BE-së, zhvillimi i TIK dhe axhenda digjitale janë pjesë e programit të qeverisë shqiptare nga viti 2013 deri në ditët e sotme. Programi shikonte zhvillimin e TIK dhe e-shërbimet të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Në programin e qeverisë gjatë viteve 2015-2020 fokusi i qeverisë konsistonte në 3 drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshme¹³: Së pari, shtimin dhe promovimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të inisiativës Open Government Partnership. Së dyti, për përdorimin e TIK në edukim për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë. Politikant do të jenë të orientuara drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve njerëzore në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve dhe të promovohet zhvillimi i ofruesve të shërbimeve. Në këtë mënyrë do të nxitet krijimi i vendeve të punës për të rinjtë, të cilët mund të punësohen në tregun shqiptar, rajonal e me gjerë. Së treti, konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit ka qenë i kushtëzuar në mënyrë të veçantë nga përshtatja e legjislacionit përkatës të nevojshëm. Janë hartuar dhe miratuar në përputhje me angazhimet e marra në MSA një sërë ligjesh të rëndësishme në fushën e shoqërisë së informacionit: Ligji Nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik"; Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008, i ndryshuar "Për mbrojtjen e të dhënave personale"; Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për prokurimet publike", që realizon mundësinë e prokurimit elektronik; Ligji Nr. 9723, datë 3.5. 2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; Ligji Nr.

¹¹ Shih <http://www.eseeinitiative.org/>.

¹² Vendet e Evropës juglindore, përveç Shqipërisë që kanë marrë pjesë në firmosjen e dokumentit janë Kroacia, Serbia, Bosnje Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Moldavia dhe Misioni i përkohshëm

i OKB-së në Kosovë, në emër të Kosovës në përputhje me Rezolutën 1244.

¹³ Shih https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia_Axhenda_Dixhitale_e_Shqiperise_2015-2020.pdf

9918, datë. 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Në fushën e krimit kibernetik Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën për Krimin Kibernetik në vitin 2002 dhe ka reflektuar në Kodin Penal dhe Kodin e Procedures Penale kërkesat e kësaj konvente¹⁴. Në programin e Qeverisë, sipas Agjendës Digjitale 2022 - 2026 është përcaktuar se Qeveria do të punojë në disa drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshme. Më specifikisht, synohet: një akses i sigurt, i shpejtë dhe i besueshëm në internet për të gjithë, qytetarët, bizneset dhe qeverinë, një shtet digjital që ofron shërbime më të mira digjitale dhe me një nivel të lartë sigurie dhe besueshmërie për qytetarët, zhvillimi i aftësive digjitale, forcimi dhe përfundimi i inovacionit digjital, rritja e kapaciteteve/nivelet të sigurisë kibernetike, etj¹⁵.

Gjithashtu krijimi i shoqërisë së informacionit kërkon vëmendje të veçantë nga ana e institucioneve publike. Institucionet publike duhet të përcaktojnë kushtet e nevojshme për të përsheptuar proceset e përfshirjes aktive të sektorit privat dhe publik për të diskutuar rregullimet e reja, si dhe implementimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjive të ndryshme kombëtare të ndërmarra në vitet e fundit. Institucionet qeveritare luajnë një rol udhëheqës në termat e legjislacionit lidhur me shoqërinë e informacionit për rregullimin minimal në interesin publik dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve; zhvillimin e politikave për të nxitur veprimtari dhe projekte me rëndësi kombëtare; pjesëmarrjen në marrëveshje ndërqeveritare për të arritur objektiva global dhe luftuar krimin ndërkombëtar¹⁶.

(Agjencia Shqiptare e Ofrimit të Shërbimeve publike të Integuara) ADISA është krijuar prej nëntorit 2014 dhe ka filluar aktivitetin e saj në dt. 7 Tetor 2016 dhe shërben si pike reference informacioni për më shumë se 1000 shërbime publike nga 50 Institucione.

Misioni i saj është të ofroj një model të ri dhe të integruar të shërbimeve publike, duke vendosur në qendër qytetarin, si dhe qendrave të shërbimeve publike të integruara me një ndalesë (one-stop-shop), për shërbimet që kryhen nga institucionet dhe agjencitë e

qeverisë qendrore dhe/ose të njësive të qeverisjes vendore sipas legjislacionit në fuqi ose marrëveshjeve përkatëse¹⁷.

Shërbime që mbështeten mbi sisteme tërësisht ose pjesërisht të digjitalizuara që ofrohen prej disa vitesh janë: regjistrimi i pasurive të paluajtshme, lëshimi i pasaportave dhe kartave të identitetit, regjistrimi dhe licensimi i bizneseve etj. Gjithashtu AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) objektivin kryesor të veprimtarisë së saj ka zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. AKSHI ka zhvillur një platform on line e-Albania, e cila ofron shërbime on line dhe për shumë të tjera jep informacion. Këto iniciativa dhe veprime të ndërmarra, koordinimi dhe përafrimi i tyre janë në përputhje me nevojën për të siguruar përdorimin eficient të këtyre sistemeve.

Portali e-Albania shërben si një pikë e vetme kontakti për shërbimet e qeverisë, duke ndihmuar përmirësimin e aksesit në informacion për publikun e gjerë. Portali unik qeveritar shumëfunksional e-albania.al administrohet dhe zhvillohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe shërben si një portë nëpërmjet së cilës çdo person i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit, shërbime elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri. Tashmë, procedurat janë më të thjeshta dhe veprimet e kryera online përmes një kompjuteri, tableti apo smartfoni, gjithnjë duke përdorur platformën e-albania, mundësojnë edhe shkarkimin në kohë reale të dokumenteve me vlerë ligjore dhe printimin e tyre përmes një printeri e një letre të zakonshme. Portali qeveritar e-Albania është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë mbi të cilën mundësohet ndërveprimi me sistemet elektronike të institucioneve publike që mundëson komunikimin midis bazave të të dhënave shtetërore, me qëllim ofrimin e shërbimeve elektronike.

Mund të themi që e-Albania është është një zyrë me një ndalesë për shërbimet online të administratës publike në 24 orë në 7 ditë të javës. e-Albania vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare, duke shërbyer kështu si një pikë e vetme hyrëse për qytetarët 24/7 dhe është e lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit që është arkitektura themelore që

¹⁴ Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit 2008-2013.

¹⁵ <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/vendim-2022-06-01-370-Agjenda-Digjitale-e-Shqiperise-22-26-dhe-plani-i-veprimit.pdf>

¹⁶ Strategjia Axxhenda Dixhitale e Shqipërisë 2014-2020.

¹⁷ <https://www.adisa.gov.al/misioni/>

lejon ndërveprimin midis 60 sistemeve elektronike të institucioneve publike.

Prej vitit 2020, ka filluar një proces i ri për shërbimet publike, ai i ofrimit të aplikimeve për shërbime publike për qytetarët dhe bizneset vetëm online. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës e albania dhe janë punonjësit e administratës publike ata që mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet shtetërore tani përdoren dhe ripërdoren, duke i çliruar qytetarët nga barra e grumbullimit të tyre fizikisht në letër në sportelet e shtetit.

Bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit (TIK) gjatë vitit 2023, të realizuar nga INSTAT vihet re që në vitin 2023 të gjitha kategoritë për kontaktet elektronike nëpërmjet internetit me autoritetet publike dhe disa shërbime publike, si faqet e internetit në lidhje me detyrimet e qytetarëve të drejtat, dokumentet zyrtare, shërbimet arsimore publike, shërbimet e shëndetit publik kanë shënuar rritje.

Një ndër sfidat më të mëdha është ofrimi i shërbimeve moderne qytetarëve dhe bizneseve dhe përdorimi i TIK në të gjitha fushat. Janë bërë përpjekje të vazhdueshme gjatë kësaj dekade, dhe pas publikimit të raportit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për zhvillimin digjital të vendeve anëtare, vihet re që Shqipëria renditet në vendin e tetë në Europë dhe në të 19-tin në botë lidhur me shërbimet publike online¹⁸.

Progres Raporti i Komisionit Evropian 2022 për Shqipërinë thekson se zhvillimi aktual i fushës së shoqërisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike ka përcjellë një progress të moderuar dhe evidenton suksesin e qeverisë shqiptare të implementuar nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në zhvillimin e arritur në fushën e qeverisjes elektronike dhe realizimin e plotë të shërbimeve online në një kohë të shpejtë¹⁹.

Refleksione përmbyllëse

Si përfundim mund të themi se shoqëria e informacionit është konteksti në të cilën teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit luajnë një rol themelor në zhvillimin e aktiviteteve të njeriut. Këto teknologji shërbejnë për të prodhuar dhe për të komunikuar, në formë dixhitale, mesazhe, imazhe, tekste, muzikë, filmime, dhe kështu me radhë. Në terma më të përgjithshëm, pjesa më e

madhe e informacionit dhe njohurive mund të riprodhohet apo të gjenerohet, në mënyrë dixhitale dhe me kosto më të ulët. Pra shoqëria e informacionit është një shprehje, e bërë tashmë shumë popullore, që përdoret për përcaktimin e një nga karakteristikave më të rëndësishme të shoqërisë, përkatësisht qendësia së fituar nga informacioni dhe teknologjitë e reja të komunikimit. Karakteristikë e saj është aftësia për të sjellë së bashku një numër të pakufizuar të përdoruesve, përtej kufijve hapësinorë-kohorë, dhe vendosja në dispozicion e një sasive të jashtëzakonshme të informacionit. Koncepte të tilla si shoqëria e dijes, shoqëria e informacionit, shoqëria e internetit, shoqëria postindustriale, shoqëria postmoderne, etj tregojnë se ekziston një diskutim i gjallë në doktrinën mbi karakterin e shoqërisë bashkëkohore dhe rolin që teknologjitë e informacionit dhe komunikimit luajnë në të. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), rritja e përdorimit të internetit dhe hapja e tregjeve të telekomunikacionit kanë revolucionarizuar jetën e përditshme të qytetarëve në mbarë botën gjatë 30 viteve të fundit duke sjellë avantazhe dhe përfitime. Bota është gjithnjë e më shumë një qendër e madhe, ku komunikimet me brez të gjerë dhe teknologjia janë çelësi i suksesit të tregtisë, të rritjes ekonomike dhe zhvillimit. Por shoqëria e informacionit ka sjellë dhe apekte negative. Si fillim ne duhet të përballemi me format e reja të krimit, të tilla si krimi kibernetik apo shkeljet e të dhënave personale dhe pronës intelektuale. Mbrojtja e privatësisë tonë është një çështje tjetër shumë e rëndësishme që duhet të merret parasysh. Nëpërmjet shoqërisë së informacionit, një mbingarkesë e të dhënave negative, mund të kthehet në një faktor destruktiv social, në qoftë se ajo përdoret në mënyrë të pakontrolluar. Shpërndarja e përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme në rrjete të ndryshme, si prostitucioni i fëmijëve, mashtrimi elektronik si dhe aktivitete të tjera të ngjashme, janë transferuar nga rrugët në ekranet tona të kompjuterit. Gjithashtu duhet të trajtohet hendeku digjital midis atyre që janë në gjendje të marrin pjesë në shoqërinë e informacionit dhe atyre që nuk janë në gjendje të bëhen pjesë saj. Në fakt, shoqëria e informacionit, me universalitetin dhe ndërveprimin e infrastrukturës dhe shërbimeve, sjell me vete një mori të tërë problemesh që duhet domosdoshmërisht të monitorohen dhe, kur është e mundur, të zgjidhen, me qëllim që të vlerësojmë avantazhet e panumërta dhe përfitimet që teknologjitë e reja mund të sjellin në jetën e qytetarëve, pa pasur nevojë të mbahet

¹⁸ Shih <https://akshi.gov.al/sherbimet-digjitale-okb-shqiperia-e-8-ta-ne-europe-e-19-ta-ne-bote/>

¹⁹ Shih <https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>

barra e rreziqeve të shumta që paraqet informatizimi. Sot po përballemi me ndryshime të rëndësishme të projektuara për të transformuar rrënjësisht kulturën dhe traditat e gjithë komunitetit dhe të cilat kërkojnë domosdoshmërisht një rishqyrtim të rregullave, zakoneve dhe të vetë traditave. Bizneset, administrata, profesionistët, por në përgjithësi të gjithë qytetarët janë në rrjet, ata ndajnë anët pozitive dhe negative dhe duhet t'u përshtaten ndryshimeve teknologjike për të shmangur izolimin e plotë. Tashmë komunikohet me e-mail, nënshkruhen kontrata on-line, arkivohen të dhëna, shkëmbehen të dhëna, dërgohen dhe të merren dokumente elektronike, kontrata, deklarata, përtej çdo pengese fizike. Përballë këtyre ndryshimeve, ligjvënësit, qeveritë e vendeve dhe juristët kanë detyrën e vështirë për tu ofruar dhe garantuar qytetarëve siguri ligjore, për tu mundësuar atyre që të përdorin teknologjitë e reja për të arritur pjesëmarrje më të madhe në jetën demokratike (nivele më të mirë të shërbimeve të ofruara nga administrata publike, shfaqje të vullnetit politik dhe elektoral për të lehtësuar zgjedhjet, për shembull, me votim elektronik) dhe për të shmangur, siç po ndodh kohët e fundit, efektin e kundërt (për shembull hendekun digjital).

Në vitet e fundit politikati mbi teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit janë bërë dhe një nga pikat strategjike të planit evropian për shoqërinë e informacionit, e cila ka identifikuar në teknologjitë moderne, një mjet të rëndësishëm për zhvillimin shoqëror-ekonomik, për të promovuar qeverisjen e mirë dhe demokracinë në të gjitha nivelet. Bashkimi Evropian ka përditësuar linjat bazë përmes miratimit të normave ligjore në fushën e shoqërisë së informacionit dhe përmes formulimit të planeve të veprimit të quajtura e-Europe, për të lehtësuar ndërtimin e një

shoqërie moderne të shtrirë në të gjithë shtetet anëtare, e karakterizuar nga përdorimi masiv i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në të gjitha degët e shoqërisë, duke lehtësuar aksesin në teknologjitë e reja për të gjithë qytetarët.

Në veçanti planet e-Europe përmbajnë udhëzime për e-government, e-learning, e-democracy, e-health, e-business, e-procurement, apo thënë ndryshe për qeverisjen elektronike, arsimin në distancë, kujdesin shëndetësor online, tregtinë elektronike, prokurimet publike on-line, votimin në distancë, etj. Suksesi i këtyre planeve është i lidhur me veprimet e ndërmarra nga shtetet anëtare, të cilët, të nxitur nga Bashkimi Evropian, dhe të vetëdijshëm për rëndësinë dhe përfitimet që teknologjia ofron, kanë filluar politikatat e tyre duke përcaktuar objektivat dhe strategjitë, përpunimin e planeve të zhvillimit dhe masat për të hequr pengesat legjislativë që pengojnë përhapjen dhe shfrytëzimin e këtyre instrumenteve.

Shqipëria është duke hedhur hapa të rëndësishëm në këtë aspekt. Në programin e Qeverisë, sipas Agjendës Digjitale 2022 - 2026 është përcaktuar se Qeveria do të punojë në disa drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshme. Më specifikisht, synohet: një akses i sigurt, i shpejtë dhe i besueshëm në internet për të gjithë, qytetarët, bizneset dhe qeverinë, një shtet digjital që ofron shërbime më të mira digjitale dhe me një nivel të lartë sigurie dhe besueshmërie për qytetarët, zhvillimi i aftësive digjitale, forcimi dhe përf forcimi i inovacionit digjital, rritja e kapaciteteve/nivelet të sigurisë kibernetike, etj.

Literaturë

- *Ligji nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë"*
- *Agjenda Digjitale Shqipëri 2022–2026, Vendim Nr. 370, datë 1.6.2022 Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale "Agjenda Digjitale e Shqipërisë" dhe të Planit të Veprimit 2022–2026*
- *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017 Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*

- *Ligj nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike"*
- *Ligji Nr.9880, datë 25.2.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik", i ndryshuar*
- *Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar*
- *Ligji Nr.9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*
- *Ligji Nr.10 273, datë 29.4.2010 "Për Dokumentin Elektronik", i ndryshuar*
- *Webster F, Theories of the Information Society. Cambridge: Routledge, p 259, (2002).*

- Moore N, *The information Society, Policy Studies Institute, United Kingdom, Chapter 20, faqe 271, në* <https://files.dnb.de/EDBI/www.unesco.org/webworld/wirerpt/wirenglish/chap20.pdf>
- Polyviou, Zachos, *The Information Society: advantages and disadvantages Essay, Aberystwyth University of Wales, Nicosia, Cyprus, 2007, në dispozicion në* http://eprints.rclis.org/10078/1/Information_Society_Aberystwyth.pdf.
- *Verso Una Società Europe Dell'informazione. La Politica e Le Iniziative Europee nel Settore Delle Tecnologie Dell'informazione E Della Comunicazione, Notiziario dall'Europa, Numero speciale/2, Comune di Forlì, Progetti Europei e Relazioni Internazionali, në dispozicion në* <http://www.puntoeuropa.eu/Newsletter/2009/tematico2informazione.pdf>.

GJUHËSI-ALBANOLOGJI

The symbol and Albanian literature

Edlira DHIMA

University of Vlora "Ismail Qemali"

Faculty of Human Sciences

Department of Albanian Language and Literature, Vlora, Albania

edadhima@gmail.com

Abstrakt

Studimet e panumërta dhe më të rëndësishmet që janë bërë në lidhje me kompleksitetin e simbolit, në epoka të ndryshme kanë sjellë edhe interpretime të shumta. Të lidhura me kategori të estetikës, letërsisë, filozofisë së gjuhës, të interpretimit ato kanë bërë të mundur ta diferencojnë atë me konceptet e përfaqësuara me të cilat e kanë ngatërruar, qysh nga antikiteti grek. Terma si miti, shenja, alegoria, ikona, arketip, e mjaft të tjerë shpeshherë janë konsideruar sinonime të tij. Shumë teoricienë të mitit dhe kritikë e lidhin mitin si gjuhë simbolike me ritualin, disa të tjerë e flakin ritualin nga simbolet mitike. Shkrimtarët e shekullit të 20-të, mbi "rrënojat" e mitit të lashtë, ndërtuan mitin e ri. Sikundër e gjithë poezia e traditës shqiptare, poezia e sotme shqipe ka pasur ndikim të fuqishëm nga rrethanat e jashtme shoqërore dhe historike. Në pjesën më të madhe ajo i njeh faktet historike dhe shpesh drejtohet prej tyre duke u bërë jehonë dhe duke i përjetësuar në vargje. E dominuar nga faktet e realitetit politik, i njeh ato ligje, u bën jehonë dhe i përjetëson në vargje. Ka qenë simboli që e ka shpëtuar këtë poezi duke e nxjerrë nga prangat e deklaratës dhe duke e çuar drejt sugjestionit. Për një kohë të gjatë, letërsia shqipe ka dalë nga natyra e saj iracionale si pasqyrë e realitetit, e çliruar prej mitit. Lirimi prej tij, shpallja luftë e ka mënjanuar atë si diçka që i takon pjesës konservatore të shoqërisë. Kështu Martin Camaj, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Din Mehmeti, Bilal Xhaferri, Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, do të fusin mitin në poezi dhe simbolin si gjuhë të komunikimit.

Fjalët kyçe: *simbol, mit, alegori, mjegullnajë, poezi, letërsi shqipe, realitet, gjuhë, imagjinatë*

Abstract

The countless and most important studies that have been done regarding the complexity of the symbol, in different eras, have also brought numerous interpretations. Associated with the categories of aesthetics, literature, philosophy of language, interpretation, they have made it possible to differentiate it from the related concepts with which they have confused it, since Greek antiquity. Terms such as myth, sign, allegory, icon, archetype and many others are often considered its synonyms. Many myth theorists and critics associate myth as a symbolic language with ritual, while others discard ritual from mythic symbols. The writers of the 20th century, on the "ruins" of the ancient myth, built the new myth. Like all the poetry of the Albanian tradition, today's Albanian poetry has been strongly influenced by external social and historical circumstances. For the most part, she knows the historical facts and is often guided by them, echoing them and perpetuating them in verses. Dominated by the facts of political reality, it knows those laws, echoes them and perpetuates them in verses. It was the symbol that saved this poem by taking it out of the shackles of the statement and leading it towards suggestion. For a long time, Albanian literature has emerged from its irrational nature as a mirror of reality, freed from myth. The release from him, the declaration of war has removed him as something that belongs to the

conservative part of society. Thus, Martin Camaj, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Din Mehmeti, Bilal Xhaferri, Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, will introduce myth into poetry and symbols as a language of communication.

Keywords: *symbol, myth, allegory, nebula, poetry, Albanian literature, reality, language, imagination*

1. Introduction

The countless and most important studies that have been done regarding the complexity of the symbol, in different eras, have also brought numerous interpretations. Associated with categories of aesthetics, literature, philosophy of language, interpretation, they have made it possible to differentiate it from the approximate concepts with which they have confused it, since Greek antiquity.

The etymology of the word "symbol" can be found in the old Greek *symbolon*, which means "sign" and was originally related to the meaning of the identification sign.

The well-known researcher Norman Friedman connects it with the Greek word "*Symballein*" which means "to unite" and the name "*Symbolon*", which means sign. While in literary use, Friedman sees it as a union of the image with the idea that is evoked, of the material with what means more or something else, the nonmaterial.¹

Terms such as myth, sign, allegory, icon, archetype, and many others are often considered its synonyms.

2. Symbol relations with semantic fog and interpretation

One of the basic characteristics of the symbol, which has prompted one of the best connoisseurs of its structure, Tsvetan Todorov, is that of semantic fog. Naturally, questions arise such as: "Why the symbol and not the clear and visual sign language? What is it that cannot be said through clear denotations and what is it that

*cannot be said through clarity but requires a fog of meaning so that the whole can be said?"*²

According to researcher Laland: "*The symbol is about many things and nothing. In short, it is not known what it is.*"³ As a complex multiple structure, its complexity lies in the necessity of indefinability.

*"Nebula as a mechanism of meaning multiplication, which only by remaining so, nebulous until the end, realizes the circle of symbolic communication."*⁴ – claims researcher Bahri Çapriqi.

Symbols are of two types in terms of their ability to produce multiple interpretations: 1. That do not provide many interpretation possibilities because they are loaded with linguistic meaning; 2. Those who give unlimited encouragement and who have a small load of linguistic meaning.

Umberto Eco does not mean only the production of the text in a "symbolic way". It is not only a way of text production, but also a way of interpreting any text through pragmatic solutions. "*I want to interpret this text symbolically. It is a text mode of use.*"⁵

3. Symbol language and myth

Many myth theorists and critics associate myth as a symbolic language with ritual, while others discard ritual from mythic symbols. In his work *Anatomy of Criticism*, Northrop Frye defines myth as a union of ritual and dream: "*...the union of ritual and dream in the form of verbal communication is myth*".⁶

According to Sartre "*...poets create myth*"⁷. The language of symbols is also the language of myth. Mythical symbols have no

¹ Norman Friedman, *Symbol*, of Umberto Eco, *Symbol*, People's book, Alfa, Belgrade, 1995, pg. 79.

² Basri Çapriqi, *The symbol and its rivals*, Kosova PEN Center, Pristine, 2005, pg. 25.

³ Umberto Eco, *Rear structure*, Dukagjini, Peja, 1996, pg. 284.

⁴ Basri Çapriqi, *The symbol and its rivals*, Kosova PEN Center, Pristine, 2005, pg. 27.

⁵ U. Eco, *Semiotics and the Philosophy of Language*, The Macmillan Press Ltd, Basingstoke, Hampshire, 1971 2xs and London, 1984. pg.163.

⁶ Northrop Frye, *Anatomy of Criticism*, Princeton, New Jersey Princeton, University Press, 1990, pg. 106.

⁷ William Righer, *Myth and Literature*, Routledge & Kegan Paul, London and Boston, 1975, pg. 40.

historical reality either. Myth does not recognize the category of time, as it is recognized by the historical consciousness that makes clear the difference between times, separated by sharp boundaries.

Explaining the nature of the language of symbols, researcher Erich Fromm elevates it to the zenith of imaginative and creative human activity. *"Different peoples create different myths, just as different peoples see different dreams. Regardless of these changes, myths and dreams have a common element, they are all "written" in the same language, in the "language of symbols."*⁸

The writers of the 20th century, on the "ruins" of the ancient myth, built the new myth. It was precisely the mythical dimension, the one that made the difference between the forms of imagination and the real ones. Named as the supreme tool of the literary imagination, the myth: *"...was opposed to narrow mimetic forms."*⁹

*"In his judgment of myth and dream, From has made clear some basic elements of the language of symbols. They are created by different peoples and different cultures are communicating naturally because they have a language that connects them. The symbolic language of myths and dreams overturns the logic of things we know in everyday life, violates the categories of time and space, and has its own syntax that differs from the language of everyday communication, so you'll learn if you want to receive messages, from mythical symbols and from symbols emerging from the dark realm of dreams."*¹⁰

4. Albanian literature and symbols

For a long time, Albanian literature has emerged from its irrational nature as a mirror of reality, freed from myth. The release from him, the declaration of war has removed him as something that belongs to the conservative part of society.

The great writer Ismail Kadare will leave history and reality and enter the multidimensional world of myth and symbol. His myth is related to faith, the divine power of

the given word, with the irrational and subrational connections he makes with the world, with the individual, with philosophy.

*"Albanian poetry has been moved from the shackles of reality and from the hostage of history Lasgush Poradeci, who made the most spectacular leap from the second voice, which assumes the measure, across to the first voice, whereas Eliot says, the poet speaks to himself or to no one."*¹¹

Martin Camaj's poetry in the second half of the 20th century is related to the individual myth that the poet created over the traditional myth.

It radiated ambiguities even for the cultural environment itself where Albanian literature flourished and created great advantages for literary creativity that echoed reality and history, a literary production sometimes direct, sometimes allegorical.

Modern poetry in Kosovo will be presented with three big names: Azem Shkrelin, Rrahman Dedaj and Ali Podrimja. As the only possible interpretation that can be made to the symbolic mode comes the symbolic interpretation in which the text is interpreted as a symbol. Through the poems of the declaration, they have made the transition of the language to the spheres of the literary myth and the individual symbol thus returning the literary art to its multidimensional and polysemic nature. Here are some verses for illustration:

*Let my grass grow above my head
On my head let my grass grow
Let my grass on my head grow
Let it grow*

Let my grass grow above my head
(A. Shkreli)¹²

In a war with a power that necessarily remains hidden, a permanent war, that has no name but that tramples its shadow, according to Ali Podrimja there is only one way to triumph:

*You know nothing my friend
Why do I sing?*

⁹Still there, pg. 40.

¹⁰ Basri Çapriqi, *The symbol and its rivals*, Kosova PEN Center, Pristine, 2005, pg. 38.

¹¹ Basri Çapriqi, *The symbol and its rivals*, Kosova PEN Center, Pristine, 2005, pg. 56.

¹² Azem Shkreli, *Baptism of the word*, Renaissance, Pristina, 1971, pg. 47.

When they step on my shadow

*Bad times taught you
(When I beat the masters)*

*Until one
(When I defeated Gods)¹³*

For Podrimja, this war is not random, but fate, and through the myth in the poem, the Tale extends and narrates it as a journey to find salvation, but unfortunately the path to know God ends fatally:

*For centuries, people have been
wondering where Olympus is
Finally, they found him at the foot of a
fairy tale
Then they asked the god with a pine
tree and a candle
After many years
In God they investigated the snake¹⁴*

Even Rrahman Dedaj, following the contestation system, like Ali Podrimja tries to insert the spiritual chaos into a system of symbolic signs. He has found the knot of evil in his research which is related to a rude fall of the referee. In that evil hour, *Great Hour*:

*The Great Hour has fallen
And strange compass
He showed the poles by mistake

Mistaking the love of flowers

Who believed in clocks
Hanged love on nails

Who remains to pay?
He swore on the unspoken

The Great Hour has struck
And strange compass
He mistakenly showed the angels*

¹³ Ali Podrimja, *Zari*, Renaissance, Pristina, 1970, pg. 49.

¹⁴ Ali Podrimja, *Torzo* (second edition), Renaissance, Pristina, 1979, pg. 72.

*And what we believed was messed up
By god we were punishing¹⁵.*

Conclusions

Like all the poetry of the Albanian tradition, today's Albanian poetry has been strongly influenced by external social and historical circumstances. For the most part, Albanian poetry knows the historical facts and is often guided by them, echoing and perpetuating them in verse.

Dominated by the facts of political reality, it knows those laws, echoes them and perpetuates them in verses.

It was the symbol that saved this poem by taking it out of the shackles of statement and leading it towards suggestion.

So many poets created the allegorical symbol, a type of symbol that approaches the emblem, but also leaves plenty of room for interpretation. Thus, symbols such as the eagle, blood, flag, stone, have been used by Albanian poets to build lasting and meaningful castles.

The density of the use of allegory, emblem explains both the creative consciousness of these poets, but also the external drivers of reality.

Precisely, it is the poets of the 60s, who will clearly separate the artistic linguistic text from the historical fact, towards the mythical symbol, building a more nebulous type of language, the language of suggestion.

Thus, Martin Camaj, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Din Mehmeti, Bilal Xhaferri, Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, will introduce myth into poetry and symbol as a language of communication. Ismail Kadare will take a step forward by extending the use of the symbol also in prose, in dimensions that cover the entire universe.

The symbols used by Camaj are original, unrepeatable creations. He does not exploit myth, but creates myth.

Literature

1. Ali Podrimja, *Torzo* (second edition), Renaissance, Pristina, 1979.

¹⁵ Rrahman Dedaj, *Untouchable things*, Renaissance, Pristina, 1980, pg. 15.

2. *Ali Podrimja, Zari, Renaissance, Pristina, 1970.*
3. *Azem Shkreli, Baptism of the word, Renaissance, Pristina, 1971.*
4. *Basri Çapriqi, The symbol and its rivals, Kosova PEN Center, Pristine, 2005.¹*
5. *Northrop Ali Frye, Anatomy of Criticism, Princeton, New Jersey Princeton, University Press, 1990.*
6. *Norman Fridman, Symbol, of Umberto Eko, Symbol, People's book, Alfa, Belgrade, 1995.*
7. *Rrahman Dedaj, Untouchable things, Renaissance, Pristina, 1980.*
8. *U. Eco, Semiotics and the Philosophy of Language, The Macmillan Press Ltd, Basinstoke, Hampshire, rg21 2xs and London, 1984.*
9. *Umberto Eco, Rear structure, Dukagjini, Peja, 1996.*
10. *William Righter, Myth and Literature, Routledge & Kegan Paul, London and Boston, 1975.*

Ndihmesa shkencore e prof. Bardhosh Gaçe me studimet bashkëkohore

Dr. Asime Feraj

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
FSHHD, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe
Ballkanistike
asimeferaj@gmail.com

Abstrakt

Punëtor i palodhur i shkencës dhe kulturës, prof. dr. Bardhosh Gaçe ka vëmendje të pandërprerë ndaj krijimtarisë letrare të autorëve të të gjithë brezave, por një shërbim të vlerët sjell me botimet e veta, nuk kalon asnjë vit pa botuar a ribotuar artikuj e studime të mirëfillta. Kjo veprimtari hulumtuese dhe botuese është e frytshme dhe dobiprurëse në shumë fusha, por më i mirënjohur dhe i spikatur është në lëmin e etnokulturës dhe historiografisë, duke na dhënë studime historiko-letrare të dobishme për kulturën, letërsinë dhe historiografinë shqiptare.

Ky hulumtues i gjerë, gërryes gjer në bezdisje i arkivave shtetërore dhe private, zhbirues dhe qetësiprshës në mbledhjen e kujtimeve dhe "copëzave të gjalla jete", sjell një kontribut të ri në vlerësimin e figurave historike, por edhe për letërsinë shqipe me gjinitë pak të lëvruara që ai paraqet. Mbi të gjitha, prof. Gaçe ka prirjen për debat shkencor mbi një varg çështjesh e problemesh historike e etnokulturore, dhe ka sjellë studime historiko-letrare me larmi tematike, të cilat meritojnë të dalin në dritë, për vlerat që mbartin në rritjen e ndërgjegjes dhe afirmimin e identitetit tonë kombëtar. Kjo anë e veprimtarisë së tij përbën objektin e këtij artikulli.

Fjalë kyç: studime historike, çështje kombëtare, hulumtime, arkiva, veprimtarë, kontribut shkencor

Abstract

A tireless worker in the fields of science and culture, Prof. Dr. Bardhosh Gaçe maintains uninterrupted attention to the literary creations of authors from all generations. Yet, his valuable contribution lies in his publications, as no year passes without him publishing or republishing articles and comprehensive studies. This research and publishing activity proves fruitful and beneficial in numerous fields, but it is most renowned and prominent in the realms of ethno-culture and historiography. He provides us with valuable historical-literary studies beneficial to Albanian culture, literature, and historiography.

This wide-ranging researcher, delving deep into both state and private archives, diligent in collecting memories and "vivid fragments of life," brings a fresh contribution to the evaluation of historical figures and to Albanian literature with the less explored genres he presents. Above all, Prof. Gaçe possesses a propensity for scholarly debate on a variety of historical and ethnocultural issues, and he has produced historical-literary studies on seldom-discussed topics, which deserve to be brought to light for the values they carry in fostering awareness and affirming our national identity. This aspect of his activity constitutes the subject of this article.

Key words: historical studies, national affairs, research, archive, activists, scientific contribution

Hyrje

Prof. dr. Bardhosh Gaçe i përket brezit që ka dhënë një kontribut të çmuar në Arsimin Universitar. Ai dallohet për punën mësimore e shkencore në disa dhjetëvjeçarë, por mbi të gjitha për njeri me virtyte të larta njerëzore. Profesori është një emër që gëzon respektin e pedagogëve të Universitetit "Ismail Qemali", miqve, shokëve dhe brezave të tërë studentësh. Me artikujt e mbajtur në konferenca dhe veprimtari të ndryshme ka tërhequr vëmendjen me seriozitetin, përkushtimin dhe përgatitjen shkencore, duke u bërë model frymëzues për më të rinjtë, por edhe një zë i respektuar dhe autoritet i njohur shkencor.

Me studimet dhe botimet e veta prof. Gaçe ka sjellë ndihmesë në shumë fusha si: letërsi, folklor, albanologji dhe etnologji, por jemi ndalur në lëmin e historiografisë ku duket se autori e ka shpallur qëllim të vetin, nxjerrjen në dritë të vlerave dhe të vërtetave të historisë së popullit tonë të lëna në harresë dhe ndriçimin e figurave atdhetare të lëna në heshtje.

Dashuria për vendin dhe për njerëzit e motivojnë autorin që të kapërcejë çdo vëshirësi në plotësimin e kësaj zbrazëtie me qëllimin për t'ia bërë të njohur brezit të kohës sonë dhe brezave të ardhshëm.

Nga studimi i materialeve të botuara prej profesorit, biem në një mendje me prof. Ilden Spasen kur shprehet se: "... një nga tiparet kryesore të B. Gaçes është vetia e tij e lindur për të hulumtuar, 'gërmuar', e 'eksploruar', në të fshehtat e historisë dhe kulturës shqiptare, për t'ua hequr pluhurin e kohës shumë ngjarjeve të rëndësishme kombëtare dhe figurave të ndritura, që kanë luajtur rol të madh në luftërat për liri, për emancipimin shoqëror, duke zbuluar njëkohësisht edhe trashëgiminë kulturore të transmetuar brez pas brezi në këngët popullore dhe muzikën polifonike, në përrallat, baladat dhe legendat e ndryshme, në gojëdhënat, duke ngritur gjithnjë lart e më lart karakterin burrëror, fisnik, atdhedashës, liridashës, arsimdashës dhe artdashës jo vetëm të vlonjatëve nga e ka prejardhjen dhe ku është gatuar e mëkuar që në fëmijërinë e vet, por të mbarë shqiptarëve nga Veriu në Jug, madje edhe më tej, ndër trevat shqiptare të Maqedonisë, në

Kosovë, të arvanitasve të Greqisë dhe arbëreshëve të Italisë."¹

Studimet dhe botimet e tij janë të shumta, por do të ndalemi në disa prej tyre, sa për të treguar rolin e Vlorës dhe vlonjatëve në proceset historike të jetës shqiptare të shek. XX.

Figura historike të trajtuara në veprat e prof. Bardhosh Gaçes

Pavarësia Kombëtare e Shqipërisë është një ngjarje e madhe, e cila ka lënë gjurmët e veta në Historinë tonë Kombëtare. Kjo ngjarje si dhe figura e Ismail Qemalit si shtetar dhe diplomat për gati një shekull kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve shqiptarë dhe të huaj, dhe nuk mund ta linte jashtë edhe prof. Bardhosh Gaçen. Me rastin e 100-Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, aktit më madhështor historik të shqiptarëve, profesori nxori librin publicistik-historik *"Ata që shpallën Pavarësinë Kombëtare"*, vepër dinjitoze e me kulturë të thellë në historiografinë tonë (i ribotuar disa herë) me dëshmi e materiale të reja, të pabotuara më parë, e kthejnë veprën në "një muze të gjallë të Pavarësisë Kombëtare"².

Në këtë vepër portretizohen me të dhëna apostujt e shqiptarisë që morën pjesë në Kuvendin Historik si përfaqësues nga të gjitha trevat e vendit. Në parathënien e librit autori, për të qenë afër së vërtetës, hulumton dhe jep të dhëna të hollësishme për kontekstin historik para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë. Në pjesën e parë autori përshkruan 84 portrete të delegatëve dhe disa personalitete që luajtën rol të veçantë në shpalljen e Pavarësisë, si dhe 7 mbledhje të Qeverisë së Vlorës. Përshkrimi i këtyre personaliteteve historike i ka kushtuar autorit një punë të stërmundimshme jo vetëm në arkiva dhe shtypin e kohës, por edhe duke gjurmuar në qytete, fshatra e krahina të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut e gjetkë, pasi një pjesë e tyre ishin mbuluar me pluhurin e harresës. Evidentues i përpiktë i momenteve më të rëndësishme të kësaj ngjarje

¹ Ilden Spase, "Bardhosh Gaçe- Etnologu, Studiuesi dhe Pedagogu", Tiranë, 2015, fq. 8.

² Stilian Adhami, "Bardhosh Gaçe- Etnologu, Studiuesi dhe Pedagogu", Tiranë, 2015, fq. 74.

madhore siç janë procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, botimet e gazetës së Qeverisë së Vlorës "Përlindja e Shqipërisë", prodhimi i pullës së parë postare, krijimi i Himnit Kombëtar dhe portreti i qëndistares së flamurit Marigo Pozio.

Në pjesën e dytë kemi kujtime nga personalitete të Kuvendit të Vlorës, marrë nga arkivat dhe revistat e kohës. Libri është plotësuar me një album, foto të Ismail Qemalit nga jeta dhe Shpallja e Pavarësisë, kurse pjesën e tretë dhe të katërt autori e ka pasuruar librin me të dhëna mbi Flamurin Kombëtar. Hulumtimet mbi gjurmët e Tij gjatë shekujve, mbi udhëtimin në ballë të çetave patriotike, si dhe mbi flamurtarët e ndjenjës kombëtare nga Skënderbeu deri tek Ismail Qemali, vijnë me një vërtetësi të pakontestueshme.

Profesori mbledh gjithçka me një dashuri të veçantë, me saktësi e seriozitet shkencor, por edhe përzgjedhës i ngjarjeve dhe figurave historike që dëshmon. I tillë është edhe Hamza Isai në librin monografik: **"Hamza Isai, Një jetë në shërbim të kombit"**, ku autori nëpërmjet hulumtimeve në gazetatat dhe revistat e kohës, në arkivat e muzeve, kujtimeve të bashkëkohësve ka ravijëzuar qartë portretin e Hamza Isait si vazhdues i rilindësve tanë "për dritë, dituri dhe përparim të Shqipërisë", por edhe të ngjarjeve dhe përpjekjeve të mëdha në trevën e Vlorës për Pavarësinë Kombëtare. Një kontribut i çmuar i autorit dhe një vlerë e rrallë janë dokumentet dhe dorëshkrimet, 41 të tilla, si letra, certifikata dhe deklarata, të cilat nxjerrin në dritë dhe zgjojnë nga letargjia një kohë të përhumur në mjegullat e kohës veprimtarinë e patriotit Hamza Isai dhe bashkëlufëtarëve të tij.

Monografia **"Rilindasi i Vlorës, Ibrahim Abdullahi"** shkruar në mënyrë dinjitoze nga prof. dr. Bardhosh Gaçe, mbështetur në dokumente dhe fotografi arkivale, por edhe në kujtimet e bashkatdhetarëve, përshkruan portretin historik dhe shoqëror të Ibrahim Abdullait dhe sfondin historik të ngjarjeve dhe lëvizjes kombëtare në Vlorë dhe më tej.

Autori ka pasqyruar tiparet dalluese nacionale, veprimtarinë e Tij energjike në shërbim të Atdheut dhe çështjes kombëtare, si dhe kontributin në proceset demokratike të kohës. Kryekatundar dhe kryetar i Klubit

Atdhetar "Labëria e Vlorës", Ibrahim Abdullahi bën përpjekje të mëdha për organizimin dhe forcimin e shtetit të pavarur shqiptar, në përballimin e situatave dramatike të jetës së kombit, në krah të Ismail Qemalit.

Me monografinë **"Arshi Selfo Dajlani, Një vatër kombëtare në Kaninë"** prof. dr. Bardhosh Gaçe rigjen e vendos në vendin e duhur edhe një emër tjetër vlonjat, një ndër familjet më zëmëdha siç është familja e Arshi Selfo Dajlanit nga Kanina; me rrënjë të thella në historinë kombëtare dhe me kontribute të çmuara në Lëvizjen Kombëtare dhe Shpalljen e Pavarësisë.

Në faqet e kësaj monografie, lexuesi i gjerë njihet edhe me marrëdhëniet që ka pasur Abdyl Frashëri në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me vlonjatët, himarjotët, lebërit dhe kaninjtë, si dhe takimet e Ismail Qemalit 1908-1912, me Vlorën, Kaninën e Labërinë. Vepra pasurohet jo vetëm me një bibliografi të pasur, por çdo punim mbështetet në dokumente origjinale, duke e bërë veprën një burim me vlerë dhe mundësi e pranueshme referimi për studiuesit e tjerë.

Një tjetër kontribut i profesorit është monografia **"Osman Haxhiu"**, që sipas akademik Shaban Demiraj, është një nga burrat më të shquar që ka nxjerrë Vlora, pas Ismail Qemalit, një nga figurat më të ndritura të historisë shqiptare, por padrejtësisht e mbetur në "harresë"³. Profesor Gaçe hulumton dhe sjell dokumente burimore me saktësi shkencore, si: artikuj nëpër gazetatat e kohës, telegrame, faksimile etj. Emri i Osman Haxhiut nuk është i padëgjuar edhe më herët. Ai del në disa prej botimeve për Luftën e Vlorës, 1920, por vendi që zë në këto botime nuk i përgjigjen veprimtarisë kombëtare, punës aq të çmuar të këtij atdhetari, dhe kontributit aq të vyer të këtij patrioti në kohë aq të vështira të historisë sonë kombëtare.

Përmes kujtimeve të bashkëlufëtarëve apo miqve të familjes, prof. Gaçe hedh dritë mbi veprimtarinë e guximshme të Osman Haxhiut, në shërbim të çështjes kombëtare. Veprimtari që vazhdoi edhe pas shpalljes së Pavarësisë si diplomat, politikan, prefekt e deputet, pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjes, si edhe

³ Shaban Demiraj, në parathënien e librit "Osman Haxhiu", fq. 3-8.

kryetar i "Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare", ku luajti rol të rëndësishëm në përgatitjen, drejtimin dhe fitoren e kryengritjes së armatosur, që sipas Isuf Luzajt *"Po të mos ishte Osman Haxhiu, nuk bëhej lufta e Vlorës, po të mos ishte Qazim Koculi nuk fitohej Lufta e Vlorës."*⁴

Në këtë monografi figura e Osman Haxhiut vlerësohet jo vetëm për veprimtarinë patriotike, por edhe për vlerat njerëzore. Në të gjithë veprën Osman Haxhiu paraqitet si njeri paqësor e rregulldashës, fjalurtë, shpirtpastër e patriot gjer në palcë.

Për ta ravigjzuar edhe më mirë këtë portret autori sjell vlerësime nga poetë, studiues dhe shkrimtarë të shquar të letërsisë shqipe. Një vlerësim të denjë për ndihmën e çmueshme në çështjen kombëtare, bën Dritëro Agolli, në artikullin "Një nga ahet e mëdhenj të pyjeve të Labërisë" ku thekson se: *"Labëria ka vërtet pak pyje, ka shumë shkëmbinj, gryka të thella, qafa malesh. Por Labëria ka shumë pyje figurash të shquara ... që janë kthyer në qereste për kalanë e historisë së luftës së popullit shqiptar"*.⁵

Edhe poeti ynë i madh, Fatos Arapi, e radhit Osman Haxhiun në një nga emrat dhe njerëzit më të dashur dhe të adhuruar në familjen e Toli Arapit: *"Ne jemi rritur me një dashuri të veçantë për Osman Haxhinë, këtë figurë emblematike të historisë shqiptare"*.⁶ Në këtë monografi zënë vend edhe vlerësimet e Petro Markos, i cili e paraqet Osman Haxhiun me tërë madhështinë e vet: *"... një figurë e gdhendur me mjeshtëri, kryeherë të epopesë së Vlorës, i lidhur ngushtë me Vlorën dhe Labërinë"*.⁷ Një pjesë e rëndësishme e librit është edhe kapitulli "Në krahët e këngës së popullit", ku janë mbledhur nga goja e popullit 44 këngë, në Brataj, Velçë, Kuç, Panaja etj., kushtuar Osman Haxhiut, si përkrahës i zjarrit të Ismail Qemalit dhe Luftës së Vlorës. Edhe pse kanë kaluar shumë vjet ai qëndron i gjallë në këngët e

popullit, në rrëfimet e njerëzve dhe i gdhendur në historinë shqiptare.

Studimi i gjerë dhe i hollësishëm **"Halim Xhelo, militant dhe ideolog revolucionar"**, nuk është sprovë e parë, por është ndër të parat punime me përmasa të mëdha dhe komplekse kushtuar jetës dhe veprimtarisë së një figure patriotike të rëndësishme siç është ajo e Halim Xhelos. Kjo "biografi dokumentare"⁸ është hartuar duke u mbështetur në burime arkivore, në shtypin e kohës, në kujtimet dhe arritjet e historiografisë sonë. Prof. Gaçe e përshkruan Halim Xhelon si veprimtar demokrat, "në krah të Fan Nolit"⁹, i cili përqafoi mendimin e përparuar të kohës dhe me kontribut edhe në gazetë europiane. Halim Xhelo shfaqet si një nga figurat më interesante të lëvizjes demokratike dhe revolucionare të viteve '20-'30 të shek. XX. Libri është një vepër serioze e përshkruar mbi një bazë njohjeje të gjithanshme e të plotë, të faktorëve historikë dhe shoqërorë, politikë dhe psikologjikë të kohës dhe mjedisit ku u rrit e u afirmua si një luftëtar patriot, demokrat dhe revolucionar. Bir i Labërisë, mishërim i cilësive më të mira të kësaj krahine me tradita luftarake dhe botë shpirtërore të pasur.

Njëzet kapitujt flasin për një vepër voluminoze dhe nxjerrin në pah momentet kyçe të heroit. Vend të rëndësishëm zënë lidhjet e forta me njerëzit, letërkëmbimi me figura të njohura historike dhe kulturore si: Avni Rustemi, Jani Minga, Shtjefën Gjeçovi, Marigo Pozion, Ali Kelmendin, Sejfulla Malëshovën, Kozma Nushin, Petro Markon, etj. "Është pikërisht komunikimi me njerëzit që e bënë atë një figurë të dashur e të respektuar"¹⁰. Për rëndësinë e kontributit në vlerësimin e Halim Xhelos flasin emra të njohur të letrave shqipe si

⁴ Isuf Luzaj, *"Përpyjekja e viganëve në Luftën e Vlorës"*, në "Osman Haxhiu", fq. 264.

⁵ Dritëro Agolli, *"Osman Haxhiu, një nga ahet e mëdhenj të pyjeve të Labërisë"*, në "Osman Haxhiu", fq. 291.

⁶ Fatos Arapi, *"Lufta e Vlorës dhe Osman Haxhiu"*, në "Osman Haxhiu", fq. 289.

⁷ Halo Abazi, *"Osman Haxhiu dhe kapedanët e Labërisë në romanin 'Ultimatum' të Petro Markos"*, në "Osman Haxhiu", fq. 276.

⁸ Nasho Jorgaqi, *"Mbi biografinë 'Halim Xhelo' të studiuesit Bardhosh Gaçe"* në "Bardhosh Gaçe- Etnologu, Studiuesi dhe Pedagogu", Tiranë, 2015, fq. 17.

⁹ Viron Koka, *"Halim Xhelo - monografi me vlera të shumëfishta"*, në "Bardhosh Gaçe- Etnologu, Studiuesi dhe Pedagogu", Tiranë, 2015, fq. 21.

¹⁰ Nasho Jorgaqi, *"Mbi biografinë 'Halim Xhelo' të studiuesit Bardhosh Gaçe"* në "Bardhosh Gaçe- Etnologu, Studiuesi dhe Pedagogu", Tiranë, 2015, fq. 18.

prof. Nasho Jorgaqi, prof. Viron Kona, prof. Muin Çami, prof. Luan Zelka, prof. Shaban Demiraj etj.

Nga studimet monografike me karakter historik, lexuesi ynë ka në dorë një pasuri, me afro 50 vepra, të cilat shquhen për qartësinë e mendimeve, thjeshtësinë në parashtrimin e problemeve, përgatitjen e një dijetari dhe dashurinë për vendlindjen, por së fundmi relievi historik i Vlorës u rigjallërua edhe me një vepër të re **"Vlora- Fjalor Enciklopedik"**, vepra më gjithëpërfshirëse për Vlorën dhe më e rëndësishmja e autorit. Me këtë vepër prof. Bardhosh Gaçe, vjen si misionar në mbledhjen e trashëgimisë kulturore, muzikore, letrare, artistike, arkitekturore etj., që nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme, si dhe të kontribuesve në këto fusha. Janë afro 2200 zëra të vendosur në një pemë që stolis kopshtin e bukur të historisë dhe kulturës vlonjate. Është fakt që brenda këtij libri unik autori ka shfrytëzuar për më shumë se 30 vjet arkivat e shtetit në Shqipëri, Stamboll, Napoli, Romë, Venecia, por edhe mjaft botime të autorëve vendas dhe të huaj.

Puna e prof. Bardhosh Gaçes në "Vlora- Fjalor Enciklopedik", është përpjekje për të krijuar një vepër në shërbim të kujtesës historike të qytetit të Vlorës dhe përçimi i saj te shoqëria, sot, dhe në të ardhmen. Rezultati i kësaj pune me dimension rajonal merr edhe dimension kombëtar. Mund të theksojmë se vepra që kemi në dorë është vetëm fillimi i një pune që do të vijojë me vëllime të tjera që sigurisht do të kërkojnë punë të ngulët dhe vetëmohuese, ndaj i urojmë profesorit jetë të gjatë, punë të mbarë e të frytshme!

SI PËRFUNDIM

Veprat e sjella nga prof. Bardhosh Gaçe janë jo vetëm befasuese, të mahnitshme, frymëzuese e mbresëlënëse, por me faktet e detajet e shumta, ato janë një ndihmesë e jashtëzakonshme dhe shërbejnë si burim për studiuesit dhe historianët. Ato janë vlerë në historiografinë tonë shqiptare, por edhe modele për gjithkënd që kërkon të merret me studime historiko-letrare.

Askush tjetër nuk ka kryer deri më sot studime kaq të thelluara për figurat historike të qytetit të Vlorës, përpjekje që me plot bindje

marrin përmasa kombëtare dhe mbarëkombëtare dhe i sigurojnë Profesorit një vend nderi midis studiuesve dhe lëvruesve më të shquar të kulturës dhe të historisë shqiptare.

Pasqyrimi i jetës dhe veprimtarisë së figurave historike, është jo vetëm shprehje mirënjohje e nderimi për kontributin e këtyre personaliteteve që i kanë qëndruar pranë Atdheut sa herë që ka qenë në rrezik, por edhe një përpjekje për të shkuar tek brezat e rinj, për t'i njohur me këto figura e për të mësuar mbi dinjitetin e treguar prej tyre në momente të vështira historike, me kontributin e dhënë në shërbim të çështjes shqiptare, por edhe për të përcjellë frymën e gatishmërisë për të punuar për zhvillimin dhe përparimin evropian të Shqipërisë.

Vepra të shfrytëzuara

1. Bardhosh Gaçe, "Arshi Selfo Dajlani- Një vatër kombëtare në Kaninë", (monografi), Shtëpia botuese "Maluka", Tiranë, 2016.
2. Bardhosh Gaçe, "Ata që shpallën pavarësinë kombëtare", (monografi), "Toena", Tiranë, 2002.
3. Bardhosh Gaçe, "Hamza Isai- një jetë në shërbim të kombit", (monografi), Shtëpia Botuese "Globus R". Tiranë, 2000,
4. Bardhosh Gaçe, "Osman Haxhiu", (monografi, ribotim), Shtëpia botuese "Maluka", Tiranë, 2020.
5. Bardhosh Gaçe, "Rilindasi i Vlorës, Ibrahim Abdullahi", (monografi), Shtëpia botuese "Toena", Tiranë, 2010.
6. Bardhosh Gaçe, "Halim Xhelo", Shtëpia botuese "Botimet Enciklopedike", Tiranë, 1990.
7. Bardhosh Gaçe, "Vlora- Fjalori Enciklopedik", Shtëpia botuese "Maluka", Tiranë, 2023.
8. Ilinden Spasse, Faik Shkodra, Xhevat Sylja, "Bardhosh Gaçe- Etnologu, Studiuesi dhe Pedagogu", Maluka, Tiranë, 2015.

Marigo Posio dhe aktiviteti i saj publicistik

Dr Enkelejda Billa

Phd Ermal Sina

Universiteti "Ismail Qemali", Vlore

Fakulteti i Shkencave Humane

Departamenti i Edukimit

enkelejda.billa@yahoo.com

Abstrakt

Në jetën politike, shoqërore dhe kulturore të qytetit të Vlorës, qysh në fillim të shekullit të XX spikati një emër i vecantë, ai i Marigo Posios. Ajo së bashku me disa gra intelektuale të qytetit themeluan në maj të vitit 1914 shoqërinë e grave "Shpresa Kombëtare" e cila e ndaloi veprimtarinë e saj në shtator 1914, për t'u ringjallur përsëri pas fitores së Luftës së Vlorës 1920.

Shoqëria demokratike e grave vlonjate gjallëroi më tej jetën kulturore me debate e diskutime për rolin e gruas në shoqëri, edukimin atdhetar dhe arsimor të fëmijëve, çlirimin nga zakonet e vjetra, duke u ngritur kundër martesave të vajzave në moshë të vogël, luftën kundër analfabetizmit etj. Sipas programit të kësaj shoqërie gruaja kishte një rol të jashtëzakonshëm jo vetëm në familje, por në tërë jetën e shoqërisë. Vetë shoqëria me çeljen e shkollave dhe kontaktet me vënde të tjera të qytetëruara të Europës, ndodhej përballë ndryshimeve të mëdha, të cilat kërkonin edhe një përgatitje kulturore e arsimore tjetër të femrës shqiptare.

Për t'i dhënë një gjallëri të mëtejshme jetës së gruas vlonjate, Marigo Posio dhe shoqëria "Shpresa Kombëtare" themeluan në Vlorë edhe gazetën me emrin "Shpresa Kombëtare", numri i parë i së cilës doli në qarkulli më 6 shkurt 1921, me drejtore të përgjithshme vetë Marigo

Posion, me okelion "Organ i femrave të shoqërisë".

Fjalë kyçe: *Shoqëri, arsim, analfabetizëm, emancipim, gazetë*

Abstract

In the political, social and cultural life of the city of Vlorë, since the beginning of the 20th century, prominently emerged the name of Marigo Posio. Together with some intellectual women of the city, she founded in May 1914 the women's society "National Hope", which stopped its activity in September 1914, to be revived again after the victory of the War of Vlorë in 1920.

The democratic society of Vlorë women further enlivened cultural life with debates and discussions about the role of women in society, patriotic educational of children, liberation from old customs, standing up against the marriage of girls at a young age, the fight against illiteracy, etc. According to the program of this society, the woman had an extraordinary role not only in the family, but in the whole life of the society. The society itself, with the opening of schools and contacts with other civilized countries of Europe, was faced with great changes, which required another cultural and educational preparation of the Albanian woman.

In order to give further vitality to the life of the Vlora woman, Marigo Posio and the "National Hope" society also founded in Vlora the newspaper called with the same name "National Hope" -organ of the women of society. The first issue was published on February 6, 1921. General director was Marigo Posio.

Keywords: *Society, education, illiteracy, emancipation, newspaper*

Në jetën politike, shoqërore dhe kulturore të qytetit të Vlorës, qysh në fillim të shek. XX përndriti një emër i veçantë, ai i Marigo Posios, anëtares së klubit atdhetar "Labëria" dhe qëndistares së Flamurit Kombëtar, i cili u shfaq më 28 nëntor 1912 në Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare.

Në vargun e madh të rilindësve shqiptarë një vend të rëndësishëm ndër ata që ju kushtua çështjes së atdheut në ato çaste që po kalonte vendi ka qenë dhe patriotja me zemër të madhe nëna e kombit siç e quanin bashkëkohësit Marigo Posion. Marigoja, vajza korçare e martuar me Jovan Posion, nga fshati Hoçisht i Devollit, u detyrua të largohet nga ky fshat për arsye të ndjekjeve që u bëheshin patriotëve dhe në vitin 1904, u vendos në Vlorë në lagjen Muradie.. Familja vuajti nga një sërë fatkeqësish, së pari me fëmijët e tyre, dhe më vonë me shëndetin e Marigosë për shkak të tuberkulozit. Kristo Floqi ngriti zërin më 9 dhjetor 1928 duke akuzuar autoritetet shqiptare se kishin harruar kontributin e Marigos. Marigo nuk e mori "statusin e veteranit", ashtu si shumë të tjerë bënë në vitin 1912.

Marigoja ka qenë një nga figurat më të ndritura të periudhës së Rilindjes dhe pavarësisë, por edhe një nga gratë më të shquara të Shqipërisë së kësaj periudhe. Në të gjithë veprimtarinë e saj spikati akti sinjifikativ i qëndisjes së flamurit që u valëvit në ditën e shpalljes së pavarësisë dhe si i tillë mbeti simbol duke u dekoruar me dekoratën më të lartë Flamuri i Kombit (Dekreti 3292 i datës 15. 04. 2002), por Marigoja zhvilloi edhe një veprimtari të gjerë politike, atdhetare dhe emancipuese.

Siç shkruhet në shtypin e kohës dhe nga mjaft autorë si: Eqerem bej Vlora, Kristo Floqi, Jani Minga, Halim Xhelo, Thanas Floqi, Ibrahim Shyti,

Kristo Luarasi, Haki Glina, Muço Qulli, Mihal Grameno, Sali Nivica, Jakov Milaj dhe në kohët më pas, veprimtaria e saj kulturore dhe atdhetare la gjurmë të thella në lëvizjen kulturore në Vlorë.

Me Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare, qeveria e Ismail Qemalit u ndesh me vështirësi të shumta, pasi vendi u bë shesh lufte nga fuqitë ballkanike ndërluftuese. Mijëra shqiptarë nga viset jugore të vendit nga shkaku i flakëve të luftës, djegies dhe shkatërrimit të vatrave të tyre familjare nga ushtria greke, u grumbulluan në ullishtat e Vlorës, si dhe në Vllahinë, Sevaster, Armen dhe fushën e Cakranit.

Qysh në maj të vitit 1914, Marigo Posio së bashku me disa gra intelektuale të qytetit, si: Hamide Vlora, Polikseni Koleka, Sado Kanina etj., themeluan shoqërinë e grave "Shpresa Kombëtare". Me ardhjen në qytetin e Vlorës të Princ Vidit, pas takimit me të kjo shoqëri e shpalli gruan e tij, Sofie, Presidente Nderi. Kryetare u zgjodh Hanëme Vlora, ndërsa sekretare e Përgjithshme zonja Marigo. Në faqet e gazetës "Populli", 6 gusht 1914, vihet në dukje ndihma e madhe që u dha muhaxhirëve Marigo Posio dhe shoqëria e grave vlonjate. Duke trokitur në çdo portë vlonjate, te tregtarët dhe zejtarët e vegjël, Marigo Posio mundi të mbledhë 21.813 grosh për ushqime e veshëmbathje për muhaxhirët. Me zaptimin e Vlorës prej kryengritësve rebelë të Haxhi Qamilit, në shtator të vitit 1914, shoqëria e grave vlonjate "Shpresa Kombëtare" e ndaloi veprimtarinë e saj.

Pas fitores së Luftës së Vlorës 1920, në qytetin e Vlorës u krijuan kushte të reja që edhe gruaja shqiptare të jepte kontributin e vet në zhvillimin e jetës ekonomike, kulturore dhe shoqërore. Me ndihmën e Shtjefën Gjeçovit, Halim Xhelos dhe Dom Mark Vasës, Marigo Posio riorganizoi shoqërinë e grave "Shpresa Kombëtare". Lajmin e ringritjes së kësaj shoqërie së pari e jep gazeta "Mbrotja Kombëtare": "Të dielën e kaluar u mbledhën ca zonja në shkollën e çupave për bisedime, për formimin e shoqërisë "Shpresa Kombëtare", por duke mos qenë në një numër të mjaftë sa për të zgjedhur ligjërisht një pleqësi bëmë mejtim për thirrjen e përgjithshme që të bëhet mbledhja gjerësisht të dielën më 16 janar,

ora 2 pasdreke. O burra të ndershëm, këshilloni ju fëmijën (familjen – E.B.) tuaj që të mos mungojë të dielën nga shoqëria e vet, pse Atdheu prët shërbime të mëdha nga gruaja shqiptare...”

Krijimi e kësaj shoqërie demokratike të grave vlonjate e përshëndetën mjaft intelektualë të njohur të Vlorës si: Ali Asllani, Jani Minga, Spiro J. Koleka, Halim Xhelo, Seit Qemali, Ibrahim Shyti, Shtjefën Gjeçovi, si dhe shoqëria patriotike “Mbrojtja Kombëtare”. Në mesazhin e shoqërisë “Mbrojtja Kombëtare” dërguar zonjës Marigo Posio dhe grave vlonjate thuhej: *“Shoqëria Mbrojtja Kombëtare gëzohet, gëzohet dhe pse hollë kupton që do t’i vijë kombit tonë një ndryshim rrënjësor në përparimin qytetënuer. Ne, burrat, gjithnjë ua kemi hedhur fajin prindërve tanë, që nga padituria e tyre na rritën të verbër, po nuk e mejtojmë që edhe ata që do të vijnë pas neve, po që se nuk përkujdesemi, do të na mallkojnë shpirtin, pse i lamë në errësirë... Ati (Babai) është drejtonjësi dhe udhëheqësi i fëmijës. Mëma është shikuesja dhe rritësia e çilimiut, është themeli i moralit të parë shtëpiak, të cilën pjella e trashëgon si një natyrë të dytë dhe me qëndresë e heq më vete deri në gropën e varrit. Jeta praktike na rrëfen se mësimi i nënës është më i fuqishëm nga mësimet e çdo shkolle, andaj lipset që nëna të ndajë mirë detyrën e saj që t’ia kalli përllimisht fëmijës dhe shtëpisë...”*

Shoqëria demokratike e grave vlonjate “Shpresa Kombëtare” e gjallëroi më tej jetën e tyre me debate e diskutime për rolin e gruas në jetën e shoqërisë, edukimin atdhetar dhe arsimor të fëmijëve, çlirimin nga zakonet e vjetra, duke u ngritur kundër martesave të vajzave në moshë të vogël. Nga takimet e shpeshta me gratë në lagjen “Muradie”, “Vrenez” dhe “Tophana”, në vitin shkollor 1921-1922, u përfshinë në shkollën mashkullore dhe atë të çupave 120 nxënës më shumë.

Një punë të veçantë shoqëria e grave “Shpresa Kombëtare” bëri edhe në luftën kundër analfabetizmit. Vetë Marigo Posio, si dhe mësuesit: Jani Minga, Elpiza Bazaj e Polikseni Koleka, një ditë në javë drejtonin kurset e mësimi kundër analfabetizmit, ku ishin përfshirë 34 gra e vajza. Për përparimin e tyre në mësim, M. Posio shkroi disa artikuj me pseudonimin “Shqipëria” në gazetën “Korça” dhe “Mbrojtja Kombëtare”.

Emancipimi i grave dhe i vajzave, shikohej nga shoqëria “Shpresa Kombëtare” dhe zonja Marigo Posio si një nga detyrat e rëndësishme të shoqërisë shqiptare, për ngritjen kulturore të shoqërisë dhe thyerjen e vargonjve të prapambetjes dhe varfërisë e mjerimit. Nëpërmjet kulturës ajo kundron edhe bashkimin e vllazërimit e njerëzve, si dhe përpjekjet e tyre për të kuptuar më mirë ligësitë e shovinistëve fqinjë, të cilët me anën e shkollave turke, greke e italiane, helmonin ndërgjegjen kombëtare të brezit të ri.

Duke lavdëruar punën e çmuar të mësueses Polikseni Koleka, në shkollën femërore, Marigo Posio shpreh bindjen e saj dhe admirimin *“e kësaj gruaje me ndjenja të atdhetarta dhe të fisme, për guximin dhe trimërinë e kësaj gruaje mëmëdhetare”* Në këtë shkrim dhe shkrime të tjera, Marigo Posio gjen rastin të vlerësojë lart shembullin atdhetar të grave shqiptare, të cilat shërbejnë si burim frymëzimi edhe për burrat dhe djemtë e rinj *“për të punuar vepra të shkëlqyera dhe të dobishme për kombin tonë...”*

Në përshëndetjen e tij për themelimin e shoqërisë së grave vlonjate “Shpresa Kombëtare”, publicisti Halim Xhelo në artikullin *“Brezi i ri kombëtar”* në faqet e gazetës *“Mbrojtja Kombëtare”*, me plot besim shprehej se, gruaja shqiptare, duke kërkuar të drejtat e saj me guxim, do të dinte edhe më mirë të mbjellin në shpirtin e tij ndjenjat kombëtare, *“për të ndërtuar një Shqipëri të re dhe europiane”*.

Për t’i dhënë një gjallëri të mëtejshme jetës demokratike të gruas vlonjate, Marigo Posio dhe shoqëria “Shpresa Kombëtare” themeluan në Vlorë edhe gazetën me emrin “Shpresa Kombëtare”, numri i parë i së cilës doli në qarkullim më 6 shkurt 1921, me drejtore të Përgjithshme vetë Marigo Posion, me okelion *“Organ i femrave të shoqërisë”*. Qysh në kryeartikullin e numrit të parë të kësaj gazete nën titullin *“Lypset kujdesim për femrat”*, shoqëria “Shpresa Kombëtare” trajton një varg problemesh për përparimin dhe lartësimin e femrës shqiptare. Sipas këtij artikulli, programi i kësaj shoqërie ishte i gjerë, duke u mbështetur në traditat e mira të gruas shqiptare, ajo synonte të nxiste më tej misionin e saj *“për plotësimin dhe mbarimin e detyrës së lartë që femra ka*

kundrejt shtëpisë (familjes E.B) shoqërisë dhe Mëmëdheut..."

Sipas programit të shoqërisë "Shpresa Kombëtare", gruaja kishte një rol të jashtëzakonshëm jo vetëm në familje, por në tërë jetën e shoqërisë. Vetë shoqëria me çeljen e shkollave dhe kontaktet me vende të tjera të qytetëruara të Europës, ndodhej përballë ndryshimeve të mëdha, të cilat kërkonin edhe një përgatitje kulturore e arsimore tjetër të femrës shqiptare. Duke u ndalur në disa cilësime që i bëheshin racës shqiptare në shtypin europian, se *"kombi ynë nuk është i qytetëruar, femrën e ka si kafshë, shtëpinë e ka burg" etj.*, shoqëria kërkonte që shqiptarët të bëheshin të zotët e vetes, të ndreqnin të metat, duke dalë në dritën e qytetërimit me punë e sakrifica.

Në faqet e gazetës "Shpresa Kombëtare", shoqëria e grave vlonjate pasqyrore edhe kontributin e vet qysh në vitin 1914, kur së pari një grup grash e vajzash vlonjate, ndihmuan e sakrifikuuan për muhaxhirët e Shqipërisë së Jugut, duke shpëtuar qindra jetë njerëzish nga plagët e luftës, uria, mjerimi dhe sëmundjet e ndryshme.

Duke parë kushtet e reja të zhvillimit të lirisë dhe frymës demokratike, shoqëria "Shpresa Kombëtare", kishte përcaktuar në *Kanonizim* e saj edhe misionin e ri *"për të forcuar shpresën që kombi shqiptar ka në fuqinë e vet për kohën e ardhshme"* Në faqet e kësaj gazete botohet edhe *Programi i Shoqërisë "Shpresa Kombëtare"*: "Shoqëria e zonjave të Vlorës "Shpresa Kombëtare" që ish filluar më 10 maj 1914, po ngjallet sot për të dytën herë.

Qëllimi i Shoqërisë:

1. Përparimi, arsimi dhe zgjimi i femrës shqiptare.

2. Ndihma për çdo qëllim kombëtar.

3. Stërvitja e vajzave në shkolla dhe të ndihmojë me të hollat e saj vajza të varfëra të vazhdojnë mësimet e tyre në shkolla të larta.

4. Në këtë shoqëri mund të shkruhet çdo grua shqiptare ose e huaj që dëshiron arsimin dhe zgjimin e femrës.

5. Shoqëria do të qeveriset prej një këshille me 12 vetë, që do të zgjedhë midis saj

Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve, kjo këshillë do të veprojë për një mot.

6. Këshilla e Shoqërisë zgjedh një kryetare, një nënkryetare, një arkëtare, një shkronjëse, të tjerat mbeten këshillonjëse.

7. Shoqëria do të nxjerrë organin e saj me titullin "Shpresa Kombëtare".

8. Kryesia udhëheq mbledhjen dhe bisedimet e Këshillës, sikundër edhe të përgjithshmet.

9. Programi i kësaj shoqërie mund të ndërrohet pas nevojës, por nuk mund të ndryshohet qëllimi i saj.

10. Kjo shoqëri do të ketë një vulë me emrin e saj.

Shoqëria demokratike e grave të Vlorës "Shpresa Kombëtare" e vazhdoi veprimtarinë e saj kulturore e arsimore deri në vitin 1924, kohë kur zonja Marigo Posio mbajti në emër të kësaj shoqërie fjalën e saj në varrimin e Avni Rustemit. Ajo kishte lidhje e bashkëpunim edhe me shoqëritë e grave në Berat, Korçë, Shkodër e Durrës. Por sëmundja e tuberkulozit, bëri që M. Posio të shtrohet në një spital në Austri, ku qëndroi disa vjet dhe shoqëria nuk e vijoi më tej veprimtarinë e saj.

"Shpresa Kombëtare", Është gazetë e përdyjavshme atdhetare, shoqërore e letrare, organ i shoqërisë së grave vlonjate me të njëjtin emër. Gazetë e parë e këtij lloji në Shqipëri. Drejtohej nga atdhetarja Marigo Posio. Numri i parë i saj doli më 6 shkurt 1921 duke dalë në dritë 6 numra. Gazeta kushtonte:

Pajtimet në Shqipëri për një vit 20 Lireta, për gjashtë muaj 12 Lireta.

Pajtimet jashtë Shqipërisë për një vit 25 Lireta, për gjashtë muaj 15 Lireta.

Kryesisht trajtoi probleme shoqërore që lidheshin me çlirimin shoqëror të femrës, duke u kushtuar vëmendje të posaçme arsimit dhe lartësisimit moral të saj, ngriti lart rolin e arsimit dhe edukimit të brezit të ri duke kërkuar dhe shkolla të përbashkëta për djemtë dhe vajzat. Kërkoj që femrës t'i jepej e drejta e votës.

Qysh në artikullin e dt.6 shkurt 1921 në faqet e gazetës bëhet fjalë për "përparimin, arsimin dhe zgjimin e femrës shqiptare"

Shoqëria e Grave Vlonjate nëpërmjet artikujve të veçantë për çështjen e shkollave vazhdimisht ngre problemin para shoqërisë ,për stërvitjen e vajzave në shkollë duke ndihmuar me të holla, vajzat e varfëra të vazhdojnë mësimet në shkollat e larta. Qysh në artikullin redaksional tw numrit tw parw tw kësaj gazete "Lypset kujdesim për femëra|" artikullshkruesja, që siç duket është Marigo Posio, ngre nevojën e emancipimit të femrës, e cila nuk mund të zhvillohet pa arsimin e saj, e mbyllur brenda 4 mureve të shtëpisë. Sipas saj shtetet e mëdha të Europës janë qytetëruar duke arsimuar të gjitha shtresat e shoqërisë. Ajo shkruan " Programi i fletores Shpresa Kombëtare do të jetë shtytj' e paprerë në përparim dhe lartësim, morale dhe material , së femëresë shqiptarkë, duke u përpjekur me gjith fuqiët, që ti forcojë ato zakone të mira, që deri më sot I kanë mbajtur të larta e të lavdëruara femërat t'ona, si dhe të thithën si bleta, ng' ato të botës, që munt të pajtohen me të vetat, për plotësimim dhe mbaresën e detyrës së lartë, që femëra ka kundreq, shtëpies, shoqëries dhe mëmëdheut."

Mjaft interesant është edhe artikulli i shkruar në këtë gazetë nga e bija Ferëniqi Posja nën titullin "Shkollë-shkollë". Atikull shkruesja duke bërë një pasqyre të prapambetjes së popullit tonë ndër shekuj thekson se ka ardhur koha që femrës t'I jepet roli I merituar edhe në shoqërinë shqiptare, duke I kushtuar rëndësi shumë të madhe arsimimit të saj: " Ne femrat lipset të përpiqemi të vemë përpara, sepse nga përparimi I femrës, vjen përparim i përgjithshëm. Këtë gjë do të mundim ta bëjmë me përpjekjen tonë për arësimin, duke ndimuar(të gjitha) shoqeve tona, që kanë këtë qëllim, që të mundin të dërgojnë vajsa në për më të mirat shkolla të jashtme, e kësisoj të pregatiten mësonjënese të mbaruara. Atëherë po do të mundim të shoim që dhe ne do rojmë."

Në vazhdim të idesë së rilindasve tanë të mëdhenj në këtë artikull, si shkak i gjithë të këqijave të shoqërisë, quhet mungesa e kulturës, padija, prandaj kërkohet që të çelen dhe të

ndiqen sa më shumë shkollat: "Është e ditur që e gjithë kjo që vërejmë në kohërat e shkuara nga shkelja e të huajve në Shqipëri ishin consequencat e padijes". Një mbivlerësim i tillë i rolit të kulturës mendojmë se e ka bërë të kuptojë qartë mendimin humanist që kishte autorja për zhvillimin e shoqërisë njerëzore, ndaj në artikull argumentohet edhe arsyeja e kësaj prapambetje: "Për fat të keq në të gjitha kombet e Ballkanit, kombi që ka jetuar mbrapa është kombi shqiptar. Jo se i mungon dëshira dhe inteligjenca, por hordhitë e 500 vjetëve që e ndalonin mësimin e gjuhës amtare. Për këtë shkak ky i ngrati popull ka mbetur kaq mbrapa".

Shoqëria Mbrojtja Kombëtare në faqet e gazetës së saj përgëzon themelueset dhe drejtuesen e "Shpresa Kombëtare", duke e ditur rolin e rëndësishëm të femrave në një shoqëri shkruan:" Shoqëria "Mbrojtja Kombëtare" gëzohet! Gëzohet !dhe gëzohet! Pse hollë kupëton nga do I vijë kombit t'onë aji ndryshim rrënjësor në përparimin gjytetnuër."

Në faqet e gazetës "Shpresa Kombëtare" shpesh flitet për traditat, zakonet e kulturën e shqiptarëve, të cilat duhet të ndriçohen nga idetë e reja iluministe. Aty këmbëngulet që mjaft gra e vajza të shkollohen edhe jashtë vendit në vendet perëndimore ,pasi kështu arrihet përparimi i përgjithshëm.

Marigo Posjo e quan zhvillimin mendor të shqiptarëve një detyrë imediate të kohës: "Njeriu sot nuk lipset të mendojë e të përkujdeset vetëm për ushqimin e trupit. Veç kësaj detyrë ka edhe një tjetër, gjithnjë të madhe e me rëndësi dhe kjo është zhvillimi dhe lëvrimi i mendjes". Në disa artikuj të gazetës "Shpresa Kombëtare" si shembuj merren Naim Frashëri e Kristoforidhi, por edhe rilindas të tjerë, të cilët e kanë parë kurdoherë arsimin si një zgjim kombëtar të ndërgjegjes kombëtare, por edhe domosdoshmëri për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe të komb Një fushë e gjerë e artikujve publicistikë të kësaj gazete ishte edhe ajo e luftës kundër zakoneve prapanike, thashethemet dhe martesat e vajzave në mosha të vogla, mbyllja brenda mureve të shtëpisë, mungesa e arsimit dhe e lirisë së tyre, të cilat e kishin kufizuar rolin e tyre në jetën e shoqërisë. Për këtë arsye shoqëria "Shpresa Kombëtare"

dhe artikujt e ndryshëm si ai *"Arsim, arsim"* nën emrin e Fereniqi Pozios, i bënte thirrje shoqërisë në vazhden e mendimit të rilindasve tanë të mëdhenj, të sprapsnin këtë të keqe të madhe, analfabetizmin e grave dhe të vajzave, që ishte një plagë e thellë e shoqërisë.

Duke e vlerësuar rolin e kulturës dhe të arsimit në jetën e shoqërisë, gazeta *"Shpresa Kombëtare"* e shikonte atë si një faktor të veçantë të zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë. Fitorja e Luftës së Vlorës, ku edhe gratë kishin dhënë kontributin e tyre, tashmë kishte çelur një fat të ri edhe për gruan shqiptare për të marrë pjesë aktive në jetën shqiptare që *"edhe ne të përpiqemi me tërë fuqitë të arrijmë shkallën e kombeve të tjera..."*

Në artikullin *"Nevoja e mësimi"* rithekson disa herë se arsimi dhe kultura mund të fitohen vetëm në shkollë, ndaj e quan këtë institucion të pazëvendësueshëm për jetën e shoqërisë. Megjithatë, krahas shkollave të huaja, Marigo Posjo e gazeta *"Shpresa Kombëtare"* këmbëngulën në mendimin e tyre në krijimin e shkollës kombëtare shqipe, si një *"ndërtesë të qytetë që ndrit mendjen e njeriut dhe ka në dorë përparimin e një kombi e të gjithë njëzisë."* Edhe pse në disa artikuj pranohet se shpresa e Shqipërisë kishte filluar qysh me shpalljen e Pavarësië, Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës e kishin vulosur atë. Frenimin e zhvillimit të arsimit e të kulturës ajo e shikonte në rrethanat e brendshme dhe të jashtme të varfëra e mjerimi, ndaj me nota revolte ajo kërkon zhvillimin kombëtar arsimor të vendit. Në këtë kuadër gazeta *"Shpresa Kombëtare"* bëri që brezi i ri të hedh përtej mentalitetet e vjetra dhe të padijes, të shfaqë të gjallë dëshirën e mësimi *"që të dëftehemi vërtet një komb i zotë, që të ngre e të përparojë si të tjerët"*.

Në të gjithë numrat e gazetës çështja e arsimimit dhe emancipimit të femrës mbetet kryesorja. Në kryeartikullin *"Togu i Shenjt"* Fereniqi Posjo, duke i'u drejtuar atyre që kanë mundësi të ndryshojnë situatën e rëndë në të cilën gjendet gruaja shqiptare shkruan: *"Tani a është e drejtë që ky ëndëgjell i familjes (gruaja), të jetë kaq prapa dhe pa përkujdesim?"*

Juve që frerin e familjes e keni në dorë, juve që qeverisni vazhdimin e marë në të mirën materiale, ekonomike, të zbulimit të nderit,

juve ju mbetet, përgjigje, dhe përgjigjuni vehtes s'uaj. "

Në një rubrikë të posacme të titulluar *"Ca nga çëdo anë"* kjo gazetë informonte edhe në lidhje me lajme nga shtete të tjera, por që kishte të bënte me gratë psh në njoftimin *"Regimenti femëruer i Polonis"* tregon pjesëmarrjen e grave në luftë, në lajmin *"O Fatë ose nëpunësi"* tregon grevën e vajzave që punojnë në një bankë në Napoli, të cilave u kërkohet të japin dorëheqjen nga puna nëse martohen. Pra sic duket në cdo rresht të gazetës *"Shpresa Kombëtare"* lufta për emancipimin e femrës është kryesorja.

Gazeta i'u bën thirrje të gjitha zonjave të Shqipërisë për bashkëpunim me artikuj, vjersha, lajme etj. Pavarësisht se gazeta doli vetëm në 6 numra, shpresa nuk duhej të vdiste kurrë dhe ashtu sic mori edhe emrin *"Shpresa Kombëtare"* në cdo numër shkruhej *"Ay komb që ka Shpresë, ay do rrojë I gëzuar! Ajo motër që nuk është me shpresë, ajo do dëshpërohet"*

Gjithashtu Marigo Posjo Drejtoreshë e përgjithshme e gazetës bën thirrje: *"Janë të lutura të gjitha zonjat Kombëtare, ta huajnë Shoqevë dhe mikëreshave, Fletoren Shpresa Kombëtare që del një herë në dy javë"*

Me rastin e fushatës së zgjedhjeve të reja parlamentare të vitit 1921, gazeta *"Shpresa Kombëtare"* ngrinte disa probleme, të cilat lidheshin ngushtë edhe me rolin e shtetit dhe përgjegjësinë e tij për edukimin *"e djemve dhe të çupave"*, pasi shtylla më e fortë për begatinë e Atdheut *"është dituria edhe për femra si për burrat"*. Ndaj shoqëria e grave vlonjate ngre zërin e protestës për barazinë e burrave dhe grave, por edhe kundër mohimit të së drejtës së votës për gratë, duke i privuar ato nga jeta politike e shoqërisë. Në artikullin *"Një çikë nga të gjitha"* zëri i protestës femërore bëhej edhe më i fuqishëm: *"Kandidatët (për deputetë – E.B) duan të përpiqen për shkolla për djem. Po vajzat nuk janë edhe ato pjesëtare të një kombësie? Sikur të ish që të votonin edhe gratë, mendojmë se këta kandidatë nuk do të kishin asnjë votë nga të femrave..."*

Në faqet e gazetës *"Shpresa Kombëtare"* botoheshin herë pas here edhe artikuj të tillë si *"Flamuri"*, *"Si e duam mëmëdhenë"*, *"Dashuria për*

Atdheun" etj., nëpërmjet të cilëve vajzat e reja marrin mësim atdhetarie për edukimin e tyre me ndjenja kombëtare. Në këtë aspekt, për të nxitur recitimet e vajzave në shkolla në faqet e gazetës botoheshin edhe mjaft vjersha me frymën e dashurisë për Atdheun dhe gjuhën shqipe.

Drejtuesja e Gazetës dhe e shoqërisë me të njëjtin emër publicistja dhe patriotja Marigo Posjo shfaqet edhe si një poetë. Poezia e saj e njohur për Avni Rustemin u botua në numrin e dytë të gazetës me pseudonimin Luanesha.

Gazeta "Shpresa Kombëtare" sic u përmend vazhdoi për pak muaj. Kur entuziazmi që kishte grumbulluar të gjitha gratë e Vlorës rreth Zonjës Marigo u shua, shoqëria u shpërnda dhe gazeta u mbyll. Zonja Marigo tashmë ishte plakur dhe përveç pleqërisë, sëmundjet e mjerimit familjare nuk e linin të qetë. Dy vajza dhe biri i vetëm i vdiqën nga tuberkulozi. Ajo vdiq në vitin 1932, dhe u varros në varrezat e Manastirit të Zvërnecit.

Referenca

1. *Instituti i Historisë (Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë) (1987), "Disa sqarime e plotësime për jetën e Marigo Posios", Studime Historike, 41, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë:223, ISSN 0563-5799, OCLC 3648264*
2. *Ledia Dushku (2012-12-02), "Lef Nosi: Çfarë dinte dhe ç'dëshmi la për flamurin e Pavarësisë" (PDF), Rilindasi (45): 14, Në një shkrim rreth ligjit të veteranëve në Gazeta e Re, më 9 dhjetor 1928 Kristo Floqi, ngre zërin për faktin se Marigo Pozio, veprimtare e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, njëkohësisht qëndistare e flamurit të ngritur nga Ismail Qemali, nuk merrte shpërblimin e veteranit*
3. *Bardhosh Gace " Ata që shpallën Pavarësinë Kombëtare", Tiranë : Argeta-LMG, 2022*
4. *Gazeta "Populli", Vlorë, 6 gusht 1914.*
5. *Gazeta "Mbrojtja Kombëtare", Vlorë, 2 janar 1921.*
6. *Gazeta "Mbrojtja Kombëtare", Vlorë, 13 janar 1921.*
7. *Gazeta "Mbrojtja Kombëtare" Vlorë, 27 janar 1921.*
8. *Gazeta "Mbrojtja Kombëtare", Vlorë, 9 shkurt 1921.*
9. *Halim Xhelo: "Brezi i ri kombëtar", gazeta "Mbrojtja Kombëtare", Vlorë, datë 27 janar 1921.*
10. *Gazeta "Shpresa Kombëtare", Vlorë, nr. 1, 6 shkurt 1921.*
11. *Gazeta "Shpresa Kombëtare", Vlorë, nr. 2, 20 shkurt 1921.*
12. *Gazeta "Shpresa Kombëtare", Vlorë, 3 prill 1921.*
13. *Revista "Atdheu" nr. 2, Vlorë 1921.*

KËNDVËSHTRIME TË NDRYSHME NË LETËRSINË PËR FËMIJË E TË RINJ

Dr. Rudina ALIMERKO

*Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
Departamenti i Edukimit
Vlorë, ALBANIA
rudi_alimerko@yahoo.it*

Vjollca MYFTARI

*Autore për fëmijë
vjollcamyftari70@gmail.com*

Abstrakt

Një nga veçoritë e shquara të letërsisë për fëmijë është përshtatja e saj me kulturat e ndryshme dhe periudhat e kohës. Ajo pasqyron normat, vlerat dhe aspiratat shoqërore, duke e bërë atë një pasqyrë për botën në të cilën është shkruar, është një mjet i fuqishëm në arsim duke promovuar zhvillimin e gjuhës, aftësitë njohëse dhe një dashuri të përjetshme për leximin. Qëllimi i këtij hulumtimi përmes aktivitetit të zhvilluar dhe diskutimeve, është të theksojë promovimin e lexueshmërisë dhe ndërgjegjësimin social për ndikimin që ka libri në formësimin e personalitetit të fëmijëve.

Në kontekstin e sfidave dhe përballjes globale, fëmijët dhe të rinjtë janë përfshirë duke marrë vëmendjen më të madhe në internet dhe në botën dixhitale, duke mos patur interes ose kureshtje për t'iu qasur letërsisë si një fushë eksplorimi, si një hapësirë për argëtim dhe studim, si një palestër gjuhësore, si një vend në të cilat thjesht të kalojnë kohën. Duke patur parasysh rëndësinë që ka letërsia, si dhe nga përvoja për të mbështetur punën e mësuesve dhe edukatorëve, me vëmendje të veçantë në zgjedhjen e librave që do t'u ofrojnë nxënësve të tyre, do të shkëmbejmë përvojat më të mira për të zgjeruar këndvështrimet letrare, didaktike dhe pedagogjike në letërsinë për fëmijë.

Si pasojë, ia vlen të reflektohet se si programet mbi letërsinë për fëmijë në nivel universitar mund të zhvillojnë qëndrime pozitive ndaj leximit, në mënyrë që studentët, mësuesit e

ardhshëm, ta mbajnë dhe ta ndajnë këtë motivim të brendshëm gjatë gjithë jetës.

Fjalë kyç: *Këndvështime letrare, pedagogjike, të lexuarit, mendim kritik*

Abstract

One of the remarkable features of children's literature is its adaptability to different cultures and time periods. It reflects societal norms, values and aspirations, making it a mirror of the world in which it is written, it is a powerful tool in education promoting language development, cognitive skills and a lifelong love of reading.

The purpose of this research, through the developed activity and discussions, is to emphasize the promotion of readability and social awareness of the impact that the book has on shaping the personality of children. In the context of global challenges and confrontation, children and young people are involved taking the most attention on the Internet and in the digital world, not having interest or curiosity to approach literature as a field of exploration, as a space for entertainment and study, as a language gym, as a place in which to simply pass the time. Bearing in mind the importance of literature, as well as the experience to support the work of teachers and educators, with special attention to the choice of books to offer to their students, we will share the best experiences to broaden

perspectives literary, didactic and pedagogical in children's literature. Consequently, it is worth reflecting on how children's literature programs at university level can develop positive attitudes towards reading so that students, future teachers, can maintain and share this intrinsic motivation throughout life.

Key words: *Literary perspectives, pedagogy, reading, critical thinking*

Hyrje

Sot, letërsia për fëmijë përfshin një gamë të gjerë zhanresh, nga librat me figura dhe përrallat deri tek romanet për të rinjtë. Kjo letërsi vazhdon të zhvillohet duke përfaqësuar diversitetin, përfshirjen dhe temat bashkëkohore, duke siguruar që ajo të mbetet pjesë e rëndësishme dhe e dashur e fëmijërisë për brezat që do të vijnë. Letërsia për fëmijë është burim i vlefshëm, magjepsës, gjallërues për pasurimin e jetës së të rinjve dhe kultivimin e një pasioni të qëndrueshëm për leximin dhe të pasura me mësimdhënie.

Metodologjia e hulumtimit

Studimi në fjalë, është zhvilluar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Librit për fëmijë e të Rinj, si një aktivitet i zhvilluar në Departamentin e Edukimit, me qëllimin tonë të përbashkët: T'u japim fëmijëve mundësinë për të njohur libra të standardeve të larta letrare e artistike; kështu ata orientohen me kërkesat e shoqërisë së sotme. Në këtë workshop u propozuan vështrime dhe sugjerime duke filluar nga këndvështrime të ndryshme: ilustrim, rrëfim poetik dhe modele didaktike dhe pedagogjike. Metodologjia e hulumtimit bazohet edhe në metodën vlerësuese bazuar në eksperiencën e mësuesve në zhvillimin e orëve letrare; në metodën krahasuese për të parë rolin që luan leximi si urë lidhëse midis ngjarjeve të lexuara dhe eksperiencës gjuhësore individuale, të cilat lehtësojnë integrimin e këndvështrimeve të ndryshme për botën reale. Për secilën nga këto prezantime u vlerësua vizioni i mësuesve, i shkrimtarëve që shkruajnë për fëmijë dhe ai i kritikut, për të zgjeruar vështrimin për të ardhmen, për kërkimin dhe përhapjen e letërsisë për fëmijë, si dhe për ndërtimin e imagjinatës përmes letërsisë dhe universeve narrative.

Emy Beseghi, studiuese dhe pedagoge në Universitetin e Bolonjës ka identifikuar pika të ndryshme reflektimi për të kuptuar rëndësinë e leximit dhe letërsisë për fëmijë. *Ajo thekson se letërsia është pasqyrë identiteti, sepse përmes leximit ne arsyetojmë, mbi të gjitha reflektojmë dhe personazhet e çdo historie bëhen shoqërues*

udhëtimi që lehtësojnë vetminë dhe na mësojnë si të jetojmë; është një rrugë e dijes që fton leximin dhe çdo histori mund të veprojë si një urë lidhëse midis të njohurës ose të shkuarës dhe të panjohurës ose së ardhmes [1].

Leximi për kënaqësi është një nga objektivat kryesore të programeve të leximit në shumicën e vendeve evropiane dhe është treguesi më i rëndësishëm i suksesit të ardhshëm akademik të fëmijës. Për shumë kohë, hulumtimi ka vërtetuar se leximi për kënaqësi lidhet pozitivisht me përvetësimin e aftësive të të lexuarit, aftësive të të shkruarit, të kuptuarit dhe zhvillimin e fjalorit. Efektet e leximit për kënaqësi nuk kufizohen vetëm në motivimin për të lexuar, por sjellin edhe përfitime emocionale, psikologjike dhe njohëse [2].

Siç e shohim edhe më lart, letërsia mbetet një fushë dinamike dhe me ndikim që frymëzon lexuesit, nxit imagjinatën e tyre dhe i ndihmon ata të lundrojnë në kompleksitetin e botës me ndjeshmëri dhe mirëkuptim. Letërsia, karakterizohet nga një perspektivë e të zgjidhurit të problemit. Ndaj natyrshëm lindin pyetjet: *Si të inkurajojmë kënaqësinë e leximit tek fëmijët dhe të rinjtë? Si të zhvillohen njohuritë dhe praktikat e mira arsimore për të lexuarin? Pse është e rëndësishme të promovojmë leximin dhe leximin me zë të lartë?*

Të lexuarit është një proces i rëndësishëm intelektual dhe edukativ, i cili mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve. Shkolla është institucioni përmes të cilit përcillen dhe përvetësohen dije, e shoh të lexuarin si:

- çelësin e sukseseve të çdo individi në të gjitha moshat e edukimit të tij. Është pjesë e edukimit tërësor të fëmijës;
- fillon në mjedisin e familjes si pjesë e edukimit prindëror, familjar;
- përfshihet gjerësisht në programet e edukimit institucional, si mjeti më i rëndësishëm i formimit, i të nxënit dhe arsimimit;
- pjesë tek politikat sociale- kulturore-shoqërore.

Një vend me rëndësi zë: *edukimi për leximin në familje*, sepse: familja është çerdhja e parë e edukimit; e realizon rolin e saj nëpërmjet angazhimit të prindërve; nëpërmjet rolit të gjyshërve, motrave, vëllezërve; familja e ushtron ndikimin në kontekstin e saj kulturor dhe intelektual.

Po ashtu një vend të veçantë zë: *edukimi institucional*, si: formimi akademik-profesional; institucionet e ushtrojnë rolin e tyre nëpërmjet profesionistëve të edukimit; studentët ndjekin

programin e edukimit për t'u pajisur me kompetencat e duhura për ta ushtruar në mënyrë cilësore detyrën dhe përgjegjësinë.

Çfarë kompetencash profesionale duhet të zotërojnë një student i cili aspirojnë të ndikojë me rolin e vet në formimin dhe edukimin e fëmijëve?

- Zotërimi i bazave të formimit teorik të psikologjisë së zhvillimit të fëmijëve. Të dallojë qartë treguesit e zhvillimit të fëmijëve;
- Zotërimi i njohurive të mira shkencore në të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijëve;
- Njohja e stadeve dhe standarteve të zhvillimit dhe të të nxenit të fëmijët;
- Njohja e veçorive të zhvillimit të gjuhës;
- Njohja e fondit të krijimtarisë letrare për fëmijë;
- Zotërimi i aftësive gjuhësore-komunikuese me fëmijët;
- Shfaqja e interesit në rritje për profesionin duke kërkuar të fitojë vazhdimisht përvoja të reja, trajnime, kualifikime, veprimtari praktike.

Çfarë kompetencash profesionale duhet të zotërojnë një mësues me një përvojë të caktuar i Arsimit Parashkollorë dhe Arsimit Fillor, për të ndikuar fuqishëm dhe në mënyrë cilësore në edukimin e të lexuarit tek fëmijët?

Krahas gjithë kompetencave të një mësuesi fillestar, duhet:

- Zotërimi i aftësive praktike për të aplikuar me efektivitet metoda dhe teknika të ndryshme të mësimdhënies;
- Trajnimi në mënyrë sistematike për të rritur aftësitë profesionale;
- Njohja e thellë e fondit të krijimtarisë artistike-letrare për fëmijët, shqiptare dhe të huaj (klasike);
- Krijimi i bibliotekës së pasur personale profesionale;
- Përzgjedhja e materialeve dhe përfshirja në kurrikul brenda lirisë profesionale;
- Thellimi i njohurive në lidhje me qasjet e reja letrare bashkëkohore që duhet t'u ofrojnë fëmijëve;
- Përdorimi i formave dhe teknikave nxitëse drejt dëshirës për librin dhe të lexuarin si proces;
- Realizimi i përzgjedhjeve të duhura të librave dhe krijimeve të përshtatura për grupmoshën;

- Njohja e mirë e interesave të fëmijëve për t'i orientuar me kujdes ndaj librit, jo duke i detyruar;
- Krijimi i bibliotekës së grupit, e pasur me libra të ndryshëm për fëmijë;
- Hartimi i projekteve të ndryshme me prindërit apo komunitetin për të rritur interesin për librin dhe procesin e të lexuarit;
- Zbulimi dhe zbatimi i mënyrave produktive që nxisin hap pas hapi në vazhdimësi procesin e të lexuarit;
- Njohja dhe zbatimi i didaktikës metodave dhe teknikave të mësuarit të vjershës, përrallës, tregimit etj;
- Përfshirja e prindërve në procesin e edukimit të të lexuarit tek fëmijët nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta [3].

Procesi i të lexuarit të librit kalon në këto faza:

Strategji për të edukuar të lexuarin:

Fëmija mëson në dy mënyra: Nga Brenda-Jashtë dhe nga Jashtë-Brenda.

Nga Brenda-Jashtë, fëmija shfaq potencialin, vlerat e veta origjinale të mbartura nga trashëgimia. Psh; dëshirat për lojë, për ndërveprim social etj janë të lindura. Loja është veprimtari e natyrshme.

Nga Jashtë-Brenda ndikon mjedisi, ne, me mjetet e edukimit, me programet akademike. Dëshira për librin edukohet, dëshira për celularin edukohet, lojërat virtuale menaxhohen. Të lexuarit e librit është veprimtari që udhëhiqet, organizohet, orientohet dhe sygjerohet nga mësuesja ose të rriturit e tjerë [4].

Pse duhet t'i orientojmë sa më shumë fëmijët drejt librit dhe të të lexuarit?

- Libri është mjet i fuqishëm edukimi;
- Ndikon fuqishëm në zhvillimin e personalitetit dhe inteligjencës së fëmijëve;
- Fëmijët zbulojnë veten dhe botën përreth;
- Të lexuarit zhvillon aftësitë shprehëse-komunikuese;
- Të lexuarit është proces produktiv i përdorimit të kohës;
- Të lexuarit është proces të nxëni;
- Të lexuarit për të tjerët është marrëdhënie sociale, zhvillon komunikimin e referencës sociale;
- Të lexuarit është praktikë pozitive e mirëqenies emocionale të njeriut;
- Libri është udhërrëfyes i mirë për të ndjekur ëndrrat;
- Të lexuarit redukton efektet anësore të përdorimit të teknologjisë;

- Ndikimi i fuqishëm gjuhëve të tjera si rezultat i lëvizjeve po e zbeh dhe po e deformon cilësinë e komunikimit në gjuhën shqipe;
- Është detyrë jo thjesht profesionale e edukimit, por mision kulturor, patriotik, atdhetar, ruajtja dhe fuqizimi i gjuhës shqipe brez pas brezi [5].

Duket sikur takimi me letërsinë është sfidues, gati e pamundur, por harrojmë që autorët e letërsisë për fëmijë janë shpesh mjeshtër në krijimin e personazheve me të cilët lexuesit e vegjël mund të identifikohen lehtësisht. Këta personazhe përballen me sfida, evoluojnë dhe mësojnë gjatë rrugës, gjë që u jep lexuesve të rinj mundësinë të zhvillojnë ndjeshmëri dhe të rriten me ta. Për shkak se letërsia nuk i nënshtrohet kufizimeve kohore ose hapësinore, librat në mënyrë figurative mund t'i transportojnë lexuesit nëpër kohë dhe hapësirë. Vende të tjera në kohët e shkuara, të tashme ose të ardhshme ftojnë fëmijët të eksplorojnë, për shkak të këtij eksplorimi, fëmijët arrijnë të kuptojnë më mirë botën në të cilën jetojnë dhe marrëdhënien e tyre me të [6].

Teoritë pedagogjike mbi rëndësinë e letërsisë për fëmijë

Letërsia për fëmijë ka rëndësi të veçantë dhe të shumanshme në arsim, duke luajtur një rol kryesor në zhvillimin intelektual, emocional dhe zhvillimin social të fëmijëve. Rëndësia e letërsisë për fëmijë njihet nga teori të shumta pedagogjike. Disa nga pikat kryesore për t'u marrë parasysh përfshijnë faktin pse letërsia është komponent i rëndësishëm në edukim:

Promovon aftësinë e shkrim-leximit: letërsia shërben si një portë e shkrim-leximit, sepse aftësitë e leximit dhe tregimet e përshtatshme për moshën i zhvillojnë fëmijët të lexuarit dhe të kuptuarit, pasuron fjalorin, strukturën e fjalisë dhe tregimit, duke hedhur themelet e komunikimit efektiv dhe mendimit kritik. Ekspertët në një takim të UNESCO-së kanë propozuar përcaktimin e shkrim-leximit si "aftësi për të identifikuar, kuptuar, interpretuar, krijuar, komunikuar dhe njehsuar, duke përdorur materiale të shtypura dhe të shkruara të shoqëruara me kontekste të ndryshme". Ekspertët vërejnë se: "*Shkrim-leximi përfshin një vazhdimësi të të nxënësve dhe mësimit në aftësimin e individëve për të arritur qëllimet e tyre, për të zhvilluar njohuritë dhe potencialin e tyre dhe për të marrë pjesë plotësisht në komunitetin dhe shoqërinë më të gjerë*" [7].

Nxit dashurinë për leximin: letërsia e krijuar dhe e përshtatur për fëmijë ka fuqi të rrënjës në dashuri të përjetshme për leximin. Kur fëmijët ndeshen me personazhe magjeps dhe botë imagjinative, e shohin leximin si një aktivitet të këndshëm dhe tërheqës. Ndërkohë që flitet gjithnjë e më shumë për një rënie të interesimit ndaj librit dhe të lexuarit, gjatë punës së përditshme mësimdhënësit shohin se si shfaqen nxënësit e tyre, që meritojnë vërtetë të quhen "gjenialë" të leximit dhe të kërkimit të dijes, përmendim një rast në një orë mësimi: Në një detyrë me shkrim në lëndën e Gjuhës shqipe, u zbulua një pasion i tij, leximi i librave. Në përgjigje të një pyetjeje në punën me shkrim ku i kërkohet "Hartoni një tekst të shkurtër me titull 'Pasioni im më i dashur'", ndër të tjera ai shkruan: "*Kam disa pasione, por pasioni im më i dashur është leximi. Jam regjistruar fillimisht në bibliotekën e shkollës, e më pas në atë të qytetit. Aq pasion e kam leximin sa që lexoj të paktën 100 faqe në ditë. Për mua ky pasion do të vazhdojë përjetë...*" [8]

Fuqia e letërsisë për fëmijë ndikon dhe *nxit zhvillimin konjitiv*, sepse ekspozimi ndaj tregimit dhe temave të ndryshme stimulon zhvillimin konjitiv. Inkurajojnë fëmijët të mendojnë në mënyrë analitike, të krijojnë lidhje dhe të eksplorojnë ide komplekse, duke nxitur aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve dhe kreativitetin. Kështu për shembull nëpërmjet integritetit, duke përfshirë përvojën e nxënësve nga jeta e tyre, për njësinë tematike Harry Potter, ata do të sigurojnë mundësitë që të zhvillojnë mendimin kritik, krijimtarinë, aftësinë për të punuar në mënyrë aktive dhe serioze me tekstin [9].

Ndërgjegjësimi dhe empatia kulturore: Letërsia për fëmijë u prezanton fëmijëve të vegjël dhe të rinj më një gamë të gjerë kulturash, përvojash dhe këndvështrime. Ky ekspozim nxit ndërgjegjësimin kulturor dhe ndjeshmërinë, duke ndihmuar fëmijët të kuptojnë dhe të vlerësojnë diversitetin, si dhe të kuptojnë përvojat e njerëzve të tjerë dhe të zhvillojnë marrëdhënie pozitive.

Edukimin moral dhe etik: Shumë vepra të letërsisë përfshijnë mësimet morale dhe etike që nxisin reflektimin e menduar. Nëpërmjet përvojave dhe zgjedhjes së personazheve, lexuesit mund të mësojnë për vlerat dhe pasojat e veprimeve.

Të mësuarit përmes argëtimit: Historitë e fëmijëve shpesh mësojnë vlera, histori, kulturë dhe më shumë përmes argëtimit. Lexuesit më të rinj mësojnë në mënyrë mëkëmbëse ndërsa zhyten në histori.

Rritja sociale dhe emocionale: Tregimet në letërsinë për fëmijë shpesh eksplorojnë emocionet, marrëdhëniet dhe rritje personale.

Ato ofrojnë një hapësirë të sigurtë për fëmijët që lidhen me personazhe që përballen me veprim dhe sfida, duke i ndihmuar ata të kontrollojnë emocionet e tyre dhe ndërveprimet shoqërore.

Zhvillimi i të menduarit kritik: Leximi i tregimeve komplekse stimulon mendimin dhe analizën kritike, duke inkurajuar të rinjtë të marrin në konsideratë perspektiva të ndryshme dhe të shqyrtojnë temat themelore [10].

Letërsia angazhon në diskutime dhe inkurajon nxënësit për të shprehur mendimet dhe opinione me bashkëmoshatarë dhe mësues, duke bërë kështu që të ndërtojnë aftësitë e komunikimit.

Letërsia për fëmijë shpesh trajton sfidat e jetës reale, të tilla si: ngacmimi, bullizmi, humbja e identitetit, përmendim romanin aq të dashur për fëmijë dhe të rinj *Meriyll* të shkrimtarit Viktor Canosinaj, roman i llojit të problemeve shoqërore. Që në rreshtat e parë ndeshemi me Meriyllin, e cila qëndron e ulur pranë nënës së saj të sëmurë. Romani fillon me ngjarjen e dhimbshme të vdekjes së nënës së Meriyllit. Fatkeqësia që godet Meriyllin të bën të ndjesh dhembshuri për këtë personazh. Meriyll është vetëm 13 vjeçe dhe supet e saj të brishtë do të duhet të mbajnë peshën e humbjes së njeriut më të shtrenjtë, nënës, pikërisht në momentet kur ajo do të kishte më shumë nevojë për të... Kjo kërkon një nivel kompleks të inteligjencës emocionale, pasi shumë fëmijë të vegjël e të rinj nuk e kuptojnë vdekjen. Tema e vdekjes do të ishte më e përshtatshme, por edhe një temë e rëndësishme për t'u diskutuar me nxënësit dhe studentët në klasë. Përballë kësaj vjen i qartë dhe i fortë mesazhi që përçoi Meriyll tek të rinjtë adoleshentë: *Gjej forcën, ki durim, ec drejt në rrugën tënde të jetës, pa hequr vëmendjen nga gjërat që kanë vërtet vlerë në jetë*. Leximi rreth personazheve që trajtojnë këto çështje, mund të ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë strategji elastike dhe përballuese. Letërsia është një hapësirë magjike në të cilën mund të gesh veten, por edhe të zbulosh, të mësosh dhe të jetosh jetë të tjera, përveç jetës tënde. Zhvillimi i ndjeshmërisë përmes leximit lejon një kuptim më të mirë të këndvështrimeve dhe përvojave të ndryshme.

Përfundime

Për të arritur këto qëllime, ndërhyrjet letrare mund të konsiderohen si një nga strategjitë e mundshme për të nxitur të lexuarin në proceset e të menduarit, sepse fuqia magjike e letërsisë është dëshmi e fuqisë së qëndrueshme të tregimeve, përrallave, fabulave, legjendave dhe ndikimit në mëndjen, imagjinatën e fëmijëve dhe të rinjve duke luajtur një rol jetik në formësimin e identitetit kulturor dhe transmetimin e vlerave

njerëzore, projektimin dhe perspektivën e ndërtimit të brezave të ardhshëm.

Letërsia për fëmijë paraqet një komponent të fortë pedagogjik dhe duhet parë si një strategji reale edukative me potencial për t'u përfshirë në kurrikulat shkollore, gjithnjë duke patur parasysh veçoritë psikologjike, didaktike dhe letrare të përshtatura për fëmijë.

Përvojat e të nxënit të kryera në një mjedis miqësor shkollor gjenerojnë përmirësim të shëndetit emocional dhe arritje më të mira akademike. Letërsia përforcon lëndën nëpër disiplina të ndryshme, duke e bërë të mësuarin më të arritshëm, më të matshëm. Për shembull, tregimet historike mund të gjallërojnë historinë të kuptohet më mirë, dhe ato me temë shkencore mund të nxitë më tej kuriozitetin për botën natyrore dhe shkencore.

effective approach when learning vocabulary? Why do teachers apply this type of method during teaching? The instruments used are a closed questionnaire and an unstructured interview. The population of the study is 10 students of the Armed Forces and 5 teacher's working in the same field. Findings showed that implementing the interactive classroom model increased student engagement and improved retention.

Keywords: *interactive, military, learning effects*

1. HYRJE

Sipas Abildsness, Flottorp dhe Stensland, cituar në Yang (1), ndërveprimi është një nga karakteristikat e njohurive të përbashkëta shoqërore. Ndërveprimi është lidhja e mësuesit me nxënësit e tij/saj që krijon mjedisin mësimor. Palmer (2) beson se "mësimdhënia e mirë vjen nga identiteti dhe integriteti i mësuesit". Punimi tenton të rishikojë kurset e gjuhës angleze në Akademinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Përdorimi i modelit interaktiv si një qasje për mësimin e anglishtes ushtarake, veçanërisht leksikut, kërkon nevojën e tyre për të zhvilluar "kompetencën komunikuese". Dështimi për të artikuluar mendimet e tyre në anglisht sjell nevojën për të përdorur strategjinë më të mirë për tejkalimin e dyshimit në të folurit e një gjuhe të huaj. Është e vështirë të vihet një kufi midis asaj që kualifikohet si anglishte e përgjithshme dhe asaj që është anglishte për qëllime specifike. Edhe nëse një pjesë e "qëllimit specifik" mund të nënkuptojë një zhargon të caktuar profesional, njohuritë e tij janë të parëndësishme nëse studenti nuk ka aftësitë e nevojshme gjuhësore për t'i përdorur ato. Ajo që është më e rëndësishme në rastin e grupeve profesionale, me ushtarakët mes tyre, është ndërveprimi që ata kanë me mësuesin ose me njëri-tjetrin brenda klasës. Në fakt, aktivitetet ndërvepruese nuk

mund të kryhen nëse nxënësit nuk fitojnë të paktën një njohuri minimale për fjalorin bazë.

2. ANGLISHTJA E PËRGJITHSHME DHE USHTARAKE

Anglishtja ushtarake është një fushë e asaj që në përgjithësi quhet anglishte për qëllime specifike (ESP). Siç thanë Barnard dhe Zemach, cituar në Kolumban (3) se ESP do të ishte "një term ombrellë që i referohet mësimi të anglishtes për studentët që po mësojnë gjuhën për një arsye të caktuar pune ose studimi". Ata theksojnë se sa më specifik të jetë kursi, aq më i specializuar duhet të jetë mësuesi, por sado e lartë të jetë shkalla e specializimit, do të përfshihet një sasi e gjuhës angleze të përgjithshme në kontekst. Për më tepër, shkalla e specializimit nuk ndikon në teknikat ose metodat që mësuesi zgjedh për të dhënë mësim.

Sipas këtij përkufizimi, nuk është vetë gjuha ajo që është "e veçantë", por kërkesat e studentëve që e mësojnë atë. Ekzistojnë dy perceptime kryesore gjatë përcaktimit të kufirit midis 'Të Përgjithshmes' dhe 'Speciales'. Njëra është se ekziston një bërthamë e përbashkët që mbulon të gjithë fjalorin dhe gjuhën bazë të plotësuar nga një gjuhë shtesë e specializuar. Ideja alternative është se nuk ka kufi midis varieteteve thelbësore dhe të specializuara, pasi të gjithë përdorin një gjuhë, pavarësisht nga konteksti, janë 'qëllime specifike' (4, p.15-17).

Në rastin e anglishtes ushtarake ekziston një korpus specifik i fjalorit dhe zhanreve specifike që zakonisht do të përdoret në ushtri. Termat si komisar, turne në detyrë, paqeruajtës, oficer i mandatit japin vetëm disa shembuj, nuk ka të ngjarë të ndodhin në kontekste të tjera përveç nëse shërbejnë si referencë. Kjo lidhet drejtpërdrejt me materialin që mësuesit përdorin gjatë mësimdhënies. Sipas Tomlinson (5, p.89), vlerësimi dhe përshtatja e materialeve janë të një rëndësie jetike në lidhje me procesin mësimor dhe nuk duhet t'i lihen intuitave të improvizuara të mësuesve nën presionin e kohës dhe kufizimeve institucionale.

Dudley-Evans dhe St John (6, p.4) besojnë se një përkufizim i ESP duhet të pasqyrojë faktin se pjesa më e madhe e mësimdhënies në ESP, veçanërisht kur lidhet në mënyrë specifike me një profesion ose disiplinë të caktuar, përdor një metodologji që ndryshon nga ajo e përdorur në mësimdhënien e anglishtes me qëllim të përgjithshëm. Ata theksojnë dy aspekte të metodologjisë së ESP; e gjithë mësimdhënia e ESP duhet të pasqyrojë metodologjinë e disiplinave dhe profesioneve të cilave u shërben; dhe në mësimdhënien më specifike të ESP-së, natyra nëse ndërveprimi ndërmjet mësuesit dhe nxënësit mund të jetë

shumë i ndryshëm nga ai në një orë të përgjithshme të anglishtes.

3. ROLI I MËSUESIT NË MËSIMDHËNIEN NDËRVEPRUESE

Mësuesi ndërveprues është ai që respekton të gjithë nxënësit, i dëgjon dhe i ndihmon të zgjidhin vetë problemet si dhe shkëmbejnë ide të mira me mënyrën e veprimeve dhe qëndrimeve të tij/saj. Nxënësit janë të motivuar të mësojnë nga përmbajtjet ose mësimet e përshtatura me interesat dhe frymëzimin e tyre. Kjo nënkupton që mësuesit kanë ndikim dhe përgjegjësi për formimin e nxënësve si persona. Zeiger, siç citohet në Xhemajli (7, p.33), theksoi se roli i mësuesit nënkupton shumë më tepër sesa qëndrimin para nxënësve dhe vetëm mësimdhënien. Mësuesi ndjen përgjegjësinë për të njohur interesat dhe nevojat e nxënësve, për të zgjedhur materialin dhe gjithashtu për të dhënë vlerësimin e studentëve në fund. Roli i mësuesit nuk është vetëm të nxisë studentët të kuptojnë mësimin, por është edhe në detyrë të tij/saj të kuptojnë se çfarë duan të thonë studentët.

4. METODOLOGJIA

4.1 Plani i kërkimit

Ky punim përdor një metodë të përzier. Të dhënat sasiore do të mbledhen duke përdorur pyetësorë të mbyllur dhe të dhënat cilësore do të mbledhen duke përdorur intervista të pastrukturuara. Ai nënkupton një dizajn vijues shpjegues ku fillimisht ndodh analiza sasiore e të dhënave, e ndjekur nga mbledhja dhe analiza cilësore e të dhënave. Të gjitha të dhënat e mbledhura synojnë t'u përgjigjen dy pyetjeve kërkimore të përmendura në abstrakt, të cilat janë: 1. A e gjejnë nxënësit modelin ndërveprues si një qasje efektive gjatë mësimi të fjalorit? 2. Pse mësuesit aplikojnë këtë lloj metode gjatë mësimdhënies?

4.2 Pjesëmarrësit

Popullata e zgjedhur ishin 10 studentë në Akademinë e Forcave të Armatosura në nivelin 2222. Pjesë e hulumtimit ishin edhe 5 mësues që punojnë në të njëjtën fushë. Ky hulumtim realizoi një pyetësor të mbyllur me 3 pyetje dhe një intervistë të pastrukturuar me mësuesit duke përfshirë 2 pyetje. Të gjithë mësuesit dhe studentët ishin të vetëdijshëm se arsyeja e pyetësorit dhe intervistës ishte për shkak të një hulumtimi të kryerjes. Konfidencialiteti dhe privatësia u arrit duke mos publikuar të dhënat demografike të informatorëve si moshë, gjinia, statusi akademik etj. Studiuesi i dha

pjesëmarrësit informacionin se për çfarë studimi bëhet fjalë, sa kohë do të zgjasë studimi.

4.3 Instrumentet për mbledhjen e të dhënave

Instrumentet për mbledhjen e të dhënave përfshijnë një pyetësor të mbyllur të administruar për studentët e Forcave të Armatosura dhe intervista të pastrukturuara me 5 mësues. Instrumentet ishin burimi kryesor për mbledhjen e të dhënave.

4.4 Procedura e mbledhjes së të dhënave

Të gjitha të dhënat u mbledhën gjatë periudhës së studimit. Studimi përfshin një qasje parësore të të dhënave, pasi i gjithë informacioni i mbledhur ishte përshtatur me pyetjet e kërkimit. Për pjesën cilësore ajo përfshin një intervistë kokë më kokë. I gjithë procesi u zhvillua në Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë së Shqipërisë për rreth 2 orë.

4.5 Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga pyetjet e intervistës përdorën një analizë tematike të të dhënave duke përfshirë tema dhe koncepte të caktuara, ndërsa për të dhënat sasore u përdor statistika përshkruese e bazuar në numra. Proces i mbledhjes së të dhënave cilësore bëhet me dorë, duke përdorur një stilolaps dhe një letër.

4.6 Llojet e veprimtarive të përdorura në klasë

Përdorimi i modelit interaktiv në mësimdhënie nënkupton angazhimin e çdo nxënësi në klasë. Mund t'i ndihmojë studentët më të turpshëm të komunikojnë më mirë dhe i lejon mësuesit të ecë nëpër klasë, duke i vëzhguar dhe mbështetur ata. Një nga aktivitetet që përdor mësuesi është PUNA NE DYSHE. Nation (8) ka sugjeruar këtë formë aktiviteti si një mënyrë që përfshin detyrën e renditjes. Mësuesi i jep një deklaratë të gjithë klasës dhe u kërkon studentëve që të etiketojnë veten A dhe B. A duhet të argumentojnë për deklaratat dhe B duhet të argumentojë kundër. Deklarata është "gratë duhet të shërbejnë në role luftarake ose duhet të ketë shërbim të detyrueshëm ushtarak". Në këtë mënyrë studentët ushtarakë përpiqen të pasurojnë fjalorin e tyre përmes argumenteve. Një aktivitet tjetër që ka të bëjë me PUNËN NË ÇIFT është PËRSHTATJA E KUJTESËS. Sipas Brown, Roediger dhe McDaniel (9, p. 3) praktika e rikthimit është një strategji më efektive e të mësuarit sesa rishikimi me rilexim. Flashcards janë një shembull i thjeshtë. Rikthimi forcon kujtesën dhe ndërpret harresën. Këtë herë mësuesi përdor një grup letrash dhe kërkon nga secila dyshe që t'i vendosë letrat me fytyrë poshtë ndërmjet tyre. Një nga një ata mund të kthejnë dy letra. Nëse përputhen, mund t'i

mbajnë ato. Nëse nuk e bëjnë, i kthejnë përsëri. Disa nga fjalët e përdorura janë: Catcher Bullet, AnyMouse, Bang-Bang, Bird, Chancre Mechanic, Geardo etj. Për të zhvilluar më tej aftësitë e tyre të komunikimit studentët janë të lirë të ndajnë informacionin që ata kanë në lidhje me fjalët e paraqitura në kartat.

Veprimtaria e fundit që mësuesi përdor për të plotësuar nevojat e nxënësve ushtarakë është LEXIMI ME ZË. Strategjia e leximit me zë është një aktivitet në të cilin nxënësit lexojnë me intonacionin e duhur për të marrë më shumë informacion dhe për të përmirësuar shqiptimin e tyre. McKeown dhe Gentilucci (10) pretendojnë se leximi me zë të lartë është një metodë e matjes së procesit të leximit njohës dhe përdoret për të matur kompetencën e aftësive të leximit. Në përputhje me këtë, leximi me zë është një proces për të ndërtuar kompetencën e nxënësve për të kuptuar aftësitë e leximit.

Një student lexon një tekst në lidhje me betejën e Gettysburg. Ky aktivitet përfshin leximin e aftësive të të kuptuarit dhe riaktivizimin e fjalorit të mësuar më parë. Studentëve ushtarakë u kërkohet të përdorin një hartë dhe të vizatojnë lëvizjet taktike të ushtrive të përfshira në konflikt. Më pas nxënësit ndahen në grupe me tre persona për të diskutuar, analizuar dhe vlerësuar strategjitë ushtarake. Nxënësit udhëzohen të krijojnë një sërë situatash hipotetike që lidhen me rezultatin e mundshëm të betejës. Pra, nxënësit duhet të demonstrojnë një zotërim të mirë të funksioneve gjuhësore: përmbledhje, parafrazim etj.

4.7 Rezultatet e pyetësorit

Faza A e pyetësorit: Perceptimi i nxënësve për të nxënëit përmes modelit interaktiv

Pyetësori përbëhet nga 3 pyetje të mbyllura në përgjithësi për të mësuarit e tyre dhe për aktivitetet e përdorura në klasë. Nga ky seksion, studimi mund të zbulojë se si studentët po mësojnë fjalorin dhe të marrin më shumë informacion rreth strategjisë së tyre të preferuar të të mësuarit.

P1. Cila mënyrë e organizimit të klasës përdoret më së shumti në mësimin tuaj të anglishtes?

Nxënësve iu kërkua të zgjidhnin nga një shkallë prej 1 "kurrë" deri në 5 "ditë". Rezultatet e kësaj pyetjeje janë renditur më poshtë:

Tabela 1 Frekuenca e përdorimit të aktiviteteve në klasë

Aktivitet	Ditore	Javore	Mujore	Ndonjëherë	Asnjëherë
Mësimi frontal	7		3		
Puna në çift	4	5		1	
Puna në grup	3	3		4	
Puna individuale	6			4	

P2.Vlerësoni aktivitetet e mëposhtme të klasës për të mësuar anglisht? (1-Më pëlqen, 2-Më pëlqen ndonjëherë, 3- Nuk më pëlqen).


Tabela 2 Vlerësimi i përdorimit të aktiviteteve në klasë

Aktivitetet	Më pëlqen	Më pëlqen ndonjëherë	Nuk më pëlqen
Debatet	7	2	1
Lidhja e kujtesës	7	3	
Leximi me zë	4	3	3

P3. Cila nga aktivitetet e mëposhtme mendoni se ju ndihmon të mësoni përmendësh më mirë fjalët? Rrethoni a, b ose c.

a. debat b. përputhja e kujtesës c. lexim me zë të lartë

Figura 1 Aktivitetet për memorizimin e fjalëve



Shënim. Ka tre ngjyra në tabelë. Ngjyra blu përfaqëson aktivitetin më të mirë që ndihmon në memorizimin më të mirë, ngjyra portokalli përfaqëson aktivitetin e dytë për memorizimin e fjalëve dhe ngjyra gri përfaqëson aktivitetin më

të vogël që ndihmon në memorizimin më të mirë të fjalëve

4.8 Rezultatet e intervistës

Faza B e intervistës: Perceptimi i mësuesve për modelin ndërveprues në klasë.

Për t'i lënë mësuesit e intervistuar të shprehin saktësisht qëndrimet dhe opinionet e tyre, këto intervista bëhen në gjuhën shqipe. Intervista është realizuar me 5 mësues që punojnë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ishin 3 femra dhe 2 meshkuj. Pyetjet e përfshira janë paraqitur më poshtë:

P1. Si e prezantoni zakonisht fjalorin e ri të përdorur në aktivitetet gojore dhe si promovoni ndërveprimin?

Tabela 3 Kodet dhe temat e pyetjes 1

Pjesëma rrësit	Kodimi i fjalës	Kodet	Temat
M1	Shumicën e kohës preferoj të përdor leximin me zë të lartë për të mësuar fjalorin sepse nxënësit kanë nevojë për lexim.	leximi me zë fjalori	Pasurimi i fjalorit nëpërmjet të lexuarit
M2	E kam të vështirë kur nxënësit ende nuk i shqiptojnë mirë fjalët, kështu që e shoh të dobishme të përdor përsëritjen	përsëritja shqipërimi	Vështirësi me shqipërimin
M3	Preferoj të përdor tema të ndryshme për diskutim për të promovuar fjalorin.	Tema fjalori	Përdorimi i temave për diskutim

M4	Ushtrime me gojë duke përfshirë bashkëlokacionet për ESP dhe debat, gjithashtu në varësi të nivelit të studentëve .	Ushtri me Kolokacione për ESP debate	Jepni ushtrime me bashkëlokacione për ESP dhe debat
M5	Unë zgjedh forma të ndryshme, për shembull shikimi i filmave ushtarakë sesa shënimi i fjalëve që kujtojnë nga filmi ose diskutimi është aktiviteti im i preferuar.	Të parit film diskutim aktivitet	Mësimi i leksikut përmes filmave dhe diskutimit

P2. Cilat aktivitete të të mësuarit të fjalorit aplikoni në klasë: prezantim, lexim me zë, punë në dyshe apo diskutim? Pse aplikoni këtë lloj metode?

Tabela 4 Kodet dhe temat e pyetjes 2

Pjesëma rrësit	Kodimi i fjalës	Kodet	Temat
M1	Më së shumti e përdor leximin me zë, sepse më duket interesant .	Leximi me zë të lartë interese nte	Përdorimi i i leximit gjatë mësimdhënies
M2	Unë përdor diskutimin për të ndërtuar fjalorin	diskutimi	Debate për promovimin e fjalorit

M3	Puna në çift dhe diskutimi është metoda ime e preferuar e përdorur në klasë.	Metoda Punë në çift diskutim	Përdorimi i metodës së punës në dyshe dhe diskutimi t në mësimdhënie
M4	Kam përdorur rrallë prezantim . Kryesisht përdor punën në çift.	Rrallë Prezantimi Punë në çift	Prezantimi është një formë e rrallë e mësimdhënies
M5	Mësimdhënia përmes diskutimit ndihmon në promovimin e leksikut dhe rrjedhshmërisë.	Diskutimi rrjedhshmëri	Të qenit i rrjedhshëm përmes diskutimit

5. DISKUTIMI

Ky studim kishte për qëllim përgjigjen e disa pyetjeve në lidhje me modelin interaktiv të përdorur në klasë për të mësuar kushte ushtarake. Rezultatet e pyetjes së parë të pyetësorit treguan se aktivitetet më të përdorura në klasë ishin mësimdhënia frontale, puna në dyshe dhe puna në grupe. Gjithashtu, këtu vlerësohet se aktiviteti më i preferuar ishte përputhja e kujtesës dhe debati. Për më tepër, të dhënat sugjeruan që leximi me zë të lartë ishte aktiviteti më i vogël që i ndihmoi studentët të mësojnë përmendësh më mirë fjalët.

Nga ana tjetër, gjetjet, në lidhje me intervistën me mësuesit, treguan se ata paraqesin fjalor të ri kryesisht përmes debateve. Mësuesit përfshijnë edhe aktivitete të tjera si: shikimin e filmave dhe më pas shkrimin e fjalëve të reja, përdorimin e ushtrimeve për të mësuar koleksione etj. Për më tepër, pyetja e dytë kishte të bënte me aktivitetet që mësuesit ofrojnë për mësimin e fjalëve të reja. U zbulua se ata kryesisht përdorin diskutime, ata rrallë përdorin prezantim ose duke lexuar me zë të lartë. Gjithashtu, puna në çifte ishte një aktivitet tjetër që ata preferuan të përdorin në klasë.

Për më tepër, studimi mbështet Dudley-Evans dhe St John (6) të cilët arrijnë në përfundimin se për mësimdhënien në ESP mësuesi duhet të përdorë një metodologji që ndryshon nga ajo e mësimdhënies së anglishtes së përgjithshme. Të gjitha rezultatet duhet të merren parasysh kur bëhet fjalë për mësimin e leksikut dhe përmes një modeli interaktiv.

Të gjitha të dhënat ofrojnë një pasqyrë të aktiviteteve të fjalorit që studentët preferojnë të përdorin kur mësojnë anglisht dhe aktivitetet që mësuesit ofrojnë për të mësuar një fjalor të tillë. Sidoqoftë, rezultatet tregojnë mungesë të përgjithësueshmërisë pasi përfshin vetëm studentë ushtarakë që mësojnë anglisht dhe jo një madhësi të madhe të mostrës.

Nevojitet një kërkim i mëtejshëm për një kuptim më të mirë të fjalorit mësimor nëpërmjet modelit ndërveprues dhe gjithashtu për aktivitetet që nxënësit preferojnë kur mësojnë të zgjerojnë leksikun.

6. PËRFUNDIME

Problemi i këtij studimi ishte të zbulonte nëse nxënësi e konsideron atë tërheqës kur aplikohet modeli interaktiv në klasë dhe gjithashtu pse mësuesit aplikojnë këtë lloj metode në klasë. Ndërsa modeli i ndërveprimit po bëhet gjithnjë e më i preferueshëm në klasë, mësuesit duhet të zbatojnë aktivitete të ndryshme për ta promovuar atë. Është shumë e qartë nga provat se mësuesit përpiqen të zbatojnë disa aktivitete të tilla si diskutimi ose puna në çift në klasë për të nxitur ndërveprimin gjatë mësimdhënies së leksikut, por ata gjithashtu hasin edhe të meta të tilla si: mjedisi fizik, aftësia e nxënësve për të mësuar nëpërmjet këtyre aktiviteteve etj. Gjetjet duhen interpretuar me kujdes për shkak të kufizimit të studimit, por inkurajojnë edhe studime të mëtejshme kur bëhet fjalë për përdorimin e aktiviteteve të ndryshme për mësimin e leksikut dhe veçanërisht atij ushtarak.

MIRËNJOHJE

Ky punim nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e jashtëzakonshme të udhëheqëses sime, Prof. Klodeta Dibra. Entuziazmi dhe vëmendja e saj ndaj detajeve kanë qenë një frymëzim dhe e kanë mbajtur punën time në rrugën e duhur që kur hartova këtë punim. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj të gjithë pjesëmarrësit e hulumtimit që ranë dakord të plotësojnë pyetësorin, koleget e mia që kontribuan me idetë dhe opinionet e tyre rreth temës sime. Në fund, dua të falënderoj familjen time për durimin dhe inkurajimin e tyre.

REFERENCAT

1. Yang, Lei. An Interactive Learning Model to Enhance EFL Students' Lexical Knowledge and Reading Comprehension. *Sustainability*. 2023; 15(8): 6471. <https://doi.org/10.3390/su15086471>
2. Parker J. Palmer. The courage to teach: Exploring the Inner Landscape of a Teacher's Life. San Francisco: John Wiley & Sons; 2007.
3. Kolumban, Kinga. The Communicative tasks in teaching Military English. *The Scientific Informative Review*. 2020; XVIII (2) doi: 10.19062/1842-9238.2020.18.
4. Basturkmen H. Ideas and Options in English for Specific Purposes. London: Taylor and Francis e-library; 2008.
5. Tomlinson, B. Developing materials for language teaching. London/New York. Continuum; 2003.
6. Dudley-Evans, T. St John, and M. Developments in ESP. Cambridge: Cambridge University Press; 1998.
7. Xhemajli, Arbana. The role of the teacher in interactive teaching. *International Journal of Cognitive Research in Science, Engineering and Education*. 2016; 4 (1): 33. <https://doi:10.5937/IJCRSEE1601031X>
8. Nation, I. S. P. Learning Vocabulary in another Language. Cambridge: Cambridge University Press; 2001.
9. Brown, P. C., Henry L. Roediger III, Mark A. Mc Daniel. Make it stick: The science of successful learning. The Belknap Press of Harvard University Press. 4. ProQuest Ebook Central; 2014.
10. McKeown, Regina G., and James L. Gentilucci. Think-Aloud Strategy: Metacognitive Development and Monitoring Comprehension in the Middle School Second-Language Classroom. *Journal of Adolescent & Adult Literacy - J ADOLESC ADULT LITERACY*. 2007; 51(2): 136-147. <https://doi.org/10.1598/JAAL.51.2.5>

Shtojca 1 PYETËSORI

Çfarë mendoni për modelin interaktiv si një mënyrë për të mësuar termat ushtarakë?

Ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme në lidhje me përdorimin tuaj të aktiviteteve të ndryshme në mësimin e termave ushtarakë. Përgjigjet tuaja do të përdoren vetëm për qëllime

kërkimore dhe ato nuk do të ndikojnë në punën tuaj shkollë.

Emri: _____ Klasa: S.____ Klasa nr. _____
Seksi: M/F Data: _____

P1. Cila mënyrë e organizimit të klasës përdoret më së shumti në mësimin tuaj të anglishtes?
Zgjidhni nga 1 deri në 5 prej 1 "kurrë" deri në 5 "ditë". Ju lutemi, shënoni (✓) kutinë e duhur .

Aktivitetet	Ditore	Javore	Mujore	Ndonjëherë	Asnjëherë
Mësimi frontal					
Puna në çift					

P2.Vlerësoni aktivitetet e mëposhtme në klasë për mësimin e anglishtes? (1-Më pëlqen, 2-Më pëlqen ndonjëherë, 3-Nuk më pëlqen).

Aktivitetet	Më pëlqen	Më pëlqen ndonjëherë	Nuk më pëlqen
Debatet			
Lidhja e kujtesës			
Leximi me zë			

P3. Cila nga aktivitetet e mëposhtme mendoni se ju ndihmon të mësoni përmendësh më mirë fjalët? Rrethoni a, b ose c.

a. debat b. përputhja e kujtesës c. lexim me zë të lartë

Faleminderit për kontributin tuaj!

MËSIMI ONLINE GJATË COVID-19. MANGËSITË, PËRPARËSITË DHE ÇFARË MUND TË BËHET MË SHUMË

MSC. Jonida ÇOBANI

*Gjimnazi "Ali Demi" Vlorë
cobanijonida@yahoo.com*

Abstrakt

Nga fillimi i marsit të vitit 2020, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, mësimi online nisi të aplikohet në të gjithë vendin në forma të ndryshme. Mësuesit dhe nxënësit, veçanërisht ata të fizikë, përballeshin me sfida të reja, duke filluar nga organizimi dhe zhvillimi i mësimi nëpërmjet aplikacioneve të ndryshme për komunikim online, deri te platformat si Google Classroom dhe Google Meet, të cilat e mundësonin ngarkimin e materialeve mësimore, zhvillimin e mësimi në kohë reale dhe përdorimin e tabelave interaktive të fizikës dhe formula të ndryshme fizike. Nxënësit gjithashtu ballafaqoheshin me sfida të reja, duke e gjetur më të vështirë të kuptonin lëndën e fizikës, e cila tashmë për ta ishte e vështirë, pa mundësinë për t'u konsultuar dhe komunikuar drejtpërdrejtë me mësuesit dhe shokët e klasës. Megjithatë, edhe pse e panjohur në këtë shkallë të gjerë nga nxënësit dhe mësuesit, mësimi online sjell edhe disa përfitime. Nëpërmjet sondazhit të kryer, u zbulua se puna e pavarur, aksesimi i leksioneve gjatë gjithë kohës dhe video-leksioneve të disponueshme për shpjegimin e fenomeneve fizike solli rritje në nivelin e përqendrimit dhe aftësisë së nxënësve për të punuar individualisht.

Fjalët kyce: *Classroom, Covid-19, Google*

Abstract

From the beginning of March 2020, due to the pandemic from Covid-19, online learning began to be applied throughout the country in various forms. Teachers and students, physics subjects, face new challenges, starting from the organization and development of the lesson through different knowledge of online communication, to platforms such as Google Classroom and Google Meet, which are difficult to be loaded with learning materials, real-time learning sentence and common interactive whiteboards to draw physics reactions and various physics formulas. The students were also faced with the challenges of finding new understandings in the subject of physics, which has been difficult for them, without consulting and communicating with teachers and classmates. However, because it is not widely known by students and teachers, online learning also brings some things. Through the survey conducted, it was discovered that independent work, access to full-time lectures and video lectures available for solving physics phenomena improved the level of concentration and the ability of students to work individually.

Keywords: *Classroom, Covid-19, Google*

1. HYRJE

Izolimi i shkaktuar nga pandemia e COVID-19, së bashku me panikun dhe situatën ekonomike globale të prekur nga kjo krizë, ka sjellë në vëmendje një diskutim thelbësor lidhur me edukimin në distancë. Megjithatë është herët për të bërë përfundime të qarta rreth se si do të ndryshojë bota pas krizës së pandemisë, është evidente se arsimit, në të gjitha nivelet, ka pësuar ndryshime të mëdha. Përdorimi i teknologjisë në arsim është një realitet i njohur prej kohësh, por pandemia e COVID-19 e ka bërë atë një nevojë të pashmangshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor.

Në reagim ndaj frikës dhe panikut që solli virusi, shumë shtete dhe institucione arsimore vendosën të mbyllnin fizikisht shkollat dhe universitetet, duke i kthyer mësimet në një ambient online. Kështu, mbi 1.2 miliardë nxënës u gjetën të privuar nga aksesimi në klase. Në këtë kontekst, ndikimi i pandemisë në arsim ndryshon ndjeshëm nga një vend në tjetrin, duke u bazuar në shumë faktorë të tilla si nivelin e zhvillimit, ekonominë, teknologjinë, dhe faktorë të tjerë relevante. Për të përballuar këtë situatë dhe për të përgatitur për të ardhmen, është e rëndësishme të zhvillojmë strategji dhe skenarë për edukimin në distancë. Megjithatë, përpara se të kalojmë në këto strategji të reja, është e nevojshme të analizojmë efektet e pandemisë në të gjitha palët e përfshira në procesin arsimor.

Në fillim të pandemisë, vendimet për mbylljen e shkollave u morën pa informacion të mjaftueshëm shkencor. Kjo zhvendosje e menjëhershme nga mësimi tradicional në distancë solli sfida të mëdha për të gjithë pjesëmarrësit. Në rastin e Shqipërisë, edukimi në distancë ishte një risi e papritur, pasi nuk kishte bazë ligjore për të mbështetur një mësim të tillë. Problemi i infrastrukturës teknologjike është një tjetër sfidë, duke marrë parasysh mungesën e aksesit të internetit në shumë zona të vendit.

Në një kohë kur të dhënat tregojnë se shumica e familjeve nuk kanë akses në internetin e shpejtë, është e qartë se një pjesë e madhe e nxënësve kanë vështirësi në marrjen e një arsimit efektiv në distancë. Këto sfida tregojnë nevojën për një përgjigje të përshtatshme për arsimin në distancë, duke përfshirë zhvillimin e

infrastrukturës teknologjike dhe përmirësimin e legjislacionit për të mbështetur këtë format mësimor.

2. MËSIMDHËNIA ONLINE DHE ROLI I MËSUESIT

2.1. Historiku i mësimdhënies online

Mësimi në distancë ka origjinën e tij në shekullin XIX në Europë dhe SHBA, ku pionierët e kësaj metode përdorën teknologjitë e kohës së tyre, si postën, për të ofruar mundësi arsimimi për ata që nuk mund të shkonin në shkollë. Sot, mësimi në distancë përdor teknologjinë moderne për të lejuar interaktivitetin midis nxënësve dhe mësuesve. Kjo përfshin përdorimin e internetit, telefonisë, radiove, televizionit, dhe teknologjive të tjera. Shumë vende e kanë përdorur atë si pjesë të sistemit të tyre arsimor. Ideja e "Universitetit në ajër" u sugjerua në vitin 1963, ndërsa përdorimi i radios dhe televizionit për qëllime mësimore ka qenë praktikë e zakonshme. Mësimi në distancë ka qenë e suksesshme, veçanërisht në vende të zhvilluara, dhe jep mundësi për arritje akademike si gradat master dhe doktor. Zhvillimi i teknologjisë së komunikimit, si radioja dhe televizioni, ka bërë të mundur për mësuesit të ofrojnë programe edukative për një audiencë të gjerë, duke përhapur mundësitë e arsimit në distancë. Kjo metodë ka rritur aftësinë e komunikimit midis mësuesve dhe studentëve. Me përhapjen e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, arsimi në distancë ka hyrë në një epokë të bashkëpunimit global dhe rrjetëzimit. Cilësia dhe akreditimi i programeve të arsimit në distancë janë bërë shumë të rëndësishme. Këto programe përdorin një sistem telekomunikues për të lidhur studentët dhe mësuesit në një ambient virtual. Përkufizimet kryesore të mësimin në distancë përfshijnë faktin që është një proces individual, ndarja gjeografike midis mësuesve dhe studentëve, dhe përdorimi i telekomunikacionit interaktiv për ndërveprimin midis tyre.

2.2. Covid-19 dhe efektet në mësimdhënie

Pandemia e vitit të kaluar ka rritur vlerësimin dhe rëndësinë e edukimit publik në mënyrë të ndjeshme. Prindërit janë përqendruar

në punën nga shtëpia dhe kujdesin për fëmijët e tyre, duke ndikuar thellë në rolin e edukimit në jetën sociale, ekonomike dhe stabilitetin e vendit. Është e vështirë të mos vlerësohet momenti aktual si një mundësi për të përmirësuar sistemin arsimor dhe për të ndërtuar një vizion të qartë për të ardhmen e edukimit. Trajtimi i disa temave kyçe është i domosdoshëm për të arritur këtë, përfshirë mësimin online, komunikimin mësues-prindër, trajnimin e mësuesve për mësim online, mbështetjen shtesë për mësuesit, si dhe planifikimin bazuar në përvojat e mësimdhënies së vitit të kaluar.

Shkollat dhe drejtoritë arsimore kanë reaguuar ndryshe ndaj nevojës së menjëhershme për mësim online, duke zbuluar dallimet në cilësinë e mësimdhënies midis shkollave rurale dhe atyre urbane. Mungesa e aksesit në internet dhe pajisjeve teknologjike ka ndikuar në këtë proces. Është koha që shkollat të bëhen qendra për komunitetin në procesin e nxënës dhe mbështetjes së fëmijëve, duke përdorur praktikatat e përdorura gjatë pandemisë për të inkurajuar edukimin e fëmijëve edhe pasi pandemia të ketë mbaruar.

Pyetja kryesore është se a është e mundur që mësimi i përdorur gjatë pandemisë të sjellë një përgatitje më cilësore të nxënësve dhe mësimdhënja pas pandemisë të jetë më efektive se më parë. Trendet gjatë pandemisë ofrojnë një udhërrëfyes për të kuptuar impaktin e Covid-19 në edukimin global dhe për të zhvilluar strategji për transformimin e sistemit arsimor pas pandemisë. Një nga fenomenet që u vërejt gjatë pandemisë ishte diferencimi i nxënësve dhe studentëve sipas shtresave shoqërore në përdorimin e teknologjisë për mësim online. Edukimi dixhital është kritik për të parandaluar këtë diferencim dhe për të adresuar hendekun e përdorimit. Është e rëndësishme që institucionet arsimore të studiojnë këtë situatë dhe të zhvillojnë strategji për të përmirësuar nivelin e edukimit dixhital për mësimdhënësit dhe shoqërinë në përgjithësi. Pasoja e papritura të pandemisë në sistemin arsimor kërkojnë përpjekje për të zvogëluar pasigurinë për të ardhmen e arsimit.

2.3. Covid-19 në Shqipëri

Situata e pandemisë COVID-19 detyroi Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) të mbyllë të gjitha institucionet arsimore që nga data 9 mars 2020, me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit dhe mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve. Fillimisht, mbyllja ishte për dy javë, por u shty për dy javë të tjera. Për të siguruar vazhdimësinë e mësimin, MASR, ASCAP dhe DPAP implementuan mësimin në distancë, duke përdorur leksione të xhiruara në RTSH dhe klasa virtuale në platforma si Google Classroom, Zoom, Skype, dhe WhatsApp.

Në këtë proces, problemet lidhur me aftësinë e mësuesve për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie në distancë u evidentuan. Shumë mësues dhe lektorë nuk kishin formimin e duhur për këtë. Kështu, mësimdhënja u kufizua shpesh në dërgimin e detyrave me aplikacione si WhatsApp, Viber dhe Messenger, ose në raste të rralla në videoshembuj të shkurtra.

Në këtë kontekst, ndërveprimi mes mësuesve dhe nxënësve ishte i kufizuar dhe mungonte inovacioni në mësim. Megjithatë, bashkëpunimi mes mësuesve, prindërve dhe nxënësve u rrit, duke shfrytëzuar rrjetet sociale dhe platformat online për shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen në mësim.

Prindërit, megjithëse nuk janë mësues, ndihmuan fëmijët e tyre në përvetësimin e njohurive, duke u mbështetur në klasat virtuale dhe komunikimin online. Kështu, edukimi në distancë u bë mënyra e vetme për vijimin e procesit të mësimin, ndërsa bashkëpunimi mes të gjithë palëve u bë thelbësor për suksesin e këtij procesi.

2.4. Roli i mësuesit të fizikës përgjatë mësimin në distancë

Në kohën e pandemisë, mësimi i fizikës u përball me ndryshime të mëdha. Klasat online u bënë normë e re për t'u përballur me këtë situatë të jashtëzakonshme. Në këtë kontekst, mësimi tradicional në klasë u bë i rrezikshëm për shkak të mundësisë së përhapjes së virusit. Për mësuesit, veçanërisht ata më të moshuar, kjo kaloi në një sfidë, pasi opsionet e mësimin online ishin të reja dhe të vështira për t'u përshtatur.

Për të

përballuar këtë situatë, trajnimet e vazhdueshme nga institucionet arsimore dhe ndihma e kolegëve më të rinj u bënë thelbësore. Një burim i rëndësishëm i mësimi ishin videot në platforma si YouTube. Kjo ndryshim i menjëhershëm kërkoi një përpjekje të madhe nga mësuesit, veçanërisht ata të lëndës së fizikës. Mësuesit e fizikës u përballën me sfida të reja të cilat nuk i kishin përjetuar më parë. Veçanërisht, nevoja për të shpjeguar reaksione fizike, për të kryer punë laboratorike, dhe për të përdorur figura dhe grafika të ndryshme ishin sfida të konsiderueshme. Për të mbuluar këto nevoja, ata filluan të përdornin platforma online si Zoom, Google Classroom, Google Meet, dhe Skype për të zhvilluar mësimin në distancë.

Aplikacionet online si Google Classroom, Moodle dhe Canvas u bënë të rëndësishme për zhvillimin e mësimi online. Këto platforma ofronin mundësinë për prezantime, zhvillimin e testeve, ushtrimeve në libër dhe diskutimeve në kohë reale. Për të shpjeguar koncepte fizike, mësuesit përdornin prezantime PowerPoint, video, dhe demonstrime të ndryshme. Këto metoda kërkonin një përpjekje të shtuar nga ana e mësuesve të fizike, por siguronin një përvojë mësimore efektive edhe në kohë të vështira.

2.5. Sfidat dhe përparësitë nga zhvillimi i mësimi online në lëndën e Fizikës

Paraqitja e sfidave dhe përparësive nga zhvillimi i mësimi online në lëndën e fizikës ka qenë një proces i ndërlikuar. Pandemia e COVID-19 ka ndikuar në jetën e fëmijëve dhe prindërve të tyre, duke i detyruar ata të përshtaten me mësimin online. Kjo ka sjellë shumë sfida, duke përfshirë ndryshimin e rutinës ditore, mungesën e aktiviteteve sociale, dhe mungesën e shërbimeve. Prindërit janë raportuar të ndjehen në stres dhe të mbingarkuar duke përballuar përgjegjësitë shtesë të kujdesit për fëmijët në kohën e pandemisë. Një nga sfidat kryesore është mungesa e kompetencave të prindërve në fushën e fizikës, duke shkaktuar ankth dhe frikë për progresin e fëmijëve në këtë lëndë. Megjithatë, ka edhe përparësi të ndjeshme të kësaj periudhe. Fëmijët kanë pasur mundësinë të krijojnë rutina të reja, të përmirësojnë shëndetin e tyre dhe të jenë më të përfshirë në

aktivitetet familjare. Përveç kësaj, prindërit kanë treguar angazhim dhe mbështetje të shtuar për fëmijët e tyre, duke e bërë këtë periudhë një mundësi për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të tyre. Gjithashtu, nxënësit kanë pasur sukses në përshtatjen me mësimin në distancë, duke përmirësuar shkathtësitë e tyre në përdorimin e teknologjisë dhe duke përfituar nga burimet online për të mësuar për fizikën. Kështu, edhe pse ka pasur sfida, ka pasur edhe përparësi të konsiderueshme në procesin e mësimi online në lëndën e fizikës gjatë kohës së pandemisë.


3. PYETËSORË DHE REZULTATE

Në studimin e mëposhtëm kanë marrë pjesë 100 mësues edhe 500 nxënës. Të gjithë pjesëmarrësit u pyetën rreth eksperiencës së tyre gjatë zhvillimit të mësimi online në periudhën së pandemisë, prej Marsit 2020 deri në Shkurt 2021.

Pyetësi për mësuesit.


Nga rezultatet e marra nga mësuesit vihet re se pothuajse në të gjitha shkollat tremujori i fundit i vitit shkollor 2018-2019 u zhvillua online. Vetëm 8% i mësuesve raportoi se vazhduan mësimin normalish në klasa. Të tilla raste janë ato të shkollave private me numër shumë të vogël nxënësish. Me fillimin e vitit të ri shkollor vihet re se një numër mjaft i lartë i mësuesve raportojnë se zhvillojnë mësim të kombinuar (online dhe në klasa) dhe me lehtësimin e masave anticovid gjithmonë e më shumë institucione kanë rifilluar zhvillimin e procesit mësimor në klasa.

1. Si po e organizon institucioni juaj mësimin online			
	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Online	92	34	28
I kombinuar (online dhe në klasë)	0	61	69
Në klasa	8	5	13




Me fillimin e pandemisë vetëm 4% e mësuesve raportuan se nuk kishin akses të internetit në shtëpitë e tyre. Ky numër raportimesh shumë shpejt shkoi 0%. Nga raportimet e marra në të tre tremujorët e zhvillimit të pyetësorit shihet qartë se problem i aksesit në internet është zgjidhur mjaft shpejt.

2. A keni akses të internetit në shtëpi			
	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Po	96	100	100
Jo	4	0	0



Një pjesë e madhe e shkollave dhe mësuesve kanë vazhduar të përdorin edhe gjatë pandemisë të njëjtat programe apo burime informacioni që përdornin edhe para saj. 18% e mësuesve edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit akademik 2020-2021 u shprehën se nuk janë të kënaqur me resurset që përdornin për zhvillimin e mësimi online. Vihet re edhe vështirësi për të ndërthurrur burime të ndryshe informacioni gjatë zhvillimit të një ore mësimi.


3. A jeni të kënaqur me programet dhe teknologjinë që përdor institucioni ku ju punoni?			
	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Po. Kam punuar vazhdimisht me këto programe	63	63	65
Pak. Kam nevojë për më shumë burime online.	18	6	18
As po as jo. Kam burime të mjaftueshme por ndërthurja e tyre në një orë mësimore paraqet mjaft vështirësi.	19	31	17



Solidariteti mes kolegëve dhe insitucioneve arsimore ishte një nga karakteristikat që


spikatën gjatë kësaj pandemie. Mësuesit raportojnë se bashkëpunimi mes kolegëve ishte në masën 72% në periudhën Mars-Qershor dhe 88 % në periudhën Dhjetor-Shkurt. Gjatë periudhës Gusht-Nëntor, e cila përkon me fillimin e vitit të ri akademik, u raportua bashkëpunim mes mësuesve të të njëjtës lëndë, 48%.

4. Sa ju kanë ndihmuar kolegët gjatë kësaj eksperience?			
	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Kemi punuar në grup brenda shkollës	72	49	88
Koha për të përgatitur materiale të reja ishte e shkurtër dhe secili bëri më të mirën që mundej	11	3	0
Mësuesit e të njëjtës lëndë në shkollë të ndryshme punuan së bashku për të përshtatur materialet	0	48	12



Nga përgjigjet e mësuesve vihet re një nevojë e vazhdueshme për trajnime të mëtejshme të tyre. Edhe pse ky numër është i vogël, 4%, gjatë vitit akademik 2020-2021, mësuesit janë të mendimit se rritja e zhvillimi i aftësive të tyre profesionale do të rezultonte në përshtatje më efikase dhe të shpejtë në raste të tjera emergjence.


5. Sa ju ka ndihmuar institucioni ku ju punoni me burime informacioni, trajnime apo bërje aplikacionesh të nevojshme për zhvillimin e mësimi online?			
	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Shumë	28	45	45
Përdorim të njëjtat burime online si vitet e kaluara	59	51	51
Në përgjithësi jam i kënaqur por do të dëshiroja trajnime më të shpeshta.	13	4	4



69% e mësuesve raportoi se zhvillimi i mësimi tërësisht online ka qenë një eksperiencë mjaft stresuese. Menaxhimi i orëve mësimore në një system krejt të ri dhe stresi i akumuluar tek nxënësit si pasojë e mungesës së socializimit dhe bashkëpunimit me njëri tjetrin prej një periudhe rreth 1 vjecare, pastaj një ndikim mjaft të


konsiderueshëm nënritjen e vështirësisë ë zhvillimit të mësimin online.

6. Sa stresuese ka qenë eksperiencë e mësimdhënies online gjatë pandemisë në lëndën e Kimisë?	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Mjaft stresuese (Ndryshimi i sistemit të mësimdhënies në lëndën e Kimisë dhe bërja e mjaft të vështirë organizimin e orëve mësimore)	38	32	69
Disi stresuese (Nuk është mënyra më e mirë por është një mënyrë që mund të realizojmë në këto kushte)	62	68	31




Mësuesit e lëndës së fizikës u shprehën se komunikimi i vazhdueshëm me nxënësit e tyre është mjaft i rëndësishëm dhe për këtë arsye ata e shijojnë zhvillimin e mësimin të fizikës online. Rreth 20% e tyre u shprehën se rregullisht gjatë zhvillimit të orëve mësimore nuk ishte ashtu sic duhej. 34% e tyre raportuan se lënda e fizikës paraqet sfida mjaft të mëdha për t'u zhvilluar tërësisht online por, në situatën e ndodhur është një mundësi komunikimi mësues- nxënës.

7. A ju pëlqen të zhvilloni mësimin e Kimisë online?	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Po, Jam e kënaqur kur komunikoj me nxënësit	51	59	46
Jo, Konsumoj shumë kohë duke u përpjekur të vë re rregullisht zhvillimin e mësimin	28	16	20
Nuk është më e mira por është një mundësi komunikimi	21	35	34




Nga raportimet e marra nga mësuesit duket qartë se nevoja për zhvillimin e konsultimeve të vecanta me nxënësit kanë qenë më të shpeshta gjatë tremujorit të tretë të vitit akademik 2019-2020. Me fillimin e vitit të ri shkollor raportohen shifra shumë të ulëta konsultimesh të vecanta të zhvilluara në mënyrë individuale.

8. Sa shpesh keni konsultime të vecanta me secilin nxënës?	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Sa herë kanë nevojë	74	17	24
Të pakëson një herë në javë	8	32	21
Në një moment të caktuar të orës mësimore nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe komunikoj me secilin prej tyre.	18	51	55




Pjesa më e madhe e mësuesve, rreth 70% të tyre, mendojnë se suprti i prindërve gjatë zhvillimit të mësimin online është mjaft i rëndësishëm. Suporti nga familjet ndikon në mënyrë direkte në rezultatin dhe përshtatjen e nxënësve me ndryshimet e ndodhura.

9. Sa i rëndësishëm është suporti i prindërve gjatë këtij procesi sipas eksperiencës suaj?	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Shumë i rëndësishëm	71	68	77
I rëndësishëm vetëm në lëndë që nxënësi paraqet mungesë pjesëmarrjeje e interesi	12	19	17
I rëndësishëm vetëm për fëmijë të caktuar	17	13	6



Rezultatet e pritura janë arritur në masën më të madhe gjatë trmujorit të parë të vitit të ri akademik. Tremujori i tretë i vitit shkollor 2019-2020 përkon me arritjet më të ulëta sipas priyshmërive të mësuesve. Tremujori i dytë i vitit akademik 2020-2021 u shoqërua me ulje të rezultate të pritura të nxënësve.

10. A po arrijnë nxënësit tuaj rezultatet e pritura në orën e kimit?			
	Mars-Qershor	Gusht-Nëntor	Dhjetor-Shkurt
Po	23	46	39
Jo (prishmëritë janë mjaft më të larta)	44	16	19
Disi (mund të bëhet më mirë por duhet pak më shumë punë dhe përqendrim nga nxënësit)	33	38	42



4. KONKLUZIONE

Nga raportimet e marra nga mësuesit për sa i përket zhvillimit të mësimin online në lëndën e fizikës u vu re se:

- Mësuesit e fizikës duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale përmes trajnimeve të vazhdueshme, duke siguruar që mësimi online të jetë i suksesshëm.
- Pandemia e Covid-19 solli sfida të papritura në arsim, por përmes përpjekjeve të mësuesve dhe nxënësve, mësimi online doli i suksesshëm.
- Mësuesit thanë se mësimi online i fizikës ka sjellë stres, por gjithashtu i ka furnizuar ata me aftësi të reja teknologjike dhe të menaxhimit të kohës.
- Në fillim, mësimi online ishte i stresueshëm, por gjatë vitit shkollor situata stabilizohet. Megjithatë, tremujori i dytë i këtij viti akademik shoqërohet me rritje të nivelit të stresit për zhvillimin e mësimin online në fizikë.
- Komunikimi mësues-nxënës ka qenë i vazhdueshëm dhe personalizuar sipas nevojave të secilit nxënës. Mësuesit kanë bërë përpjekje për të siguruar që nxënësit të kenë akses për materiale shtesë, megjithë nevojën e tyre për burime të shtuara informacioni.

5. REFERENCA

- <https://www.edu.gov.mb.ca/k12/dl>
- <http://www.mod.gov.al/botime/html/revista>
- <https://www.botasot.info/16-prill-2011>
- www.universities.com/Distanc/_Learning/
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Arsimi_n/_distanc/
- <https://ad.rks.gov.netesq/e-learning>

- <http://www.indiaeducation.netonline-education/articles/>
- <https://observatory.tec.mx/edu-news/challenges-of-teaching-chemistry-online>
- <https://www.ejmste.com/download/effect-of-covid-19-on-the-performance-of-grade-12-students-implications-for-stem-education-7893.pdf>
- https://www.pivotpl.com/wp-content/uploads/2020/05/Pivot-Professional-Learning_State-of-Education-Whitepaper_April2020.pdf
- <https://observatory.tec.mx/edu-bits-2/teaching-physics-in-a-remote-hybrid-model-tec21/>